



Frashër Demaj

# Histori 6

PËR KLASËN E GJASHTË TË ARSIMIT TË MESËM TË ULËT

**dukagjini**  
shtëpia botuese publishing house



6

Frashër Demaj

# HISTORI

Për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët

# PËRMBAJTJA

HYRJE .....	1
1.HISTORIA - SHKENCË SHOQËRORE .....	4
2.LLOGARITJA E KOHËS NË HISTORI .....	6
3.NJERËZIT E PARË - JETA E TYRE .....	8
4.NJERIU I KOHËS SË GURIT .....	10
5.ORGANIZIMET E PARA SHOQËRORE .....	12
6.KOHA E METALEVE .....	14
7.QYTETËRIMI NË EGJIPT .....	20
8.QYTETËRIMI NË MESOPOTAMI DHE NË PERSI .....	24
9.QYTETËRIMI NË INDI DHE NË KINË .....	26
10.KULTURA DHE BESIMI TE POPUJT E LINDJES SË LASHTË .....	28
11.QYTETËRIMET E POPUJVE QË JETONIN NË BRIGJET E DETIT TË MESDHEUT .....	32
12.QYTETËRIMI GREK .....	36
13.ARSIMI, KULTURA DHE SHKENCA NË GREQI - PJSË E QYTETËRIMIT ANTIK .....	38
14.ATHINA DHE SPARTA - SHTETE SKLLAVOPRONARE .....	40
15.LUFTËRAT GREKO-PERSIANE DHE LUFTËRAT E GREKËVE NË MES VETE (LUFTA E PELOPONEZIT) .....	44
16.GRATË NË GREQINË ANTIKE .....	46
17.JETA E PËRDITSHME NË GREQINË ANTIKE .....	48
18.PERSONALITETE TË SHQUARA TË GREQISË ANTIKE .....	50
19.MAQEDONIA NË KOHËN E FILIPIT II DHE LEKËS SË MADH .....	56
20.ROMA E VJETËR .....	60
21.ROMA NË KOHËN E MBRETËRISË DHE TË REPUBLIKËS .....	62
22.ROMA ZOTËRUESE E PELLGUT TË MESDHEUT .....	64
23.SKLEVËRIT - NJERËZ PA ASNJË TË DREJTË .....	66
24.ROMA NË KOHËN E CEZARIT DHE OKTAVIAN AUGUSTIT .....	68
25.DOBËSIMI DHE RËNIA E PERANDORISË ROMAKE .....	70
26.SI MARTOHESHIN TË RINJTË NË ROMËN E VJETËR .....	72
27.ZHVILLIMI EKONOMIK I ROMËS .....	74
28.FILOZOFIA, SHKENCA DHE KULTURA ROMAKE .....	76
29.VENDBANIMET, QYTETET DHE JETA E PËRDITSHME ROMAKE .....	78
30.PERSONALITETE TË SHQUARA TE QYTETËRIMIT ROMAKE .....	80
31.LINDJA E KRISHTERIMIT .....	82
32.SHTRIRJA DHE Fiset kryesore ilire .....	86
33.VENDBANIMET, SHTËPITË DHE QYTETET ILIRE .....	90
34.SI DUKESHIN ILIRËT? .....	92
35.BUJQËSIA, BLEGTORIA DHE ZEJTARIA TEK ILIRËT .....	94
36.ILIRËT ISHIN TREGTARË TË SHQUAR .....	96
37.DETARIA, ANJET LUFTARAKE DHE PIRATËRIA NË ILIRI .....	98
38.VESHMBATHJET DHE STOLITË ILIRE .....	100
39.ILIRËT NJIHNIN ILAÇET PËR SHËRIMIN E SËMUNDJEVE .....	102
40.ILIRËT FORMOJNË SHTETET E TYRE .....	104

41.MOLOSËT FORMOJNË SHTETIN E EPIRIT (shek. V-IV para Krishtit) .....	106
42.DARDANIA .....	108
43.MBRETËRIA DARDANE .....	110
44.MONUMENTE TË KULTURËS MATERIALE NË DARDANI .....	112
45.MBRETËRIA ARDIANE .....	114
46.ILIRIA NËN SUNDIMIN E PERANDORISË ROMAKE .....	116
47.KRYENGRITJA ILIRE KUNDËR PERANDORISË ROMAKE (6-9).....	118
48.ARMËT SULMUESE DHE MBROJTËSE QE PËRDORESHIN NË ILIRI .....	120
49.GJUHA, KULTURA DHE BESIMI TEK ILIRËT .....	122
50.PERSONALITETE TË SHQUARA ILIRE.....	124



## *Të dashur nxënës, prindër dhe mësime të mësuara!*

*Teksti i historisë për klasën e gjashtë, bazuar në Kurrikulën e re, përfshin periudhën parahistorike dhe atë historike, pjesën e antikës. Në tekstin “Historia 6”, nxënësit do ta kenë mundësinë të nxënë më shumë dije për temat si: Parahistoria – Fillet e njerëzimit, bashkësitë e para njerëzore; Qytetërimet e Lindjes së Lashtë; Qytetërimet e Mesdheut në Antikitë; Qytetërimi ilir; Personalitetet e shquara në Antikë; Marrëdhëniet shoqërore në Antikë; Besimet dhe religjionet; Institucioni i vendimmarrjes në shoqërinë antike; Demokracia në kohën antike; Qyteti – organizimi i hapësirës së banimit; pozitën dhe rolin e grave dhe të fëmijëve etj.*


*Teksti “Historia 6”, është strukturuar dhe bazuar në parametrat shkencorë, profesionalë dhe pedagogjikë të mbështetur në metodat moderne të mësimit dhe mësimit. Është respektuar maksimalisht korrektesia e përdorimit të burimeve dhe fakteve shkencore bazuar në arritjet e fundit shkencore për këto periudha historike, si dhe gjuha e shkrimit në trajtimin e temave të ndryshme. Gjatë hartimit të tekstit jemi munduar që nxënësin të mos e mbingarkojmë me informacione të tepërta dhe të padobishme për këtë moshë.*


*Në tekst trajtohen fenomenet shoqërore, marrëdhëniet midis individëve dhe familjes, grupeve më të mëdha, shoqërive, shteteve-vendeve dhe civilizimeve në këto periudha historike. Gjithashtu, nxënësit do të kenë mundësi praktike të kuptojnë rëndësinë e burimeve historike, mënyrën e shfrytëzimit dhe përdorimit të tyre.*

*“Historia 6” është tekst i strukturuar në përputhje me pretendimet që të nxënësit të zhvillohet të menduarit historik, kreativ e kritik për ngjarje dhe fenomene të ndryshme historike. Kjo qasje do të ndikojë në zhvillimin e aftësive, shkathtësive dhe vlerave humane të nxënësit e kësaj moshë. Jemi të bindur që nxënësit, duke shfrytëzuar edukimin nga fusha e historisë, do të jenë qytetarë të devotshëm ndaj atdheut të tyre dhe vlerave qytetare, kombëtare e njerëzore. Në këtë vijimësi besojmë se nxënësit do të formohen si personalitete dhe qytetarë të përgjegjshëm, që do të pranojnë dhe respektojnë identitetet e ndryshme etnike, racore, gjinore, shoqërore, kulturore, fetare, ato regjionale dhe çdo identitet e dallim tjetër nga jeta e përditshme.*

*Bazuar në mënyrën dhe materien e trajtuar brenda tekstit, shpresojmë që nxënësit në klasën e gjashtë do t'i arrijnë rezultatet e të nxënësit të lëndës (RNL) për temat e caktuara, të dalin nga rezultatet e të nxënësit të fushës (RNF) “Shoqëria dhe Mjedisi”, të shkallës së tretë në Kurrikulën Bërthama II të hartuar nga ekspertët dhe të miratuar nga MASH-T-i.*

*Vit të mbarë e suksese!  
Autori*



A photograph of a cave interior, showing a large, textured rock wall. The lighting is warm and golden, highlighting the rough, uneven surface of the rock. A large, white, serif letter 'I' is overlaid on the right side of the image, partially obscuring the rock wall. The letter is positioned vertically, with its top and bottom extending towards the top and bottom of the frame.

I

PARAHISTORIA  
FILLET E NJERËZIMIT,  
BASHKËSITË E PARA NJERËZORE




## I

## 1. HISTORIA - SHKENCË SHOQËRORE

**Çka studion historia?**

Historia studion të kaluarën e shoqërisë njerëzore, që nga njerëzit e parë deri më sot. Secili njeri, grup njerëzish, komb, shtet e ka historinë e vet. Duke mësuar historinë marrim informacione të rëndësishme për mënyrën e jetesës së njerëzve, për komunikimin në mes tyre, për edukimin dhe arsimimin e fëmijëve dhe të rriturve, kulturën dhe qytetërimin, për zhvillimin ekonomik, për punët e përditshme, për rolin e grave në shoqëri, për organizimet shoqërore, politike, për shtetet dhe luftërat dhe fenomene të tjera duke filluar që nga njeriu parahistorik e deri në kohët moderne.

BURIMET-DOKUMENTET  
E SHKRUARA**Historia ndahet në dy periudha**

Historia e shoqërisë njerëzore është shumë e gjatë. Ajo ndahet në dy periudha. Periudha parahistorike dhe Periudha historike.

Periudha parahistorike fillon prej paraqitjes së njerëzve të parë dhe zgjat deri në lindjen e shoqërisë me klasa.

Periudha historike fillon nga ndarja e shoqërisë në klasa e deri në ditët tona. Ajo ndahet në katër kohë:

- Koha e vjetër (nga shfaqja e civilizimit deri në shekullin V)
- Koha e mesme (shekulli V deri XV)
- Koha e re (shekulli XVI deri më 1918) dhe
- Koha më e re (1918 deri në ditët tona)

**Në çka bazohet historia e shkruar?**

Kur shkruajmë histori duhet të bazohemi në burime historike. Ato ndahen në: burime materiale, burime të shkruara dhe burime gojore.

PIKTURË KU SHIHET FORMA E  
ANLJEVE LUNDRUESE NË ANTIKË

**Burimet materiale** janë veglat e punës, armët, stolitë, veprat e artit, mozaikë të ndryshëm, varrezat, tempujt etj. Shkenca e cila trajton më së shumti këto burime është arkeologjia. Duke bërë gërmime arkeologjike zbulojmë fakte për ngjarje të shumta në periudha të ndryshme historike.

Burimet e shkruara (dokumentet) historike janë materiale të rëndësishme të shkruara në gurë, drunj, papiruse, letër etj., pa të cilat nuk mund të shkruhet historia. Duke studiuar burimet e shkruara, historianët nxjerrin të vërtetat historike, të cilat pastaj i botojnë në librat dhe studimet e tyre. Edhe librat shkollorë të historisë bazohen në këto burime. Burimet e shkruara ruhen kryesisht nëpër arkiva, në muze, në biblioteka, në shtëpi etj.

Burimet gojore janë informata me përmbajtje historike që përcillen brez pas brezi, nga gjyshërit te prindërit dhe nga prindërit te fëmijët. Këto burime përshkruajnë ngjarje të rëndësishme. Shqiptarët kanë shumë ngjarje historike të shpjeguara që bazohen në burimet gojore. Kjo ndodh për arsye të traditës së gjatë të tregimit të ngjarjeve historike në familje.



 BURIME GOJORE



## Fjalori

**Arkeologjia** - shkencë që studion kulturën dhe jetën e popujve në kohët e lashta, duke u mbështetur në monumentet dhe sendet që kanë mbetur prej tyre nën tokë e që zbulohen me anë të gërmimeve.

**Ese** - shkrim i gjatë a studim i cili trajton në mënyrë të përgjithshme, të lirë e jo të gjithanshme a shteruese çështje shoqërore, shkencore, letrare, kulturore etj.



## TË PUNOJMË SË BASHKU

Çka studion historia dhe si ndahet ajo?

Pse janë të rëndësishme burimet historike dhe si ndahen ato?


Vizitoni Muzeun e Kosovës dhe Arkivin e Kosovës apo arkivin e komunës suaj për të parë burimet materiale dhe ato të shkruara. Diskutoni çka ju ka pëlqyer më së shumti dhe pse.

Shkruani nga një ese me tema të ndryshme duke përdorur burimet gojore nga familjarët tuaj.

## 2. LLOGARITJA E KOHËS NË HISTORI

### Si e llogaritin kohën popujt e lashtë?

Të gjitha ngjarjet historike zhvillohen në një kohë të caktuar. Njerëzit e vjetër i kanë llogaritur ngjarjet historike në mënyra të ndryshme, që kanë dalluar nga njëra-tjetra. Dikush ka llogaritur vitet nga ndonjë ngjarje natyrore, të tjerë nga korrijet e kulturave bujqësore, dikush nga vdekja e ndonjë njeriu të rëndësishëm, të tjerë nga lindja e një tjetri, që është bërë i famshëm, nga ngritja e ndonjë vendbanimi etj. Grekët e vjetër, për shembull, i llogarisnin vitet duke u nisur nga Olimpiada e parë (776 para Krishtit), romakët nga themelimi i Romës (753 para Krishtit), ilirët sipas ngjarjeve të rëndësishme nga jeta e tyre, egjiptianët sipas ditëlindjeve të faraonëve, kinezët e shfrytëzonin lindjen e diellit dhe muzgun për llogaritje etj.



LLOGARITJA E KOHËS PARA KRISHTIT  
DHE PAS LINDJES SË KRISHTIT

### Llogaritja e kohës para Krishtit dhe pas Krishtit

Pjesa më e madhe e historianëve, për të llogaritur vitet, ka zgjedhur si pikë referimi lindjen e Jezu Krishtit. Me lindjen e Krishtit si vit i parë për llogaritjen e kohës është marrë viti 1. Periudha para lindjes së Krishtit (para Krishtit) ndryshe quhet edhe para erës sonë dhe është llogaritur në bazë të ngjarjeve të ndryshme dhe vitet janë numëruar prej të madhit drejt të voglit, p.sh. viti 229 (Luftërat Ilirio-Romake), pas tij vjen viti 228, 227, 226 e kështu me radhë. Ndërsa pas lindjes së Krishtit (pas Krishtit) ose pas erës sonë, vitet numërohen prej të voglit drejt të madhit. P.sh. viti 395 (ndarja e Perandorisë Romake), 396, 397, 398 e deri në vitin 2017, 2018 e më tutje vitet që pasojnë.

## Dekada, shekulli dhe mijëvjeçari

Numërimi i viteve në historinë e shoqërisë njerëzore bëhet me vite. Viti i ka 365 ditë të ndara në 12 muaj. Në jetën e përditshme njerëzit përdorin shumë shpesh fjalët: dekadë, shekull dhe mijëvjeçar ose milenium. Ngjarjet historike ndodhin në një datë, brenda një dekade të caktuar, shekulli dhe mijëvjeçari.

**1 dekadë = 10 vjet;**

**1 shekull = 100 vjet;**

**1 mijëvjeçar = 1000 vjet.**

Shekulli I (i parë) filloi në vitin 1 dhe ka mbaruar në fund të vitit 100, shekulli II (i dytë) ka filluar në vitin 101 dhe ka mbaruar në vitin 200, i treti nga viti 201 deri më 300 e kështu me radhë.

Mijëvjeçari I ka filluar në vitin 1 dhe ka përfunduar në vitin 1000, mijëvjeçari II ka filluar në vitin 1001 dhe ka përfunduar në vitin 2000, mijëvjeçari III - ky që jetojmë – ka filluar më 1 janar 2001 dhe do të mbarojë më 31 dhjetor 3000 e kështu me radhë.



## Ushtrime në klasë

Shkruaj më poshtë cilit shekull dhe mijëvjeçar i takojnë vjetët:

Viti	Shekulli	Mijëvjeçari	Viti	Shekulli	Mijëvjeçari
218	_____	_____;	999	_____	_____
1405	_____	_____;	1878	_____	_____
1912	_____	_____;	2008	_____	_____



## TË PUNOJMË SË BASHKU

Si e kanë llogaritur kohën popujt e lashtë?

Diskutoni për llogaritjen e kohës para dhe pas lindjes së Krishtit.

Diskutoni për ditëlindjet tuaja, të arsimtarëve, prindërve dhe gjyshërve.

Tregoni cilës dekadë, të cilit shekull dhe cilit mijëvjeçar i takojnë ditëlindjet.

## I



 NJERIU I PARË DUKE U USHQYER ME FRUTA TË GATSHME

NJERËZIT E PARË 

### 3. NJERËZIT E PARË - JETA E TYRE

#### Si dukeshin njerëzit e parë?

Paraardhësit e njeriut të sotëm mendohet se kanë jetuar para 3-4 milionë vjetësh. Shkencëtarët mendojnë se dallimet në mes njeriut parahistorik dhe njeriut të sotëm ishin të dukshme. Njerëzit e parë ishin me trup më të shkurtër se njeriu i sotëm. Trupin e kishin të kërrusur dhe të mbuluar me qime të gjata, këmbët më të shkurtra se njeriu i sotëm kurse duart i kishin të gjata. Pamjen e fytyrës nuk e kishin të përsosur si njerëzit e sotëm. Nuk kishin as veshje, por lëkura e tyre e trashë i mbronte ata nga të ftohtët.

#### Jeta e përditshme dhe të ushqyerit


Njerëzit e parë jetonin në grupe, kryesisht në shpella, në pyje dhe vende të mbuluara me barishte të gjata dhe kaçuba. Jeta e tyre ishte shumë e vështirë dhe plot me rreziqe. Për t'i përballuar rreziqet nga sulmet e kafshëve të egra ata ishin të detyruar të jetonin në grupe që përfshinin 20-30 veta. Njerëzit e të njëjtit grup shoqëror kishin armiqësi me grupet e tjera dhe shpeshherë përplaseshin në mes vete. Ky fakt ndikonte keq për shkak se e pamundësonte komunikimin e grupeve të ndryshme shoqërore.

Ushqimi ishte një nga arsyet e përplasjes së njerëzve ne mes vete. Në fillim ata ushqeheshin me ushqime të gatshme që i gjenin në natyrë, sepse ata nuk dinin ta përgatisnin. Ndër ushqimet kryesore ishin frutat, barishtet, fletët dhe bimët e ndryshme. Kur harxhohej ushqimi, ata zhvendoseshin nga një vend në tjetrin.



## Mendja, të folurit dhe puna ndikuan në përsosjen e njeriut

Nevojat e përditshme ndikuan që njeriu ta përdorte trurin. Pas një kohe të gjatë ata filluan të punojnë vegla të ndryshme të punës. Për të bërë vegla pune duhej menduar të krijoheshin ato dhe duke menduar, truri i njeriut filloi të zhvillohej dhe të shkathtësohej. Ndërkohë, njeriu filloi të punonte me ato vegla të pakta që i krijoi. Në këtë mënyrë i shkathtësoi gjymtyrët e trupit. Edhe nevoja për të komunikuar me njëri-tjetrin dhe për të treguar diçka ndikoi në shfaqjen e të folurit. Pra, njerëzit, përveç komunikimit me gjeste, filluan të komunikojnë edhe me fjalë.

 NJERËZIT E PARË DUKE LËVIZUR  
NGA NJËRI VEND NË TJETRIN



## TË PUNOJMË SË BASHKU


Duke përdorur imagjinatën tënde, provo ta pikturosh njeriun e parë!  
Analizo mënyrën e përdorimit të mendjes së njeriut dhe inskeno situata duke përdorur mendjen për diçka që nuk e di, por do ta mësoh!

## I

## 4. NJERIU I KOHËS SË GURIT

**Paleoliti, Mezoliti dhe Neoliti**


Koha e Gurit është quajtur kështu për arsye se njerëzit i kanë punuar veglat e punës prej gurit. Ajo ndahet në tri periudha kryesore: në Paleolit ose Kohë e Vjetër e Gurit, Mezolit ose Kohë e Mesme e Gurit dhe Neolit ose Kohë e Re e Gurit. Njerëzit në Paleolit, me gurin e mprehur, çanin frutat, prisnin bimët etj. Në Mezolit u përsos më shumë mënyra e punimit të veglave të punës dhe e jetës së përditshme. Në periudhën e Neolitit që filloi nga mijëvjeçari i shtatë, u përmirësua dukshëm jeta e njeriut. Njeriu i kësaj kohe punonte vegla më të përsosura si sëpata prej guri, thika të ndryshme, armë me forma të ndryshme për gjueti, për peshkim, mjete shpuese etj.



VEGLA GJUEITE NGA GURI

**Zbulimi i zjarrit dhe njohja e gjuetisë**

Para 400 mijë vjetësh njerëzit nuk kishin njohuri për zjarrin. Ndryshimet klimatike dhe moti me shi sollën diçka të re. Në një ditë me reshje shiu, rrufeja kishte goditur disa drunj të mëdhenj në natyrë, të cilët i kishte ndezur flakë. Njerëzit e panë që flaka bënte dritë dhe lëshonte nxehtësi. Fillimisht, ata e bartën zjarrin nga një vend në tjetrin. Me kalimin e kohës ata mësuan ta ndeznin duke fërkuar dy drunj të thatë me njëri-tjetrin, duke grumbulluar dushk të thatë dhe duke fërkuar gurët në mes vete. Si rezultat i fërkimit të gurëve shfaqeshin shkëndija zjarri, të cilat binin në dushk dhe e ndiznin atë. Me zbulimin e zjarrit njerëzit u bënë të pavarur nga klima, mësuan ta piqnin mishin, ta ngrohnin ujin dhe ta përdornin për nevoja të përditshme.



NJERËZIT DUKE NDEZUR ZJARRIN

Përsosja e veglave të punës, përdorimi i mendjes dhe shtimi i nevojave për ushqim e çuan njeriun në njohjen e një veprimtarie të rëndësishme si gjuetia. Njerëzit filluan të gjuanin kafshë të ndryshme si: mamuthin, drerin, derrin, kalin e egër, bizonin, ariun.


Nga gjuetia e kafshëve njerëzit përfitonin mishin, lëkurën nga e cila bënin veshmbathje, brirët dhe eshtrat e kafshëve, që i përdornin për të punuar vegla pune dhe gjuetie si: heshta, biza, çengelë, harpunë dhe mjete të tjera. Edhe peshkimi u bë veprimtari e rëndësishme nga e cila sigurohej ushqimi.

### Gjurmë të njerëzve të hershëm në botë

Nevojat e njerëzve për ushqim, strehim, mirëqenie, ikje nga konfliktet me njëri-tjetrin, kërkimi i një jete më të mirë ndikoi në popullimin e tokës me njerëz. Informatat për lëvizjet e njerëzve, vendosjen e tyre, krijimin e vendbanimeve të reja dhe për aspekte të tjera i marrim nga gjetjet arkeologjike. Sipas arkeologëve, gjurmët e para të njeriut të hershëm i gjejmë në Afrikën Lindore, në Evropë, në Azi etj. Gjurmë të njerëzve të hershëm janë gjetur edhe në territoret shqiptare, si: në Shpellën e Bogasit në Sarandë, në Malin e Dajtit afër Tiranës, në Gajtan të Shkodrës, në Ohër, në Fafos të Mitrovicës, në Tjerrtores të Prishtinës, ku është gjetur “Hyjnesha në Fron”, që është simbol i qytetit të Prishtinës etj.



**NJERËZIT E LASHTË DUKE  
GJUAJTUR KAFSHËT**



## Fjalori

**Biza** - majë e hollë që shërbente për shpim.

**Çengel** - grep i trashë që përdorej për të varur diçka.

**Harpun** - mjet peshkimi.

**Mamuthi** - lloj kafshe e egër që ngjante me elefantin.

**Bizoni** - ka i egër me trup të madh, me një gungë mbi shpatulla.



### TË PUNOJMË SË BASHKU

Merri dy copa druri të lëmuar, fërkoji mes vete dhe provo t'i ndezësh ato!

Analizo në detaje ilustrimin që flet për gjuetinë dhe diskuto për të!

Diskutoni nëse ndonjëri nga ju keni vizituar ndonjë nga vendet e përmendura në Kosovë apo diku tjetër ku janë zbuluar gjurmë të njerëzve të parë.

Çka keni parë apo dëgjuar aty?



## 5. ORGANIZIMET E PARA SHOQËRORE

### Familja, gjinia dhe fisi

Në vendbanimet e hershme të njerëzve, të formuara para rreth 40 mijë vjetësh, nevojat e përditshme ndikuan që njerëzit të jetonin në grupe. Këto grupe jetonin në shpella dhe në kasolle, të cilat filluan t'i ndërtonin vetë. Grupi më i vogël ishte familja e cila përbëhej nga njerëzit që kishin afërsi gjaku ne mes vete. Numri i anëtarëve të familjes sillej afërsisht 20-30, por në raste të veçanta mund të ishte herë më i vogël e herë më i madh. Disa familje formonin një grup më të madh shoqëror që quhej gjini. Kurse disa gjini formonin grup më të madh njerëzish me origjinë të përbashkët që quhej fis. Fiset kishin territoret e tyre dhe qeveriseshin nga udhëheqësi që ishte kryeplaku ose njeriu më i vjetër i fisit, që duhej të ishte njeri i zgjuar dhe i besueshëm për të gjithë anëtarët e fisit.



### Ndarja e punëve në familje

Banorët e Paleolitit të mesëm jetonin me prodhimet, që i gjenin të gatshme në natyrë dhe sidomos me gjueti, e cila u bë veprimtaria kryesore. Me mbledhjen e frutave të gatshme në natyrë, me punët e shtëpisë, ndezjen e zjarrit, me rritjen e fëmijëve, me përgatitjen e lëkurës për veshje etj., merrej gruaja. Me punë të rënda fizike, me gjueti, me përgatitjen e veglave të punës dhe të armëve, merreshin burrat. Ndarja e punëve dhe kontributi i të rriturve brenda familjes ndihmoi shumë në forcimin e lidhjeve të brendshme midis anëtarëve të familjes dhe grupeve të afërta të cilat çuan në organizimin e bashkësisë primitive.

 NJERIU I PARË GJAHTAR

### Roli dhe autoriteti i gruas, epoka e matriarkatit

Matriarkati ishte formë e organizimit shoqëror, në të cilën nëna ose gruaja më e vjetër ishte autoriteti dhe kreu i familjes. Në matriarkat gratë mbanin pozitat më të larta të pushtetit në rolet e udhëheqjes familjare, të autoritetit moral, të privilegjeve shoqërore, jetën ekonomike dhe kontrollin e pronës. Autoriteti i saj në krahasim me burrat ishte në një shkallë më të lartë. Periudha kohore gjatë së cilës vendin e parë të organizimit shoqëror të njerëzve me origjinë të përbashkët e kishte gruaja, u quajt epoka e matriarkatit. Autoritetit të saj duhet t'i bindeshin të gjithë anëtarët e familjes pa përjashtim.

## Besimi i njeriut të vjetër dhe fillimet e para të fesë

Studiuesit e ndryshëm mendojnë se besimi i njeriut parahistorik filloi që nga Paleoliti. Ata besonin në fuqitë e mbinatyrshme, të cilat mendohej se qëndronin në qiell. Këto fuqi njerëzit i quanin zot ose perëndi. Ata mendonin se disa nga perënditë janë të mira e disa të këqija. Kur atyre u ndodhte diçka e mirë në jetën e tyre, ata besonin në perënditë e mira, ndërsa kur përjetonin fatkeqësi në familjet e tyre, ata mendonin se goditeshin nga zotat e këqij. Kështu duke pasur frikë nga ata, njerëzit filluan t'u luteshin perëndive, por me lutje u drejttoheshin edhe kur kishin nevojë për ndihmën e tyre. Përveç fuqive mbinatyrore, njerëzit besonin edhe në kafshë të ndryshme të cilat konsideroheshin si perëndi. Ky lloj besimi u quajt totemizëm. Çdo familje dhe fis kishte totemin e vet. Lutjet dhe besimi në perëndi u quajt fe. Shqetësimi për vdekjen e njerëzve dhe varrimi i tyre, mendohet të jetë një nga format më të hershme të praktikës fetare. Për nder të perëndive, njerëzit më vonë ndërtuan tempuj dhe faltore të shumta.



## Fjalori

**Totemizëm** - besimi në kafshë.  
**Matriarkat** - koha kur rolin kryesor në jetën ekonomike, shoqërore e familjare e luante gruaja.



ANËTARËT E FAMILJES



## TË PUNOJMË SË BASHKU

Diskutoni për familjen, gjininë dhe fisin si grupe shoqërore!  
 Çka mendoni për ndarjen e punëve në familje. A janë të ndara në familjen tuaj?  
 Shkruani nga një ese të shkurtër për rolin e gruas në epokën a matriarkatit!  
 Analizoni fillimet e besimit të njeriut të vjetër!

## 6. KOHA E METALEVE

### Zbulimi i metaleve përmirësoi jetën e njerëzve

Pasi njeriu mësoi ta ndizte zjarrin, e futi atë në përdorim për nevoja të përditshme në familje. Ata e ndiznin zjarrin duke vënë disa gurë nën drunjtë që i ndiznin. Një ditë, njeriu kur kishte ndezur zjarrin mbi gurë, gurët nga temperatura e lartë ishin shkrirë. Pas fikjes së zjarrit, gurët e shkrirë, në lëng, kishin marrë formë të çrregullt. Këta gurë përmbanin sasi të madhe të metaleve. Njeriu vërejti që nga

këto metale mund të krijonte vegla me forma të ndryshme. Me kalimin e kohës njerëzit mësuuan të bëjnë kallëpe me forma të ndryshme duke punuar kështu vegla pune, armë gjuetie dhe gjëra të tjera për nevoja të përditshme. Ndër veglat kryesore të punës ishin: çekani, thika, sëpata, shati e më vonë edhe plugu për punimin e tokës. Shkrirja e metaleve dhe aftësia e njeriut për t'i përdorur për interesa të veta zënë fill rreth 6000 vjet para Krishtit. Prodhimi i veglave të punës dhe armëve prej metali shënoi kalimin e shoqërisë njerëzore nga koha e gurit, në kohën e metaleve. Përdorimi i gjërave të punuara nga metalet ndikoi dukshëm në përmirësimin e jetës së njerëzve.



VEGLAT E PARA ANTIKE TË PUNUARA NGA METALET

### Si ndahet koha e metaleve ?

Koha e metaleve është një periudhë e gjatë historike. Ajo ndahet në kohën e bakrit, kohën e bronzit dhe kohën e hekurit.

Fillimisht veglat e punës ishin nga bakri. Pas bakrit u zbulua bronzi (3000 vjet para Krishtit), i cili ishte përzierje e bakrit me kallajin. Dhe në fund, 1300 vjet para Krishtit, u zbulua hekuri, i cili u bë metali më i përhapur në botë. Veglat e para prej hekuri u prodhuan dhe u përdorën më së pari në vendet e Lindjes së Lashtë si në Egjipt, në Kinë etj., ndërsa në Evropë përdorimi i hekurit ishte më i vonshëm (1200 vjet para Krishtit).

## Lindja e bujqësisë zgjidhi problemet e ushqimit të njerëzve

Lindja e bujqësisë shënoi ngritje cilësore në mënyrën e të menduarit të njerëzve dhe në pamjen e tyre fizike. Rreth 10000-9000 vjet para Krishtit njerëzit kishin vërejtur se kur binte në tokë një kokërr nga frutat, ajo mbinte dhe jepte disa bimë të tjera, të cilat jepnin kokrra dhe fruta më shumë. Në këtë mënyrë njeriu mësoi të mbillte bimë të ndryshme si: thjerrëzat, bizelen, grurin, elbin, melin, lirin, orizin, urovin, karotën. Më vonë, rreth vitit 5000 para Krishtit, filloi përdorimi i bananes, 2500 para Krishtit edhe portokalli e pjeshka në Kinë. Supozohet se bujqësia për herë të parë u njoh nga njerëzit që jetonin në Azinë Jugperëndimore. Lindja e bujqësisë e zgjidhi problemin e ushqimit të njerëzve dhe përdorimi i ushqimeve bujqësore ndikoi pozitivisht edhe në zhvillimin e njeriut.

 NJERËZIT E PARË DUKE PUNUAR NË BUJQËSI



### Fillet e zejtarisë

Shkrirja dhe përdorimi i metaleve shënoi një kthesë të madhe në punën dhe në jetën e njerëzve. Me kalimin e kohës, mineralet e bakrit dhe të hekurit, kur nxirreshin nga minierat, i copëtonin me çekan dhe pastaj i shkrinin në temperatura të larta që jepte zjarri.

Metalin e shkrirë e hidhnin në kallëpe duke i dhënë forma të ndryshme. Pas ftohjes dhe marrjes së formës, e farkonin duke e nxjerrë si prodhim final. Shtimi i nevojave njerëzore për prodhimin e më shumë gjërave të nevojshme nga metali, e bëri këtë zanat si njërin nga më të rëndësishmit. Kështu, dalëngadalë lindi zanati i farkëtarit. Farkëtarët punonin vegla pune prej metali, maja të mprehta, vegla gjuetie, për të kaluar më vonë, në vegla më të përsosura që u duheshin njerëzve në jetën e përditshme.

### Zbutja e kafshëve të egra shënoi lindjen e blegtorisë

Kasollet e njerëzve, të ndërtuara në vendbanimet e tyre, shpeshherë rrezikoheshin nga kafshët e egra. Prandaj, burrat e fuqishëm të familjes dhe të fisit gjithnjë përballeshin me këto kafshë. Me kalimin

NJERËZIT DUKE HEQUR KAFSHËN  
E RËNË NË KURTH



e kohës, një ndër kafshët e egra që rrinin afër vendbanimeve, ishte qeni. Qentë ushqeheshin me tepricat e ushqimit të njerëzve. Kështu filloi afrimi i njeriut me qenin dhe dalëngadalë u zhvillua procesi i zbutjes së tij. Njerëzit filluan t'i mbanin afër qentë dhe t'i shfrytëzonin në dobi të tyre. Të lehurat e qenit paralajmëronin njerëzit për afrimin e rrezikut nga kafshët e egra. Njerëzit mësuuan të ngrehnin edhe kurthe dhe i zinin kafshët e egra të gjalla. I fushnin në kafaze dhe i ruanin për ushqim.



ZBUTJA E KAFSHËVE TË EGRA 📖



## Fjalori

**Zejtari** - ai që ushtron një zeje, zanatçi.

**Farkëtar** - hekurpunues. Punëtori që farkon hekurin.

**Urovi** - bimë barishtore që përdoret si ushqim për kafshë.

**Thjerrëza** - bimë bishtajore njëvjeçare, me lule të vogla e të bardha dhe me bishtaja të shkurtër; kokrrat e kësaj bime përdoren për ushqim.

**Bizele** - bimë njëvjeçare që bën bishtaja me kokrra të blerta. Bishtajat dhe kokrrat e kësaj bime përdoren për ushqim.

**Elbi** - lloj bime e ngjashme me grurin, e cila përdoret për të gatuar bukë, për prodhimin e birrës etj.

**Melli** - lloj bime që hyn te drithërat. Prej tij mund të gatuhet edhe buka.



## TË PUNOJMË SË BASHKU

Si ndikoi zbulimi i metaleve në jetën e njeriut?

Merrni një ose disa fara gruri, misri, fasule, pjeshke ose ndonjë tjetër, mbillni në tokë ose edhe në saks dhe shihni si nisi dhe u zhvillua bujqësia!

Përpiloheni një listë duke radhitur përfitimet e njeriut nga delet, lopët dhe dhitë dhe krahasoni me përfitimet që kanë sot njerëzit nga këto kafshë shtëpiake!





# II

QYTETËRIMET E  
LINDJES SË LASHTË



# II

## 7. QYTETËRIMI NË EGJIPT


### Lindja e qytetërimeve në luginat e lumenjve

Qytetërimi i popujve të Lindjes së Lashtë është ndër me të hershmit në historinë e shoqërisë njerëzore. Këta popuj jetonin afër luginave të lumenjve, sepse kishin kushte më të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë. Në Luginën e lumit Nil jetonin egjiptianët, në luginën e lumenjve Tigër dhe Euftrat, në Mesopotami, jetonin sumerët, në luginat e lumenjve Ind dhe Gang jetonin indianët, ndërsa në luginat e lumenjve Hoang-Hoa dhe Jang ce Kjang jetonin kinezët. Në këto territore u zhvilluan shumë veprimtari dobiprurëse si: bujqësia, blegtoria, tregtia, zejtaria etj. Lindën dhe u zhvilluan qytete që luajtën rol të rëndësishëm. U formuan shtetet e para, u njoh për herë të parë shkrimi si dhe u zhvilluan shkenca, artet dhe religjioni.

RRJEDHA E LUMIT NIL



NDARJA DHE RANGIMI I POPULLSISË NË EGJIPT



Pra, e gjithë popullsia e Egjiptit të Vjetër ndahej në dy grupe të mëdha: në njerëz të lirë dhe skllëvër. Përveç skllëvërve, në Egjipt të gjithë burrat dhe gratë, nga të gjitha klasat shoqërore, ishin të barabartë para ligjit. Madje, edhe fshatari më i ulët kishte të drejtë të kërkonte drejtësi. Si burrat, ashtu edhe gratë kishin të drejtë të kishin prona e t'i shisnin ato, kishin të drejtë të martoheshin e të ndaheshin, të merrnin trashëgimi dhe të ndiqnin një çështje ligjore në gjyq. Gratë e Egjiptit të lashtë kishin më shumë mundësi për të udhëhequr edhe poste shtetërore.

Gra si Hatshepsut dhe Kleopatra u bënë edhe faraone.

 EGIPTI I VJETËR



## II

**Jeta ekonomike**

Zhvillimi i bujqësisë në Egjipt ishte i varur nga lumi Nil. Egjiptianët njihnin tri stinë: Akhet (stina e përmytjeve), Peret (stina e mbjelljes) dhe Shemu (stina e korrjes). Stina e përmytjeve zgjaste nga qershori në shtator. Gjatë kësaj stine, në brigjet e lumit vinte një shtresë balte e përshtatshme për rritjen e bimëve. Bujqit lëvronin arat dhe i mbillnin me bimë të ndryshme. Egjiptianët kultivonin grurin, elbin, lirin, papirusin, frutat dhe perimet si: bostanin, rrushin, kungullin, bishtajën, qepën etj.

Blegtoria ishte veprimtari e rëndësishme. Përveç gjedhëve, egjiptianët e lashtë mbanin edhe dele, dhi dhe derra. Pastaj shpendë si: rosat, patat dhe pëllumbat kapeshin në rrjeta dhe shumoheshin në ferma. Nili, ofronte një burim plot me peshq. Bletët, gjithashtu, janë zbutur të paktën që nga Mbretëria e Vjetër dhe siguronin mjaltë dhe dyllë. Egjiptianët e lashtë përdornin gomarët dhe qetë (kijet) si kafshë pune për të lëvruar tokat. Kuajt dhe devetë, ndonëse të njohura në Mbretërinë e Re, filluan të përdreshin si kafshë pune vetëm në Periudhën e Vonë. Qentë, macat dhe majmunët ishin kafshë shtëpiake të zakonata.

Zejtaria dhe tregtia ishin veprimtari fitimprurëse. Egjiptasit punonin artizanate nga bakri, bronzi, hekuri, ari, argjendi, druri. Punonin edhe enë prej balte. Këto produkte bashkë me prodhime të tjera bujqësore, i shisnin brenda dhe jashtë vendit. Komunikimi tregtar ndikoi pozitivisht në gërshetimin e kulturave të ndryshme dhe ndihmoi qytetërimin botëror.

SKLLEVËRIT E EGJIPTIT




### Formimi i shtetit të Egjiptit

Në mijëvjeçarin IV para Krishtit, në Egjipt u formuan njësi të mëdha territoriale me tipare shtetërore. Në vitin 3200 këto shtete të vogla u bashkuan në një mbretëri të vetme. Kryeqytet i Egjiptit të bashkuar u caktua Memfisi. Në krye të Mbretërisë qëndronte mbreti i cili u quajt faraon. Pas vdekjes së tij, faraonin e trashëgonte i biri. Varrezat e faraonëve quheshin piramida. Në piramida nuk mund të varrosej askush tjetër përpos faraonit dhe anëtarëve të familjes së tij. Piramida më e njohur është ajo e faraonit Keops.

Ajo u ndërtua nga mesi i mijëvjeçarit të tretë para Krishtit. Ka një lartësi prej 146m dhe gjatësinë e çdo brinje të bazës e ka 227 m. Përbëhet nga 2 500 000 blloqe me masë prej 2 deri në 5 tonë secila. Në mijëvjeçarin e dytë para Krishtit, kryeqytet i Egjiptit u emërua Teba. Egjiptianët patën mosmarrëveshje me popujt e tjerë dhe luftuan kundër tyre.

 FARAONI TUTANKHAMON



### Fjalori

**Faraon** - kështu quhej mbreti në Egjipt.

**Shkurtra** - kokrrat e kësaj bime përdoren për ushqim.



### TË PUNOJMË SË BASHKU

Pse njerëzit e qytetërimeve të para jetonin afër luginave të lumenjve? Duke hulumtuar në internet, shkruani ese për faraonët: Hatshepsut, Kleopatra, Tutankhamon dhe Keops!

## II

## 8. QYTETËRIMI NË MESOPOTAMI DHE PERSI

**Mesopotamia - shtrirja dhe popullsia**

Fjala Mesopotami rrjedh nga greqishtja, e që në përkthim të drejtpërdrejtë do të thotë "midis dy lumenjve". Pra Mesopotamia ishte territor që shtrihej midis dy lumenjve, Tigër dhe Euftrat. Territori i saj përfshinte Mesdheun Lindor, malet e Zagros, një pjesë të Irakut të sotëm dhe disa pjesë të Iranit, Sirisë dhe Turqisë së sotme. Në Mesopotami lindën perandoritë dhe civilizimet e rëndësishme dhe për këtë arsye ky vend njihet si djepi i qytetërimit. Në mijëvjeçarin V para Krishtit, Mesopotamia ishte populluar nga sumerët të cilët kishin zbritur nga malet e Iranit dhe Indisë. Rreth shekullit XIX para Krishtit u njoh qyteti Babilon sipas të cilit e mori emrin mbretëria e Babilonisë.

KODI I HAMURABIT **Mbretëria e Babilonisë - Ligjet e Hamurabit**

Babilonia shtrihej në një vend shumë të përshtatshëm. Aty kryqëzoheshin rrugët nëpër të cilat kalonin karvanët tregtarë të ngarkuar me mallra të ndryshme. Bashkimi i Mesopotamisë në një shtet të vetëm u realizua në kohën e mbretit Hamurab. Në periudhën e qeverisjes së Hamurabit në këtë vend u zhvillua bujqësia, blegtoaria, zejtaria, arti, kultura, feja, drejtësia, shkollat dhe profesionet e ndryshme.

Kodi i Hamurabit ishte një nga kodet ligjore më të hershme dhe më të plota, të shpallura nga mbreti babilonas Hamurabi, i cili mbretëroi nga viti 1792 deri në vitin 1750, para Krishtit. Kodi i Hamurabit është një përmbledhje e 282 rregullave të përcaktuara në shoqërinë babilonase. Kodi i Hamurabit ishte gdhendur në një pllakë të madhe në gurë të zinj të qëndrueshëm por tepër të vështirë për t'u shkruar.

Kodi i Hamurabit përfshinte shumë ndëshkime të ashpra, ndonjëherë duke kërkuar heqjen e gjuhës, të duarve, të gjinjve, të syrit apo të veshit të fajtorit.

**Disa nga ligjet e Hamurabit**

*Nëse një njeri vidhte një ka, ai duhej të paguante 30 herë vlerën e tij.*

*Kush strehonte një skllav të arratisur, do të vritej.*

*Nëse një borxhli nuk e kthente borxhin në kohën e caktuar, ai së bashku me gruan dhe fëmijët e tij binin në skllavëri.*

*Një person i akuzuar konsiderohej i pafajshëm deri sa të vërtetohej fajësia e tij.*

*Nëse një skllavopronar vriste skllavin e huaj, detyrohej t'ia jepte të vetin.*

*Nëse një njeri godiste një grua shtatzënë dhe gruaja e humbte foshnjën e palindur, ai duhej të paguante dhjetë sikla për dëmin e shkaktuar.*



## Persia - një vend me fusha pjellore, male të larta dhe shkretëtira

Persia shtrihej në Azinë Jugperëndimore, e lidhur me zonën e Iranit të sotëm. Termi “Persia” është përdorur për shekuj me radhë dhe ka origjinën nga një rajon i Iranit jugor, i njohur më parë si Persi, ose si Përs apo Parsa.

Fiset persiane jetonin në Azinë e Mesme, në rrafshnaltën e Iranit të sotëm. Persia ishte një vend i rrethuar me male të larta dhe të pasura me ar, argjend, bakër, hekur, plumb etj. Një pjesë tjetër e vendit ishte shkretëtirë, por kishte edhe fusha të gjera në të cilat zhvillohej bujqësia. Aty kultivoheshin drithërat si: gruri, elbi, meli dhe pemët frutore si: dardhat, mollët, ftonjtë, pjeshkat, vishnjat etj.

## Mbretëria e Persisë

Në shekullin VI para Krishtit, fiset persiane u bashkuan nën udhëheqjen e Kirit II dhe formuan Mbretërinë e Persisë. Territorët e kësaj mbretërie shtriheshin nga shkretëtira e Saharasë deri në luginën e lumit Ind. Ato përfshinin vendet e pushtuara në Azinë e Vogël, Babiloni, por edhe një pjesë të Egjiptit. Shteti persian fuqinë më të madhe e arriti në kohën e sundimit të Darit I (521-486). Dari vazhdoi luftën për zgjerimin e territoreve në drejtim të Kaukazit për të kaluar në Evropë dhe për t’u shpallur sundimtar i tri kontinenteve. Mirëpo planet e tij nuk u realizuan, sepse ushtria e tij u ndesh me forcën e ushtrisë greke. Në luftërat greko-persiane (500-449), ushtria e Darit u thye rëndë nga ushtria greke. Pas humbjes nga grekët, shteti persian u dobësua shumë. Në gjysmën e dytë të shekullit IV para Krishtit u pushtua nga Leka i Madh i Maqedonisë dhe në këtë mënyrë Mbretëria Persiane mori fund.



## Fjalori

**Kodifikim** - përmbledhje e ligjeve.

**Sikla** - vlerë monetare.

SHTRIRJA E MESOPOTAMISË



## TË PUNOJMË SË BASHKU

Duke analizuar ligjet e Hamurabit, vlerësoni nëse do të ishin të dobishme në kohën tonë dhe arsyetoni pse!

Diskutoni për personalitete të shquara babilonase dhe persiane!

## II

## 9. QYTETËRIMI NË INDI DHE NË KINË



POPULLSIA INDIANE

**India**

Në kohët më të vjetra, India ka qenë djep i qytetërimit antik. Midis mijëvjeçarëve III dhe II para Krishtit, popullsitë që jetonin përgjatë luginës së Indit (lumi që i dha emrin Indisë) ndërtuan qytete të mëdha – Mohenjo-Daro, Harapa.

Banorët e parë të këtij vendi ishin dravidët, kurse nga viti 1600 para Krishtit në Indi jetonin **arianët**, popullsi nomade që dallohej nga popullsitë e tjera. Arianët njihnin bronzin dhe zotëronin karroca të shpejta lufte, të tërhequra nga kuajt. Indianët ishin bujq të shquar. Ata kultivonin grurin, elbin, pjeprin, hurmën dhe ishin të parët në botë që kultivuan

pambukun. Nga kafshët shtëpiake këta rrisnin derrat, kuajt, buajt, lopët etj. India përgjatë shekujve u pushtua shpeshherë. Atë e goditën ushtria e Darit (shek.VI para Krishtit), Aleksandri i Madh (shek. IV para Krishtit) dhe më vonë arabët, osmanët dhe mongolët.

Në shekullin IV para Krishtit, nga disa principata të vogla u formua një mbretëri e vetme indiane. Në këtë kohë qytetërimi indian pati shkëlqimin e tij më të madh artistik, letrar dhe filozofik.

Indianët i kushtuan vëmendje të veçantë edhe besimit.

Fetë dominuese në Indi ishin hinduizmi dhe budizmi.

Shoqëria indiane ishte e ndarë në kasta. Kriter për ndarjen në kasta ishte pasuria. Kasta përfshinte këto grupe shoqërore: bramanët, luftëtarët, tregtarët dhe fshatarët. Kalimi nga një kastë në tjetrën ishte i ndaluar. Edhe martesat në mes personave që u takonin kastave të ndryshme, nuk ishin të lejuara.



### Qytetërimi kinez

Kina ishte një nga vendet më të veçanta të qytetërimeve të lindjes. Kinezët jetonin në luginën e lumit Hoang-Ho, që në shqip do të thotë “Lumi i Verdhë”, që nga mijëvjeçari II para Krishtit. Ata kultivonin orizin, krimbin e mëndafshit, dhe gjithashtu e kishin të zhvilluar zejtarinë dhe tregtinë. Kinezët tregtonin prodhimet e tyre si enë porcelani, prodhime tekstili dhe pambuku.

Sipas legjendës, vendi u bashkua në vitin 221 nga një mbret i familjes Çin. Prej këtyre erdhi edhe emri Kinë. Perandorët kinezë, për t'u mbrojtur nga nomadët e veriut e të perëndimit, ndërtuan shumë mure por më i njohuri ishte ai që u quajt Muri Kinez.

Ky monument përbën një kryevepër të arkitekturës botërore dhe vlerësohet si një nga shtatë mrekullitë e botës. Muri Kinez, sipas rezultateve nga hulumtimet arkeologjike, është i gjatë rreth 4000 kilometra, i lartë 10 metra dhe i gjerë 8 metra. Për gjatësinë e murit ka edhe mendime të tjera të ndryshme. Në punimet e murit morën pjesë rreth 2 milionë njerëz. Nën sundimin e dinastisë Han dhe Tang, qytetërimi kinez bëri përparime të mëdha në letërsi, në shkenca, në teknikë. Kinezët shpikën letrën, busullën, barutin. Kështu, Kina u bë një burim i madh furnizimi e tregtie për perëndimin.



### Fjalori

**Nomadë** - njerëzit që nuk kanë vendbanim të përhershëm, endacakë, shtegtarë.

**Dinasti** - familje udhëheqëse mbretërore.

**Porcelan** - lëndë e bardhë, e shkëlqyeshme, që nuk e thith ujin dhe që përgatitet nga një lloj argjile. Përdoret për të bërë enë, gota etj.

**Busulla** - mjet për orientim në hapësirë.



MURI KINEZ



### TË PUNOJMË SË BASHKU

Çka mendoni për kastat? A do të ishte diskriminuuese ndarja e shoqërisë në shtresa në kohën tonë dhe pse?

Përveç Murit Kinez, a dini edhe ndonjë monument tjetër që hyn te “shtatë mrekullitë e botës”?




## II

10. KULTURA DHE BESIMI TE POPUJT  
E LINDJES SË LASHTË

**Diskutim: Si do të ishte jeta jonë, nëse nuk do zbulohesh shkrimi?**



SHKRIMI HIEROGLIFIK 



SHKRIMI KUNEIFORM 

### Shkrimi dhe dituritë

Në Egjipt dhe Mesopotami nga mijëvjeçari IV para Krishtit kishte filluar zhvillimi i diturive, të cilat u shfaqën si gojëdhëna e tregime. Këto tregime, egjiptianët filluan t'i shkruanin në gurë, në drunj, në pllaka e pëlhurë liri, kurse më vonë në një lloj letre e cila prodhohej nga bima e quajtur Papirus. Shkrimi egjiptian u quajt hieroglifik dhe shkruhej me figura e vizatime.

Mesopotamët shkruanin në pllaka balte. Ata nisën të shkruajnë me një shkop në formë trekëndëshi ose kunj. Ky shkrim u quajt kuneiform apo shkrimi kunjor.

Në Kinë ishte zhvilluar një formë e veçantë e shkrimit figurativ me një numër të madh të shenjave të stilizuar. Ndërsa fenikasit kishin shpikur alfabetin fonetik me 24 shkronja, të cilin më vonë e përdorën grekët e romakët dhe mori përhapje të gjerë duke ndikuar në rritjen dhe zhvillimin e qytetërimit botëror.

### Shpikjet dhe shkenca

Popujt e lindjes ishin të parët që ndërtuan kanale të ujitjes për të mos qenë të varur vetëm nga shiu. Ata ndërtuan pallate, piramida, tempuj, kanalizime dhe ndërtime të tjera. Të gjitha këto së bashku ndikuan në lindjen e matematikës dhe të gjeometrisë. Egjiptasit i zhvilluan dijet nga fusha e mjekësisë dhe zbuluan vlerën e numrit Pi (3,14) që edhe sot mësohet në matematikë. Hartuan kalendarin sipas të cilit viti ndahej në 365 ditë. Mesopotamët kishin mësuar të llogaritnin rrënjën katrore dhe rrethin 360 shkallë. Ata bënë hapat e parë edhe në astronomi. Shpikja më e veçantë e tyre ishte rrota. Kinezët zbuluan busullën me anë të së cilës njerëzit më lehtë orientoheshin në natyrë.

### Letërsia dhe arti

Zbulimi i shkrimit nga egjiptasit (hieroglifet), mesopotamët (kuneiform), fenikasit (alfabeti fonetik) ndihmoi në shkrimin e veprave letrare. Egjiptasit, indianët dhe mesopotamët shkruan tregime kushtuar perëndive, shkrime historike etj. Tregimet më të njohura ishin: “Tregimi mbi përjetimin e fatkeqësisë në det”, “Epi i Gilgameshit”, “Historia e Jaya dhe Vijaya”, (që ishin derëtarët me vendbanimin qiellor të Vishnu perëndi indiane) etj.



 GUADAMA BUDA

*Epi i Gilgameshit ishte një ndër veprat më të mira të lashtësisë. Është shkruar rreth 4000 vjet më parë në 12 pllaka deltime, me shkrim kuneiform dhe i takon ciklit të rrëfimeve për trimat. Në të tregohet për Gilgameshin, mbretin legjendar të Urukut, i cili, së bashku me mikun e tij Enkidu kishin treguar trimëri të padëgjua deri atëherë. Ata luftonin kundër përbindëshave, të cilët u sillnin njerëzve fatkeqësi.*



Zbulimet arkeologjike na ofrojnë dëshmi se popujt e lindjes së lashtë njihnin edhe artet si: pikturën, skulpturën, reliefet dhe muzikën. Me figura të shumta bënin edhe mozaikë të ndryshëm.

### **Besimi i popujve të Lindjes së Lashtë**

Popujt e lindjes së lashtë besonin në shumë perëndi. Pra, ishin politeistë. Në Egjiptin e Vjetër ishte ruajtur tradita e besimit në kafshët-Totemizmi. Më zhvillimin e bujqësisë u shfaqën besimet të dielli, qielli, shiu etj. Respektin më të madh, egjiptasit e treguan ndaj zotit të diellit, që quhej Amon-Ra. Gebi ishte zot i tokës, kurse Set quhej zoti i shkretëtirës dhe simbolizonte të keqen. Ndërsa perënditë e bujqësisë ishin Ozirisi dhe Izida. Egjiptasit besonin në jetën pas vdekjes dhe tregonin respekt për të vdekurit. Në varre, pranë mumies i vendosnin armët që kishte përdorur i vdekuri, ushqime, veshmbathje etj. Respekt i veçantë u bëhej faraonëve me rastin e vdekjes. Edhe në Mesopotami perëndia më e rëndësishme ishte zoti i diellit, që quhej Marduk. Ata besonin edhe në perënditë e bujqësisë - Tamuz dhe Ishtar.

Indianët kishin shfaqur gjithashtu veçantitë e tyre ku dominonte kulti i perëndive Brahmas-krijuesi i botës, Vishnes-zot i së mirës dhe Shides zot i së keqes. Në Indi në shekullin VI para Krishtit u shfaq një besim i ri i cili u quajt budizëm sipas themeluesit të tij Guadama Buda. Ai besohet të ketë jetuar dhe mësuar më së shumti në pjesën lindore të Indisë së lashtë.

Kinezët besonin në kultin ndaj tokës dhe maleve. Në besimin e tyre ndikim të madh kishte besnikëria ndaj shpirtave, traditës dhe respektimi i paraardhësve. Ata gjithashtu besonin në jetën pas vdekjes.



### **Fjalori**

**Piramida** - varret e faraonëve.

**Tempull** - vend i shenjtë.


**Astronomia** - shkencë që merret me studimin e trupave qiellorë.


**Epi** - gjini letrare që paraqitet në formë tregimi, në vargje ose në prozë. Vepër heroike e lavdishme e një populli ose një njeriu.

**Mumie** - kufomë njeriu e balsamosur a e tharë që nuk priset për një kohë të gjatë. Mumiet e faraonëve.

**Reliev** - gdhendje në dru, në gur ose në metal. Vepër skulpture e gdhendur mbi një sipërfaqe.

**Mozaiku** - zbukurim, portret etj., që bëhet me copëza shumëngjyrëshe guri, mermeri, xhami, metali etj.





# QYTETËRIMET E MESDHEUT NË ANTIKITET

## III

## 11. QYTETËRIMET E POPUJVE QË JETONIN NË BRIGJET E DETIT TË MESDHEUT

Historia e popujve mesdhetarë përfshin popujt që jetonin në brigjet e deteve Adriatik, Jon, Egje dhe pjesën evropiane të detit Mesdhe. Duke filluar që nga mijëvjeçari II para Krishtit, në këto brigje u shfaqën kultura dhe qytetërime të ndryshme. Në mes të tyre më të njohurat janë: kultura pellazge, ilire, fenikase, hebraike, minoike, greke, romake etj.

### Pellazgët

Sipas mitologjisë, në mesin e mijëvjeçarit III-II para Krishtit erdhën nga stepat e Lindjes grupe të reja popullatash që merreshin me blegtori. Ata u gërshtetuan me banorët vendës duke krijuar bashkësi të re kulturore në Gadishullin Ballkanik. Kjo popullsi mendohet të jetë popullsia e lashtë pellazge. Pellazgët u shtrinë edhe në Azi të Vogël, në Sicili dhe në Itali të Jugut. Ata ishin bujq dhe detarë të njohur. Ishin edhe mjeshtër të mirë ndërtimi të pallateve e fortifikatave. Të dhëna për pellazgët gjejmë të Homeri, Hesiodi, Herodoti, Straboni dhe dijetarë të tjerë grekë e romakë. Ata flasin për shtrirjen, për mënyrën e jetës, për gjuhën etj. Herodoti vërteton se gjuha e pellazgëve ishte e ndryshme nga gjuha greke. Sipas shumë studiuesve shqiptarë e të huaj, pellazgët ishin paraardhësit e ilirëve.

### Qytetërimi fenikas

Në mijëvjeçarin III para Krishtit ishin vendosur në jug të Azisë në një rrip toke në bregdet. Duke jetuar afër detit ata u bënë lundëtarë, peshkatarë, tregtarë dhe zejtarë të shquar. Prodhimet e tyre i tregtonin me popujt e tjerë të Mesdheut. Ata krijuan disa qytet-shtete si Tiri, Bilboja e Sidoni. Fenikasit krijuan edhe koloni në Sicili, në Spanjë dhe në Afrikën Veriore. Fenikasit bënë një nga shpikjet më të rëndësishme të kohës - alfabetin.

Gjatë udhëtimeve tregtare dhe krijimit të kolonive, fenikasit përhapën alfabetin e tyre që shumë shpejt gjeti përdorim të gjerë. Këtë alfabet e përvetësuan edhe grekët, më pas romakët dhe popujt e tjerë të Mesdheut.

### Qytetërimi hebraik

Historia hebraike fillon me ardhjen e tyre nga Mesopotamia dhe krijimin e ngulimeve të tyre në jug të Fenikisë ku ishin të vendosur edhe popullsia filistine. Hebrejntë dhe filistinët patën një konflikt të gjatë mes vete. Për qindra vjet me radhë ata jetuan në 12 fise. Këto fise në mijëvjeçarin I para Krishtit u bashkuan dhe formuan mbretërinë e tyre. Në krye të mbretërisë u vu Sauli. Pas tij erdhi mbreti David, i cili fuqizoi pozitën e shtetit dhe e bashkoi në mbretërinë e tij qytetin e Jerusalemit. Pas Davidit pushtetin e trashëgoi pasardhësi i tij Solomoni. Solomoni ndërtoi tempullin e parë në malin Moriah në Jerusalem. Pas vdekjes së Solomonit fiset

Ⲁ	ALEPH
Ⲃ	BET
Ⲅ	GIRNEL
Ⲇ	DALET
Ⲉ	HE
Ⲋ	VAV
Ⲍ	ZAYIN
Ⲏ	HET
Ⲑ	TET
Ⲓ	YOD
Ⲕ	KAPH
Ⲗ	LAMEL
Ⲙ	MEM
Ⲛ	NUN
Ⲝ	SAMEKH
Ⲟ	AYIN
Ⲡ	PE
Ⲣ	SADE
Ⲥ	QOPH
ⲧ	RESH
ⲩ	SHIN
ⲫ	TAV

hebraike u përçanë shumë duke u thyer politikisht. Më pas shpërtheu një luftë civile në mes dhjetë fiseve izraelite veriore dhe fiseve të Judës dhe Benjaminin në jug. Populli hebre u nda në mbretërinë e Izraelit në Veri dhe mbretërinë e Judës në jug me kryeqytet Jerusalemin. Hebrenjtë i dhanë qytetërimit botëror për herë të parë besimin në një zot të vetëm, pra besimin monoteist. Për këtë popull, Jehovahi ishte krijuesi i vetëm i njerëzve dhe drejtonte çdo gjë që ndodh rreth tyre.

### Qytetërimi i Kretës (minoikut) dhe Mikenës

Kretasit e vjetër gjendeshin në një shkallë më të lartë zhvillimi se grekët dhe popujt e tjerë. Ishulli i Kretës luante një rol të rëndësishëm në kulturën e botës së Egjeut. Qytetërimi minoik lindi rreth shekullit III para Krishtit në ishullin e Kretës. Kjo kulturë e mori emrin minoike për nder të mbretit të Kretës, i cili quhej Minos. Sipas legjendës, mbreti Minos i kishte dhënë urdhër mjeshtrit të famshëm Dedali për të ndërtuar një pallat të madh në qytetin e Knosit. Pallati kishte shumë dhoma e kthina të ndryshme, ku ishte lehtë të hyje dhe shumë vështirë të dilje. Kretasit këtë ndërtesë e quajtën labirint. Në këtë pallat kishte shumë piktura, qeramika dekorative dhe vepra të tjera artistike. Në fund të mijëvjeçarit III, kretasit njohën alfabetin piktografik të shkruar në argjilë, gur dhe metal. Kretasit besonin në shumë perëndi. Ata kishin respekt në radhë të parë për kultin e hyjnisë femërore, kurse në rend të dytë respektonin kultin e hyjnisë mashkullore. Kultura minoike vuri bazat e qytetërimit të kohës, të kulturës materiale dhe shpirtërore që u pasua nga grekët, romakët dhe popujt e tjerë të Mesdheut. Kultura e Mikenës e mori emrin sipas qytetit Mikenë që gjendej në Argolidë të Peloponezitet. Në shumë qytete ndërtuan pallate të fortifikuara. Bartës të kësaj kulture ishin akejt, të cilët konsiderohen si paraardhës të grekëve. Ata përvetësuan mënyrën e shkrirjes së metaleve e sidomos atë të bronzit. Nga bujqësia ata njohën kultivimin e grurit, thekrës, elbit, tërshërës, hardhinë e rrushit dhe të ullirit. Arti në Mikenë u zhvillua nën ndikimin e kulturës minoike të Kretës. Kultura e Mikenës shënon fazën e fundit të kulturës së Egjeut dhe fazën e parë të kulturës greke.



## Fjalori

**Labirint** - ndërtesë me shumë kthesa e korridore nga e cila është vështirë të dilet.

**Mitologji** - pasqyrimi fantastik i botës në ndërgjegjen e njerëzve në periudhat më të hershme të jetës së popujve. Përpyetje për të shpjeguar dukuritë e pakuptueshme të natyrës e të shoqërisë.

**Monoteist** - ai që beson vetëm në një perëndi.



## TË PUNOJMË SË BASHKU

Ndahuni në katër grupe dhe secili grup le ta lexojë e ta prezantojë pjesën e vet! Shpjegoni pjesën më të pëlqyer dhe arsye toni pse ju ka pëlqyer!





# IV

QYTETËRIMI NË  
GREQINË E LASHTË



## 12. QYTETËRIMI GREK



**Diskutim: Si do të dukeshin sot lojërat olimpike pa pjesëmarrjen e grave?**

### Shtrirja e Greqisë së Lashtë

Greqia e Lashtë ishte një gadishull i madh i rrethuar nga tri anët me dete: nga deti Mesdhe, deti Jon në perëndim dhe deti Egje në lindje. Shtrihej në pjesën jugore të Siujdhesës Ballkanike e cila përfshinte edhe ishuj që gjendeshin në detet Egje dhe Jon si dhe në bregdetin perëndimor të Azisë së Vogël. Greqia ndahej në tri pjesë: Greqia Veriore, Greqia e Mesme dhe Greqia Jugore, apo si quhet ndryshe Peloponezi. Të gjitha këto rajone kishin qendrat e veta të zhvillimit ekonomik, kulturor e shtetëror. Krahina kryesore në Greqinë Veriore ishte Thesalia, në Greqinë e Mesme ishin Atika dhe Beotia, kurse në Peloponez shquheshin Lakonia në jug dhe Arkadia në veri. Ujdhesat e shumta në detin Egje dhe Jon si dhe kushtet bregdetare ndikuan që grekët të bëheshin detarë të shquar. Përveç pjesës bregdetare, Greqia njihej edhe me toka pjellore dhe me male të larta e të thepisura.

### Formimi i popullit grek


Dyndja e fiseve paragreke si: akejt, dorët, jonët në mijëvjeçarin II para Krishtit dhe vendosja e tyre në Thesali, Atikë, Beoti, Mikenë, Kretë dhe Peloponez ndikoi në përzierjen me fiset paragreke. Ky gërshetim fisesh solli formimin e popullsisë greke. Grekët ndërtuan kështjella në shumë vende që i populluan. Ata u bënë shpejt të njohur për lundrim e tregti. Prodhimet e veta i tregtonin me popujt e Mesdheut dhe me tregtarët e Lindjes së Lashtë. Grekët u njohën edhe si luftëtarë të shquar.

### Organizimi politik

Në Greqi, bashkësitë politike kishin një territor të vogël - Polisin (qytet-shtet). Polisi udhëhiqej nga një apo më shumë prijës, të cilët quheshin bazileus (mbret). Mbretërit e vegjël në kohë lufte e kishin rolin e komandantëve të ushtrisë, ndërsa në kohë paqeje ushtronin funksionin e gjyqtarit dhe të përfaqësuesit shpirtëror. Ekzistonin edhe disa institucione politike si Këshilli i Pleqve, në të cilin merrnin pjesë njerëzit më të pasur të fiseve dhe Kuvendi i qytetarëve në të cilin merrnin pjesë të gjithë njerëzit e lirë. Këto institucione merrnin vendime të rëndësishme për bashkësinë politike, si dhe për luftën e për paqen.

## Grekët e vjetër besonin në shumë perëndi

Grekët besonin në shumë perëndi. Ata u luteshin zotave për familjet e tyre, për prodhimet bujqësore, kur shkonin në peshkim e gjueti, në luftëra etj. Ata besonin se perënditë e përcaktonin fatin e njerëzve. Grekët përvetësuan perënditë e tyre të cilave u luteshin çdo ditë. Perëndia kryesore ishte Zeusi, i cili mendohej se jetonte në malin Olimp. Hera ishte gruaja e Zeusit dhe mbrojtëse e familjes dhe e bashkëshortësisë, Hadi ishte vëllai i Zeusit dhe perëndi e nëntokës, Athina ishte bija e Zeusit dhe ishte perëndesha e urtësisë dhe mençurisë, Apoloni ishte zot i dritës, Afërdita ishte perëndesha e bukurisë, Aresi ishte perëndi i luftës, Artemisi ishte perëndesha e gjahut, Poseidoni ishte perëndia e detit, Hefesti ishte zot i farkëtarisë, Hermes ishte lajmëtar i perëndive, Dionisi zot i rrushit dhe i verës etj.



## Pse organizoheshin Lojërat Olimpike?

Grekët e vjetër njihen si organizatorë të festave dhe të aktiviteteve të ndryshme. Organizimi i tyre kryesor ishin Lojërat Olimpike, të cilat shprehnin respekt ndaj Zeusit. Ato mbaheshin në malin e Olimpit çdo katër vjet. Mendohet se për herë të parë Lojërat Olimpike u organizuan në vitin 776 para Krishtit. Në këto lojëra ishte e ndaluar të merrnin pjesë të huajt, skllevërit dhe gratë. Aty organizoheshin gara në shumë disiplina si: hedhje shtize, hedhje disku, vrapime, mundje, mundje trup më trup, gara e vrapime me karroca me kuaj etj. Gjatë kohës kur zhvilloheshin Lojërat Olimpike, ndërpriteshin armiqësitë në mes grekëve, por edhe luftërat me popujt e tjerë. Lojërat u bënë një mjet politik i përdorur nga qytetshiteti për të vendosur dominimin mbi rivalët e tyre. Politikanët i shfrytëzonin për aleanca politike. Priftërinjtë bënë flijime për nder të perëndive. Lojërat u përdorën gjithashtu për të ndihmuar në përhapjen e kulturës greke në gjithë Mesdheun. Fituesit e garave shpërbleheshin me kurorën e ullirit që u vihej në kokë.



## Fjalori

**Dyndje** - shpërngulje masive e një populli.

**Gjyqtar** - ai që ndan drejtësinë.

**Disiplina** - degë të sportit, disiplina sportive.

**Flijim** - sakrificë. Ai që jep jetën për një çështje të madhe, për interesat e atdheut.

## IV

## 13. ARSIMI, KULTURA DHE SHKENCA NË GREQI - PJESË E QYTETËRIMIT ANTIK

### Shkolla dhe teatri

Në shoqërinë greke, në lashtësi, fëmijët deri në moshën 7-vjeçare edukoheshin në shtëpi, ndërsa nga moshë 7-14 vjeç edukoheshin në shkollë. Prindërit e fëmijëve ishin të detyruar të paguanin taksa për t'u mësuar fëmijëve të tyre shkërimin, leximin, llogaritjen si dhe njohuri të tjera për letërsinë, muzikën, historinë, filozofinë dhe dituri të tjera. Të rinjtë e moshës 15-18 vjeçare fitonin njohuri të reja në shumë fusha. Shumica prej tyre synonin të mësonin artin ushtarak, sepse fitonin të drejtën të bëheshin edhe komandantë të ushtrisë. Komandantët e ushtrisë greke kishin shumë privilegje.

Mendohet se teatri lindi në Athinë në shekullin VI para Krishtit në festat që organizonin bujqit dhe fshatarët për nder të Perëndisë Dionis që e konsideronin si mbrojtës të hardhisë së rrushit dhe të prodhimeve bujqësore. Aty këndoheshin këngë dhe hidheshin valle popullore.

Më vonë në lojë u fut edhe aktori. Aktorët bënin shfaqje dhe e argëtonin popullin. Në këtë mënyrë filloi teatri. Në fillim u ndërtuan teatro të vogla. Teatri më i madh i kohës u ndërtua në shekullin IV para Krishtit në Athinë. Aty mund të zinin vend rreth 1700 spektatorë. Teatri ndikoi në krijimin edhe të veprave dramatike si tragjedia dhe komedia.

### Filozofia dhe shkenca ndryshuan të menduarit për botën

Dijetarët e parë dhe filozofët grekë vinin nga qytetet e Azisë së Vogël dhe Jonisë. Ndër to u dallua Mileti, vendlindja e filozofit të njohur - Talesit. Talesi kishte hapur një shkollë të filozofisë, ku edukonte nxënësit e tij. Filozofët e shkollës së tij, Anaksimani e Anaksimandri, thanë se nuk mund të paramendohet jeta pa ujë dhe ajër. Filozofët më të njohur grekë ishin Platoni dhe Aristoteli. Platoni themeloi shkollën filozofike që u quajt "Akademi". Ai mendonte se për të pasur një shtet të përparuar, atë duhet ta udhëheqin filozofët, ta mbronin ushtarët, ndërsa zejtarët, tregtarët, fshatarët e lirë dhe skllëvërit duhet të punonin për filozofët dhe ushtarët. Aristoteli, gjithashtu i takon plejadës së dijetarëve të mëdhenj. Ai ishte mësues i Aleksandrit të Madh.

Përveç filozofisë, u zhvilluan edhe shkencat e tjera. Zhvillim të hovshëm njohën matematika, mjekësia, astronomia, historia etj. Hipokrati bëri studimin e trupit të njeriut duke bërë përpjekje për të shëruar sëmundjet. Ndër historianët më të njohur ishin Herodoti dhe Tukididi.



### Letërsia dhe arti si vlera të përgjithshme

Grekët krijuan vepra të shumta letrare. Ata zhvilluan shumë prozën dhe poezinë. Ndër veprat të cilat patën shumë ndikim në shoqërinë ishin “Iliada” dhe “Odisea” të shkruara nga Homeri. Ndër shkrimtarët e letërsisë epike dhe lirike u shquan Hesiodi me veprën “Krijimi i Zotrave”, Alkeu, Safo (poeteshë), Pindari etj. Shkrimtarët grekë në veprat e tyre letrare e historike shkruanin për dashurinë, dhembjen, urrejtjen, gëzimin, luftën, heroizmat, heronjtë etj. Veprat e tyre u gërshetuan edhe me dijetarë e shkrimtarë romakë, ilirë dhe autorë nga qytetërimi i Lindjes së Lashtë.

Grekët e zhvilluan edhe arkitekturën, pikturën, skulpturën.



 AKROPOLI

Ndërtimi më i famshëm grek ishte Akropoli i Athinës. Ata ndërtuan edhe ndërtesa të ndryshme, shtëpi, sheshe, tempuj etj. Tempujt më të njohur janë tempulli i Partenonit dhe i Poseidonit. Skulptura njohu zhvillim të madh. U punuan shtatore nga druri, guri, mermeri, bronzi dhe materiale të tjera. Letërsia dhe arti, duke u gërshetuar me popujt e tjerë, u bënë vlera të përgjithshme të qytetërimit antik.



### Fjalori

**Privilegj** - e drejtë e veçantë që kanë njerëzit e caktuar.

**Teatër** - vendi ku luhen shfaqjet, dramat, komeditë etj.

**Komedi** - lloj gjinie dramatike, gazmore që i bën njerëzit për të qeshur.

**Tragjedi** - gjini dramatike e shfaqjes në teatër.



### TË PUNOJMË SË BASHKU

Improvizoni në klasë një skenë teatri me spektatorë dhe luani nje komedi!  
Pse filozofia, shkenca dhe dijet e tjera ndryshuan botën?

## IV

14. ATHINA DHE SPARTA  
SHTETE SKLLAVOPRONARE

## ATHINA

**Formimi i shtresave shoqërore dhe konflikti në mes të aristokracisë dhe demosit**

Qyteti i Athinës shtrihej në Greqinë e mesme në krahinën e Atikës. Athinasit ishin të njohur për kultivimin e hardhisë së rrushit dhe ullirit. Në shekullin VII-VI para Krishtit, tokat bujqësore u bënë pronë e një pakice njerëzish, përfaqësues të aristokracisë klanore të cilët quheshin eupatridë. Bujqit ishin të detyruar të punonin me qira tokat e eupatridëve, të cilëve duhej t'u jepnin 5/6 e prodhimit. Në rast se nuk mund të paguanin, apo vononin borxhin ata, së bashku me familjet e tyre, ktheheshin në skllavë.

Prodhimi bujqësor, artizanal dhe tregtia shënuan rritje. Kjo ndikoi në formimin e shtresave të pasura dhe të mesme tregtare e zejtare, të cilët bashkë me fshatarët, formonin një shtresë shoqërore që quhej demos (popull). Shtresa e fundit, pa asnjë të drejtë politike e njerëzore, ishin skllavërit.


Kështu u krijuan dy shtresa të njerëzve të lirë: aristokracia që përbëhej kryesisht nga skllavopronarët dhe pronarët e mëdhenj të tokave dhe demosit. Këto dy shtresa ishin në konflikt të vazhdueshëm me njëra-tjetrën. Lufta në mes të demosit dhe aristokracisë në Athinë zgjati rreth 100 vjet. Fitorja e parë e demosit u arrit në vitin 621 para Krishtit kur aristokracia u detyrua të pranonte ligjet e propozuara nga ligjvënësi Drakon. Këto ligje njiheshin si shumë të ashpra dhe kufizonin dominimin e aristokracisë. "Ashpërsia e ligjeve të Drakonit u bë shumë e njohur, prandaj edhe sot kur shqiptohen dënime të rënda përdoret shprehja dënime drakonike".

Pas ardhjes së Solonit në pushtet filloi reforma në shtetin e Athinës. Qëllimi i tij ishte të përfaqësonte interesat e demosit dhe të ngriste

 MONEDHË GREKE



ARISTOKRATË ATHINAS 



mirëqenien dhe aftësinë mbrojtëse të Athinës. Si rezultat i reformave u anuluan borxhet për tokën, u anulua skllavëria për borxhe, athinasit, të cilët ishin të shitur si skllavër për shkak të borxheve, u liruan me pagesë dhe u kthyen në atdhe, u vendos liria e trashëgimisë sipas së cilës secili athinas kishte të drejtë t'ia linte trashëgim pasurinë e vet kujtdo që dëshironte etj.

Pas Solonit, në krye të shtetit erdhi Klistheni. Ai e mbështeti qeverisjen e tij në ndarjen sipas parimit territorial. Klistheni arriti që t'i baraspeshonte përçarjet në mes të aristokracisë dhe demosit. Ai krijoi organe shtetërore përfaqësuese ku përfaqësoheshin të gjitha shtresat e popullsisë përveç skllavërve. Me realizimin e reformave të Klisthenit përfundoi edhe lufta në mes të demosit dhe aristokracisë.

### Demokracia në Athinë

Demokracia (demos - popull dhe kracie - sundim, qeverisje) athinase ishte demokraci skllavopronare. Demokracia në qytet-shtetin e Athinës lindi dhe u zhvillua rreth shekullit V para Krishtit. Ajo përfshiu gjithë territoret që qeveriseshin nga Athina. Shumë studiues mendojnë se demokracia e parë e njohur në botë ka lindur në Athinë. Edhe qytet-shtete të tjera greke u munduan ta ndjekin shembullin e Athinës, por asnjëra nuk ia arriti.

Demokracia athinase ishte një sistem i demokracisë së drejtpërdrejtë, në të cilën qytetarët pjesëmarrës votonin drejtpërsëdrejti ligjet dhe përfaqësuesit e tyre politikë. Mirëpo, jo të gjithë athinasit kishin të drejtë ta shfrytëzonin këtë mundësi.



## Fjalori

**Demos** (nga greqishtja) - popull.

**Aristokracia** - shtresa e njerëzve të pasur.

**Oligarki** - formë qeverisjeje ku pushtetin e kishte në duart e veta një rreth shumë i ngushtë skllavopronarësh e aristokratësh.

**Klerik** - përfaqësues fetar.

 KUVEND ZGJEDHOR NË ATHINË NË KOHËN E DEMOKRACISË



## IV

Të drejtë vote kishin shtetasit e rritur athinas që kishin të drejta politike. E drejta e votës nuk u njihej banorëve të përkohshëm të Athinës, skllëvërve, grave, të varfërve dhe njerëzve që nuk i takonin aristokracisë, as demosit.

**SPARTA****Spartanët, periekët dhe heliotët**

Sparta shtrihej në krahinën e Lakonisë. Shteti spartan u formua në shekullin IX para Krishtit. Popullsia spartane ndahej në tri shtresa kryesore: spartanët, periekët dhe heliotët. Shtresa më e privilegjuar ishin spartanët të cilët kanë qenë të vetmit qytetarë me të drejta të plota. Ata krijuan një mënyrë të re të qeverisjes që u quajt “oligarki”. Në oligarki pushteti udhëhiqej nga një grup i vogël njerëzish.

Grupi i dytë ishin periekët. Ata merreshin me bujqësi, blegtori, zeytari dhe tregti. Ishin njerëz të lirë, por pa të drejta politike. Pra, ata nuk mund ta drejtonin shtetin spartan. Në rast lufte, obligoheshin të merrnin pjesë në ushtrinë spartane si këmbësorë. Shtresën e tretë e përbënin heliotët. Ata ishin të detyruar t’iu paguanin pronarëve spartanë një tatim që arrinte gjysmën e prodhimit bujqësor. Pra, ishin fshatarë të lirë pa të drejta politike.

**Qeverisja e Spartës dhe organizimi politik**

SPARTA ANTIKE 

Sparta qeverisej nga dy mbretër. Ata e kishin edhe autoritetin e përfaqësuesit shpirtëror, pra luanin edhe rolin e kryeklerikëve.



Pushteti i tyre ishte i mbikëqyrur dhe i kufizuar nga një grup përfaqësuesish, që quhej Këshilli i Pleqve (Geruzia). Ky këshill përbëhej nga 28 përfaqësues të familjeve aristokrate spartane. Përveç Këshillit të Pleqve, ekzistonte edhe Kuvendi i Qytetarëve si organi më i lartë politik, ku përfaqësoheshin gjithë spartanët që kishin statusin e qytetarëve me të drejta të plota. Sparta, duke qenë një shtet i rëndësishëm, i kishte të organizuara edhe ushtrinë, financat e shtetit, tatimet, gjyqësinë dhe politikën e jashtme.



PËRKRENARE E USHTARIT  
GREK



## TË PUNOJMË SË BASHKU

Po të ishit ju udhëheqës i shteteve skllavopronare si Athina dhe Sparta, si do ta qeverisnit shtetin?

Krahasoni demokracinë athinase me demokracinë e kohës sonë! Nxirrni të përbashkëtat dhe dallimet!



## IV

## 15. LUFTËRAT GREKO-PERSIANE DHE LUFTËRAT E GREKËVE NË MES VETE (LUFTA E PELOPONEZIT)

### Persianët sulmojnë Evropën Mesdhetare

Persia ishte fuqizuar shumë në shekullin VI para Krishtit. Persianët, nën udhëheqjen e Darit sulmuan Evropën rreth vitit 523 para Krishtit. Ata vunë kontrollin e tyre në Helespont, qytetet në Azi të Vogël dhe ishujt Hios dhe Samos. Ky kontroll më së shumti i cenoi interesat e grekëve. Për këtë arsye, ata, në vitin 500 para Krishtit filluan luftën kryengritëse kundër persianëve. Kjo kryengritje u shua shumë shpejt nga persianët pa dhënë rezultat.

Marrëdhëniet greko-persiane u acaruan edhe më tepër, për të vazhduar me luftëra të ashpra në mes këtyre popujve prej vitit 500-449 para Krishtit. Persianët nën komandën e Mardonit, dhëndrit të mbretit persian, Darit, sulmuan Greqinë në vitin 492 para Krishtit nga toka dhe deti. Në këtë luftë persianët pësuan disfatë. Në vitin 490 para Krishtit trupat persiane zbarkuan në brigjet e Atikës afër fushës së Maratonës, vetëm 42 kilometra larg Athinës. Ushtria athinase e udhëhequr nga Miltiadi shënoi fitoren e radhës. Kjo betejë në histori njihet me emrin beteja e Maratonës.

PERSIANËT SULMOJNË EVROPËN MESDHETARE



USHTARI SPARTAN

### Grekët humbën në Termopile por fituan në Salaminë

Sukseset e grekëve në Maratonë i bindën ata se persianët nuk ishin të pathyeshëm. Athina pas kësaj fitoreje u fuqizua edhe më shumë duke shtuar numrin e anijeve në flotën e saj ushtarake. Athinasit ndërtuan edhe 150 anije luftarake për t'u shndërruar kështu në njëri nga flotat më të fuqishme në Pellgun e Mesdheut.

Ky fuqizim nxiti për sulm ushttrinë persiane. Ata, në vitin 480 para Krishtit, të komanduar nga Kserksi, sulmuan Greqinë ballkanike. Për të përballuar sulmet e persianëve, grekët krijuan një aleancë ushtarake në mes tyre nën udhëheqjen e Spartës. Mbreti persian Kserksi, për të kaluar në Greqinë e Mesme duhej të kalonte Grykën e Termopileve. Mbreti spartan, Leonida, koncentroi një numër të madh të ushtarëve në këtë grykë. Trupat persiane u hodhën në sulm por pa sukses. Pastaj përdorën dinakërinë duke i ofruar një greku (Efialtit) një shpërblim të madh për t'iu treguar ndonjë rrugë tjetër. Tradhtari grek iu priu persianëve nëpër një shteg malor për t'u dalë pas shpine ushtarëve grekë. Grekët të zënë në befasi pas luftimeve të ashpra, u thyen. Aty mbeti i vrarë edhe mbreti spartan Leonida. Pas kësaj fitoreje, persianët e plaçkitën dhe e dogjën Athinën, duke vrarë e zënë shumë robër. Pavarësisht kësaj humbjeje të madhe

grekët i rigrupuan forcat. Të gjithë burrat e aftë iu bashkuan ushtrisë dhe më flotën athinase u vendosën në gjirin e Salaminës. Kserksi sulmoi flotën greke por pësoi disfatë dhe u detyrua të tërhiqej.

Pas fitores në Salaminë në vitin 478 para Krishtit, grekët formuan lidhjen e tyre me qendër në ishullin Delos. Ky bashkim u quajt Lidhja Detare e Delosit. Lidhja krijoi arkën e përbashkët për nevojat e luftës - çdo anëtar i kësaj lidhjeje ishte i detyruar të merrte pjesë me një numër të caktuar të anijeve dhe luftëtarëve në rast rreziku.



LUFTA E PELOPONEZIT) 

### **Lufta 27-vjeçare e grekëve në mes vete (Lufta e Peloponezit)**

Fitoret e fundit të grekëve në luftërat greko-persiane nxorën dy superfuqi rajonale: Athinën dhe Spartën. Athina njihej si demokraci, kurse Sparta si oligarkia. Rreth tyre u afruan edhe polise më të vogla dhe më pak të rëndësishme duke krijuar dy blloqe politike dhe ushtarake. Lidhjen e Delosit e drejtonte Athina dhe Lidhjen e Peloponezit e drejtonte Sparta. Rivaliteti i tyre në luftë për dominim në Greqi, në gjysmën e dytë të shekullit V para Krishtit i çoi ato në një konflikt të gjatë dhe shumë të ashpër (431- 404 para Krishtit). Ky konflikt në histori njihet me emrin **Lufta e Peloponezit**. Athina i nxiste dhe i strehonte elementët demokratë kundërshtarë të Spartës, ndërsa Sparta strehonte aristokratët, kundërshtarë të demokracisë në Athinë.

Mosmarrëveshjet arritën kulmin kur Sparta dhe aleatët e saj kërkuan në formë ultimatum që Athina të shpërndante **Lidhjen e Delosit** dhe ta largonte Perikliun nga Athina. Këtë ultimatum, Athina e refuzoi dhe kështu filloi lufta. Pas 27 vjet lufte, Sparta me aleatët e saj doli fitimtare. Athina me këtë disfatë e humbi edhe rëndësinë dhe rolin që kishte pasur dikur. Ajo nuk arriti asnjëherë të rikthente fuqinë e saj.



### **TË PUNOJMË SË BASHKU**

Si e vlerësoni veprimin e Efialtit?  
Pse grekët luftuan mes vete?

## IV

## 16. GRATË NË GREQINË ANTIKE

**Edukonin fëmijët dhe kryenin punë të shtëpisë**

Marrë në tërësi në territoret e populluara me grekë, gratë nuk kishin shumë të drejta. Të drejtat e tyre mohoheshin për shumë arsye. Ato ishin nën kontrollin dhe mbrojtjen e babait, bashkëshortit ose të burrave të afërm gjatë gjithë jetës së tyre. Gratë nuk kishin rol në politikë, sepse politika konsiderohej si profesion i burrave. Ato kryesisht qëndronin në ambiente shtëpiake me fëmijët dhe familjet e tyre. Kujdeseshin për edukimin e fëmijëve dhe kryenin detyra shtëpiake, si pastrimin e shtëpisë dhe përgatitjen e ushqimit. E vetmja punë publike e rëndësishme për një grua ishte të shërbente si një priftëreshë. Me kalimin e kohës ndryshoi pozita e grave në Greqi. Ato madje arritën të mbanin pozita të larta në shoqërinë dhe polisët - qytet-shtetet greke.



GRUAJA NË GREQINË ANTIKE

**Roli i grave dhe e drejta e tyre në pronë**

Shoqëria spartane dhe athinase ishte në një shkallë më të lartë të zhvillimit krahasuar me pjesë të tjera të Greqisë Antike. Gratë spartane nuk kishin shumë kufizime. Ato kishin më shumë liri dhe përgjegjësi në jetën publike. Ato dilnin në publik, trashëgonin pasurinë dhe kishin më shumë të drejta krahasuar me disa territore të tjera të Greqisë. Në shekullin e katërt, mbi dy të pestat e tokës në Spartë ishin në pronësi të grave. Në Athinë gratë silleshin sipas ligjeve athinase. Ligji e kërkonte që të gjitha trashëgimet të kalonin nëpër vijën mashkullore, kurse prona e grave ishte më e kufizuar. Gratë mund të fitonin të drejta mbi pronën vetëm përmes dhuratave dhe trashëgimisë, edhe pse, nëse ishte e martuar, burri i saj kishte të drejtën të shfrytëzonte pronën e gruas.

Gratë e skllavopronarëve dhe fisnikërisë greke mbikëqyrnin skllëvërit dhe menaxhonin përgjegjësitë shtëpiake si mirëmbajtja, pastrimi e gatimi. Në shtëpitë e pasura, gratë kishin një zonë plotësisht të veçantë të shtëpisë ku burrat nuk lejoheshin të hynin. Në shtëpitë e të varfërve, këto zona të ndara nuk ishin në dispozicion. Gratë e varfra shpesh punonin jashtë shtëpisë, duke ndihmuar burrat e tyre në treg ose në ndonjë punë tjetër. Ato shpesh shkonin në treg pa përcjellje mashkullore.

**Lidhja dhe shkurorëzimi i martesave**

Deri në martesë, gratë ishin nën kujdestarinë e prindërve të tyre ose

MARTESA: DHËNDRI DHE NUSJA TË SHOQËRUAR NGA FAMILJARËT E TYRE



të afërmve të tjerë burra. Pas martesës burri e merrte përgjegjësinë e plotë mbi gruan. Mosha mesatare për t'u martuar për burra ishte rreth 30 vjeç, kurse për vajzat 14 vjeçe.

Në Spartë, për dallim nga pjesët e tjera të Greqisë, shumica e vajzave martoheshin rreth moshës 20-vjeçare. Në Greqinë e lashtë martesë konsiderohej si një nga ngjarjet më të rëndësishme në jetën e një gruaje, por ajo nuk kishte kontroll të drejtpërdrejtë mbi të. Atyre u mohohej liria e zgjedhjes së bashkëshortit. Një vajze të re që duhej të martohej, burrin ia zgjidhnin të afërmit. Pra, martesë nuk ishte një vendim si rezultat i dashurisë, por ishte marrëveshje midis dy burrave, babait dhe bashkëshortit. Pavarësisht këtyre kufizimeve në zgjedhjen e fatit të jetës, në Greqinë e lashtë, të drejtat e grave për shkurorëzim, ishin shumë liberale.

Martesa mund të përfundonte me pëlqimin e ndërsjellë ose veprimin e marrë nga ndonjëri prej bashkëshortëve. Nëse një grua donte ta ndërpriste martesën e saj, ajo kishte nevojë për ndihmën e babait të saj ose të një të afërmi tjetër, për ta përfaqësuar atë, sepse si grua nuk kishte të drejtë. Nëse një burrë donte shkurorëzimin, gjithçka që duhej të bënte, ishte ta lëshonte bashkëshorten e tij nga shtëpia. Babai i një gruaje gjithashtu kishte të drejtën t'i jepte fund martesës së vajzës së tij. Nëse bashkëshortët kishin fëmijë, ata konsiderohej se i përkisnin familjes së babait. Pra, në Greqinë antike statusi social i grave ishte më i ulët se i burrave.



 GRATË NË GREQINË ANTIKE



## TË PUNOJMË SË BASHKU

Cili ishte roli i grave në familjet greke?

Diskutoni për fejesat dhe martesat tradicionale në Greqinë e Vjetër.

## IV


## 17. JETA E PËRDITSHME NË GREQINË ANTIKE

**Jeta e përditëshme në familje**

Fëmijët grekë, vajza dhe djem, deri në moshën shtatëvjeçare kishin fëmijërinë e tyre, e cila karakterizohej me lojëra të ndryshme. Ata në përditshmërinë e tyre jetonin të papenguar. Nga mosha 7-vjeçare fëmijët shkonin në shkollë. Mirëpo, shumica e fëmijëve grekë nuk kishin mundësi të ndiqnin shkollimin. Të drejtë dhe mundësi shkollimi kishin vetëm fëmijët e skllavopronarëve dhe të fisnikëve. Të varfrit dhe fëmijët e skllavëve nuk e gëzonin këtë të drejtë. Djemtë që nuk shkonin në shkollë ndihmonin baballarët e tyre në aktivitete dhe punë ditore, kurse vajzat fillonin që në moshë të re t'i mësonin punët e shtëpisë dhe t'u ndihmonin nënave të tyre.

Gratë në jetën e përditëshme nuk kishin të drejta politike e qytetare. Ato qëndronin në shtëpi dhe kujdeseshin për fëmijët dhe punët e shtëpisë. Të rralla ishin ato që arritën të ngjiteshin lart në politikën greke dhe në drejtimin e shtetit. Edhe në letërsi, art e kulturë mungonte kontributi i grave në Greqinë Antike.

Burrat e lirë me të drejta politike e qytetare e dominonin përditshmërinë në shoqërinë greke. Ata udhëhiqnin shtetin, ishin komandantë të ushtrisë, filozofë, shkencëtarë, poetë e dijetarë të ndryshëm. Burrat nga shtresat e varfra merreshin me punë të rënda fizike që të nxirrnin fitime të mbanin e ushqenin familjet e tyre. Burrat në përditshmëri ishin përgjegjës për gratë, fëmijët dhe familjen. Merrnin vendime të rëndësishme për paqen dhe për luftën.



EDUKIMI I FËMIJËVE NË GREQI

**Skllavërit**

Skllavërit ishin kategoria më e ulët në shoqërinë greke. Shumica prej tyre ishin robër të kapur në luftëra dhe një pjesë tjetër të rënë në skllavëri për shkak të borxheve. Ata shiteshin e bliheshin nga skllavopronarët dhe nuk kishin asnjë të drejtë njerëzore. Jeta e tyre e përditëshme ishte shumë e vështirë. Ata detyroheshin të bënin punë të rënda në ara dhe miniera të rrezikshme dhe për punën e tyre nuk paguheshin fare. Skllavërit shfrytëzoheshin edhe si shërbëtorë të familjeve skllavopronare.

**Ushqimet kryesore**

Grekët e vjetër në përditshmërinë e tyre ushqeheshin me ushqime bujqësore dhe blegtorale, që i prodhonin vetë. Në Greqinë e Vjetër kishte dallime edhe në mënyrën dhe menunë e ushqimit. Shtresat e

larta ushqeheshin me ushqime të përzgjedhura dhe më cilësore, kurse të varfrit ishin të detyruar të ushqeheshin me ushqime më të dobëta për shkak të varfërisë. Më së keqi ushqeheshin sklevërit, të cilët shpeshherë ishin të detyruar të ushqeheshin me tepricat e të tjerëve. Ndër ushqimet kryesore në përgjithësi ishin: buka, peshku, mishi, vera, birra, ulliri, perimet, frutat etj.

### **Përditshmëria e bujqve, blegtorëve dhe zejtareve**

Bujqit çdo ditë punonin në arat e tyre. Ata kujdeseshin për mbjelljen, ujitjen dhe kultivimin e drithërave, hardhisë dhe kulturave të tjera bujqësore. Në fund të sezonit, ata kornin drithërat dhe vilnin pemët e kultivuara. Blegtorët kujdeseshin për bagëtinë. Ata i ushqenin, kujdeseshin për shumimin e tyre, shisnin mishin, qumështin dhe produktet e qumështit. Grekët e lashtë punonin gjëra të ndryshme zejtare duke përfshirë qeramikën, metalet, përpunimin e drurit etj. Prodhimet e veta i shisnin çdo ditë në tregjet e tyre.

### **Shtëpitë greke**

Ajo që dimë për shtëpitë e lashta greke vjen nga shkrimet e autorëve antikë dhe nga piktura të ndryshme që vijnë nga ajo kohë. Shumica e shtëpive ishin të punuara nga druri e të lyera me baltë. Kishte edhe shtëpi të ndërtuara nga guri dhe materiale të tjera të forta. Shtëpitë ishin përgjithësisht të vogla të rrethuara me mure dhe kishin kopshte dhe oborre të vogla. Çatitë ishin bërë me pllaka balte. Dritaret ishin të vogla. Ndonjëherë grekët ndërtonin edhe shtëpi më të mëdha në të cilat jetonin shumë anëtarë të bashkësisë familjare. Shtëpitë e mëdha kishin dhjetëra dhoma dhe më shumë se një kat. Këto dhoma përfshinin dhoma banje, një dhomë ngrënieje dhe një kuzhinë. Dhomat e gjumit zakonisht ishin të vendosura në katin e dytë. Burrat dhe gratë jetonin në pjesë të ndryshme të shtëpisë, në dhomat e dedikuara për ta.



 SHTËPI BANIMI NË GREQINË ANTIKE




### **TË PUNOJMË SË BASHKU**

Diskutoni për jetën e përditshme në Greqinë e Vjetër dhe krahasojeni me jetën e përditshme të kohës moderne!

## IV

18. PERSONALITETE TË SHQUARA  
TË GREQISË ANTIKE**Hipokrati - Babai i Mjekësisë (460-370 para Krishtit)**

Hipokrati ishte një mjek nga Greqia. Ai hodhi poshtë shkaqet e mbinatyrshe të sëmundjeve dhe kërkoi që trupi i njeriut dhe sëmundjet të studioheshin. Jetoi në epokën e Perikliut. Konsiderohet si një nga figurat më të shquara në historinë e mjekësisë. Ai shpesh quhet "Babai i Mjekësisë".

**Betimi i Hipokratit**

*Betohem se jetën time do ta vë në shërbim të humanizmit. Në ushtrimin e profesionit, në mua nuk do të ndikojë asnjë rrethanë: feja, kombi, raca, përkatësia politike ose klasore...edhe nën kërcënim nuk do të lejoj që dija ime të keqpërdoret në kundërshtim me ligjet humane. Këtë e premtoj solemnisht, lirshëm duke u bazuar në nderin tim.*


**Leonida (Mbreti Spartan) 540-480 (para Krishtit)**

Leonida ishte luftëtar i shquar dhe mbret i Spartës. Mori pjesë në luftën greko-persiane në Grykën e Termopileve. Në këtë luftë persianët udhëhiqeshin nga mbreti i tyre i famshëm Kserksi. Leonida ishte udhëheqës i forcave greke në këtë betejë. Grekët u tradhtuan nga Elfiati që ishte njëri prej tyre. Pas humbjeve të mëdha në ushtri dhe luftës së ashpër të palëve ndërluftuese mbeti i vrarë edhe mbreti spartan, Leonida, në vitin 480 para Krishtit. Lavdia e grekëve të udhëhequr nga Leonida u bë frymëzim në luftërat e mëvonshme të grekëve kundër persianëve.

**Mbretëresha Gjorgjo e Spartës**

Gjorgjo ishte mbretëresha e shtetit grek të Spartës, vajza e mbretit Kleomenes (mbretëroi 520-490 para Krishtit), gruaja e mbretit Leonidas (mbretëroi 490-480 para Krishtit). Sipas Herodotit, ajo ka lindur në vitin 518 para Krishtit. Gjorgjo u martua me Mbretin Leonidas në vitin 490 para Krishtit. Pas vrasjes së Leonidas në Termopile ajo e trashëgoi për një kohë mbretërimin e Spartës. Vlerësohet si një grua e fortë, e mençur, e zgjuar dhe me autoritet.






### Homeri

Homeri mendohet se ka jetuar në shek. IX para Krishtit. Sipas arkeologëve ai u lind në Smirna, qytet grek në Azinë e Vogël (Izmiri i sotëm në Turqi). Homeri ka jetuar shumë kohë më vonë nga koha kur ka ndodhur Lufta e Trojës dhe nga kthimi i grekëve në atdhe. Kjo do të thotë se poeti ka ditur ta shfrytëzojë me mjeshtëri të rrallë burimin e pasur të letërsisë gojore me këngë e himne të ndryshme kushtuar hyjnive, heronjve dhe bëmave të tyre. Ai u

bë i njohur me veprat ILIADA dhe ODISEJA të cilat konsiderohen si thesar i kulturës klasike botërore. Këto vepra kanë pasur dhe kanë ndikim të rëndësishëm edhe në letërsinë moderne.


### Sokrati (469-399 para Krishtit)

Sokrati lindi në Alopeke. Jetoj gjatë kohës së tranzicionit politik në Athinë, në kohën e humbjes që kishte pësuar Athina në luftë me Spartën. Sokrati ka qenë një kritik i demokracisë dhe i mënyrës së funksionimit të saj në Athinë. Ai mbajti qëndrim kritik edhe ndaj politikës. Sokrati si filozof besonte në të vërtetën objektive. Sipas tij, njeriu do ta njohë të vërtetën vetëm nëse e njeh mirë veten e tij. Sokrati thoshte: “Unë nuk mund ta mësoj askënd asgjë, unë mundem t’i bëj vetëm të mendojnë”. Filozofia e tij nuk u kuptua si duhet nga bashkëkohanikët. Nga shkolla e tij e filozofisë dolën nxënës të shquar si Platoni dhe Ksenofoni. Sokratin e akuzuan dhe e dënuan me vdekje për botëkuptimet e tij të shfaqura publikisht.



### Platoni (428-347 para Krishtit)

Ishte një aristokrat athinas dhe nxënës i Sokratit. Në moshën 20-vjeçare u njoh me Sokratin dhe për 10 vjet radhazi ishte nxënës i tij. Platoni themeloi shkollën e tij filozofike të cilën e quajti Akademi. Ai u njoh si kundërshtar i demokracisë. Sipas tij, ekzistojnë dy botëra: bota e ideve dhe bota e gjërave kalimtare. Vepra e tij kryesore është “Mbi shtetin”. Sipas Platonit shtetin ideal duhet ta udhëheqin filozofët, ta mbrojnë ushtarët dhe të punojnë e ta zhvillojnë zejtarët, bujqit e fshatarët.





## IV



VDEKJA E SOKRATIT


### **Perikliu (495 - 429 para Krishtit)**

Ishte një burrë shteti i njohur dhe me ndikim, orator dhe gjeneral i Athinës gjatë Epokës së Artë - kohë midis luftërave persiane dhe të Peloponezitet. Perikliu kishte një ndikim të madh në shoqërinë athinase, saqë Tukidididi, një historian bashkëkohës, e vlerësoi atë si "qytetari i parë i Athinës". Perikliu e ktheu Lidhjen e Delosit në një forcë të madhe dhe udhëhoqi athinasit gjatë dy vjetëve të para të Luftës së Peloponezitet. Periudha gjatë së cilës ai drejtoi Athinën, afërsisht nga 461 deri në 429 para Krishtit, njihet si "Epoka e Perikliut". Ai promovoi artin, letërsinë dhe kulturën. Perikliu nxiti dhe mbështeti demokracinë athinase.




### **Aristoteli (384 322 para Krishtit)**

Aristoteli ishte filozof, mendimtar dhe shkencëtar i shquar i Greqisë Antike. U lind në Stragira-Halkidiki të Greqisë Veriore. Kishte prejardhje nga një familje e arsimuar. I ati i Aristotelit ishte mjek në oborrin mbretëror maqedonas. Në moshën shtatëmbëdhjetë-vjeçare, ai shkoi në shkollë në Athinë, në Akademinë e Platonit, ku qëndroi për disa vjet me radhë. Konsiderohet gjeniu më i madh intelektual i botës antike. Në veprat e tij gjejmë shënime për fizikën, biologjinë, zoologjinë, metafizikën, logjikën, etikën, estetikën, poezinë, teatrin, muzikën, retorikën, psikologjinë, gjuhësinë, ekonominë dhe politikën. Aristoteli ishte vijuesi i mendimit të shkollës së Sokratit. Mendimet e tij ishin në kundërshtim me ato të Platonit. Ai thoshte: Platonin e kam mik por mik më të madh e kam të vërtetën. Aristoteli me kërkesë të Filipit II u bë mësues i Aleksandrit të Madh.



### Herodoti (484-425 para Krishtit)

Herodoti ishte historian grek. Ai u lind në Halikarnas në Perandorinë Persiane. Ishte bashkëkohës i Thukididit, Sokratit dhe i Euripidit. Ciceroni e quajti atë "Babai i Historisë". Ishte historiani i parë që mendonte se historia duhet trajtuar me metoda që bazohen në hulumtime. Hulumtimet duhen bazuar në mbledhjen e fakteve historike dhe trajtimin e tyre në mënyrë kritike. Vepra e tij kryesore ishte "Historia". Në këtë vepër, që ka 9 vëllime, bëhet fjalë për luftërat greko-persiane.



### Aspasia e Miletit

Aspasia e Miletit (470-410 para Krishtit) ishte mësuese, shkrimtare dhe intelektuale në Athinë. Ajo jetoi në një kohë kur gratë nuk e zinin vendin e merituar në shoqëri. Ato ishin të dominuara nga burrat. Ekzistojnë raste të rralla kur gratë bënë emër në kulturë, letërsi e ndonjëherë edhe në drejtimin e shtetit. Aspasia e Miletit hapi një shkollë për vajza. Këtë shkollë e ndoqën vajzat athinase të cilat dëshironin të shkolloheshin. Aspasia njihje edhe filozofinë dhe retorikën. Emri i saj gëzonte respekt në mesin e filozofëve dhe studiuesve si Sokrati dhe Platoni, oratori Ciceron, historiani Ksenofon dhe shkrimtari Athenaeus.



## TË PUNOJMË SË BASHKU

Hulumtoni dhe gjeni shënime interesante për personalitete të tjera të botës greke si: Klistheni, Pitagora, Tukididi etj!





V

QYTETËRIMI NË  
MAQEDONINË E LASHTË

## V

## 19. MAQEDONIA NË KOHËN E FILIPIT II DHE LEKËS SË MADH

### Popullsia e Maqedonisë së Lashtë

Maqedonasit ishin një popullsi e lashtë, që jetonte në luginat rreth lumenjve Haliakmon dhe Aksios, në pjesën verilindore të Greqisë kontinentale. Historianët kanë mendime të ndryshme për identitetin e maqedonasve. Disa i konsiderojnë si grekë, simbiozë iliro-greke, ilirë e deri te mendimi që maqedonasit e vjetër ishin barbarë. Sidoqoftë, maqedonasit e vjetër përqaftuan shumë aspekte të kulturës greke si pjesëmarrje në kulte fetare greke. Megjithëkëtë grekët ia kishin ndaluar pjesëmarrjen në Lojërat Olimpike Aleksandrit të Madh me arsyetimin se vetëm grekëve u lejohej të marrin pjesë në këto lojëra. Pra, nuk e pranonin si grek. Maqedonasit kanë treguar ngjashmëri edhe me ilirët sidomos në periudhën e Filipit II dhe të Aleksandrit-Lekës së Madh, nëna e të cilit ishte ilire. Edhe gjuha që flisnin maqedonasit kishte dallime me greqishten.

### Formimi i shtetit të Maqedonisë - qeverisja e Filipit II

Shteti maqedonas u formua në shekullin V para Krishtit. Nga mesi i shekullit IV në krye të shtetit erdhi Filipi II (395-336 para Krishtit). Qeverisjen e shtetit ai e mbështeti në aristokracinë e vendit, në pronarët e tokave dhe në shtresën zejtare e tregtare të qyteteve. Filipi II realizoi një varg reformash në Maqedoni. Më të njohurat ishin reformat ushtarake. Ai krijoi një ushtri të fuqishme që e quajti Falangë. Falanga përbëhej prej 16 radhëve të luftëtarëve të armatosur me shpata dhe më heshta të gjata. Kalorësia dhe këmbësoria gjithashtu kishin rol të madh në ushtrinë maqedonase. Filipi II pushtoi grekët në brigjet e Thrakisë në vitin 338 para Krishtit dhe i detyroi ta njihnin autoritetin e tij. Filipi II u vra në vitin 336 para Krishtit nga truproja e tij në teatrin e Aigait.

### Aleksandri (Leka) i Madh trashëgimtar dhe udhëheqës i Maqedonisë

Në Maqedoninë e Vjetër pushteti ishte i trashëgueshëm nga babai te i biri. Kështu pas vdekjes së Filipit II, pushteti i kaloi Aleksandrit-Lekës (336-323 para Krishtit). Leka ishte i biri i Filipit II dhe i Olmpisë, një grua ilire që vinte nga shtresat e larta shoqërore. Kishte për mësues dijetarin e madh të kohës Aristotelin. Në vitin 332 para Krishtit në betejën afër lumit Granik, Aleksandri i mundi persianët. Ai fitoi shumë beteja dhe arriti të pushtonte bregun e Fenikisë dhe Egjiptin. Në rrjedhën e lumit Nil themeloi një qytet të cilin e quajti me emrin e tij - Aleksandri. Në vitin 331 para Krishtit përsëri i mundi persianët dhe e shkatërroi shtetin e tyre.

Pas vendosjes së pushtetit të tij në Persi, në vitin 327 para Krishtit, Leka marshoi drejt Indisë. Ushtria maqedonase arriti pa vështirësi



ALEKSANDRI I MADH 

deri në degën e majtë të lumit Ind. Qëllimi i tij ishte ta pushtonte Indinë. Mirëpo u detyrua të tërhiqej, meqë nga vapa u shfaqën shumë sëmundje dhe për pasojë i vdiqën shumë ushtarë. Leka dha urdhër për tërheqje. Kjo tërheqje shënoi përfundimin e fushatës dhjetëvjeçare maqedone në Lindje.

### Leka i Madh donte të bëhej sundimtar i botës

Pavarësisht se u detyrua të tërhiqej përkohësisht, Leka i Madh kishte ambicie të mëdha. Ai dëshironte të bëhej sundimtar i botës. Për këtë arsye synonte të pushtonte Italinë dhe vendet afrikane. Por vdekja e hershme e la pa i realizuar këto plane. Ky ishte prijësi ushtarak më i njohur i botës antike, prandaj u quajt i Madh (Aleksandri i Madh). Shteti i krijuar nga Aleksandri shtrihej në tri kontinente (nga Adriatiku në Indi dhe nga Kaukazi deri në rrjedhën e mesme të lumit Nil). Pas vdekjes së Aleksandrit të Madh (323 para Krishtit) u shfaqën përçarje e konflikte që çuan drejt shkatërrimit të këtij shteti.

### Kush ishte Aleksandri i Madh

Aleksandri III i Maqedonisë (20/21 korrik 356 para Krishtit - 10/11 qershor 323 para Krishtit), i njohur si Aleksandri i Madh ishte një mbret i mbretërisë së lashtë të Maqedonisë. Ai lindi në Pella në vitin 356 para Krishtit. E trashëgoi pushtetin e babait të tij, Filipit II, në moshën njëzetvjeçare. Ai kaloi shumicën e viteve të jetës së tij në fushata ushtarake në Azi dhe Afrikë. Aleksandri krijoi një nga perandoritë më të mëdha të botës së lashtë në moshën tridhjetë vjeçare. Vdiq në Babiloni, në moshën 32-vjeçare. Për vdekjen e tij ekzistojnë disa versione. Plutarku thotë se Aleksandri kishte pirë verë shumë dhe kjo i kishte keqësuar shëndetin. E kishin kapur ethet, të cilat i kishin shkaktuar vdekjen. Variantin e dytë e përmend Diodori i cili rrëfen se Aleksandri ishte sëmure rëndë dhe 11 ditë më vonë vdiq pas një agonie të thellë.

Diodori, Plutarku, Arriani dhe Justini mbrojnë teorinë se Aleksandri ishte helmuar. Të tjerë mendojnë se ishte komplot për t'i marrë pushtetin.



## Fjalori

**Identitet** - të qenët i veçantë nga të tjerët dhe i njëjtë vetëm me vetveten.


**Simbiozë** - bashkëjetesë a marrëdhënie të ngushta në mes popujve të ndryshëm që banojnë në të njëjtat territore.

**Falanga** - reparte ushtarake maqedonase të armatosura rëndë.



### TË PUNOJMË SË BASHKU

A janë i njëjti popull maqedonët e lashtë me maqedonët e sotëm? Diskutoni më shumë për Aleksandrin e Madh, prejardhjen dhe familjen e tij!





QYTETËRIMI ROMA



## VI

## 20. ROMA E VJETËR



SHTRIRJA E ROMËS NË  
FILLIMET E SAJ

**Shtrirja**

Qytetërimi romak përfshin një periudhë të gjatë kohore nga themelimi i qytetit të Romës në shekullin VIII para Krishtit deri në rënien e Perandorisë Romake të Perëndimit në shekullin V pas Krishtit. Këtu përfshihet periudha e Mbretërisë Romake, Republikës Romake dhe Perandorisë Romake.

Roma përfshinte një territor të gjerë në Gadishullin e Apenineve. Toka ishte shumë pjellore dhe kushtet shumë të mira për zhvillimin e bujqësisë. Rajoni karakterizohej me klimë të butë, por me

një nëntokë të varfër nga e cila nxirreshin, me pakicë, bakri dhe kallaji. Shtrirja afër detit i shtonte rëndësinë këtij territori. Prej shekullit III para Krishtit, gadishulli u quajt Itali.

**Si u themelua qyteti i Romës**

Tregimet historike të traditës, të interpretuara nga vetë romakët e vjetër shpjegojnë historinë më të hershme të qytetit të tyre përmes miteve dhe legjendave. Ndër legjendat më të përhapura është ajo për vëllezërit, Remin dhe Romulin. Sipas kësaj legjende, Roma u themelua më 21 prill 753 para lindjes së Krishtit nga vëllezërit binjakë që e kishin origjinën nga princi trojan, Enea. **Romuli dhe Remi** ishin nipër të mbretit latin, Numitorit të Alba Longës. Mbreti u rrëzua nga froni nga vëllai i tij, Hamuli. Numitori kishte një vajzë që e quanin Rea Silva. Ajo lindi Remin dhe Romulin. Mbreti i ri Hamuli,

UJKONJA E CILA SIPAS  
LEGJENDËS USHQEU REMIN  
DHE ROMULIN



për shkak të frikës nga hakmarrja, urdhëroi t'i hidhnin foshnjat në lumit Tiber. Vala e lumit i nxori fëmijët në breg ku i gjeti një ujkonjë, e cila i ushqe me qumështin e vet. Më pas fëmijët i mori një bari i cili i rriti. Kur u rritën, binjakët themeluan qytetin e tyre. Romuli e vrau Remin gjatë një grindjeje në mes tyre. Qytetit iu vu emri sipas Romulit.

Një legjendë tjetër e thënë nga historiani grek, Dionisi i Halikarnasit, thotë se princi Enea drejtoi një grup trojanësh në një udhëtim në det. Pas një kohe të gjatë në ujërat e ashpra, ata zbarkuan buzë lumit Tiber. Pas pushimit, burrat donin të vazhdonin rrugën në det. Kjo ide u kundërshtua nga gratë, të cilat nuk donin të largoheshin nga aty. Një grua e quajtur Roma, ndërmoi një aksion. Ajo bashkë me gratë e tjera i dogjën anijet për të mos lejuar largimin. Për nder të saj qyteti e mori emrin Roma.

### Popullsia

Në gadishullin e Apenineve popullsia e vjetër përbëhej nga fiset italice, ndër të cilat më të njohurit ishin latinët dhe sabinët. Në veri të Italisë jetonin fiset kelte (galët). Në pjesën juglindore të Italisë jetonin fise ilire, kurse në pjesën jugore jetonin grekë. Toskana e sotme banohej nga etruskët dhe quhej Etruri.

E gjithë popullsia romake ishte e ndarë në dy grupe të mëdha: patricët dhe plebenjtë. Patricët ishin shtresa e pasur e shoqërisë romake. Pronarët e tokave dhe të pasuritë e tjerë kishin të drejtë të merrnin pjesë në politikë dhe të ishin drejtues të organeve më të larta shtetërore. Plebenjtë për nga numri ishin disa herë më shumë se patricët, por nuk kishin të drejta politike. Popullatën plebeje e përbënin zejtarët, tregtarët dhe bujqit. Martesat në mes patricëve dhe plebenjve ishin të ndaluara.



## Fjalori

**Legjendë** - tregim për dikë a për diçka.



MONEDHA ROMAKE



## TË PUNOJMË SË BASHKU

Diskutoni për legjendat e treguara për themelimin e Romës!

Shkruani një legjendë me karakter historik që e keni dëgjuar në familje ose diku tjetër.

## VI

21. ROMA NË KOHËN E MBRETËRISË  
DHE TË REPUBLIKËS

SENATI ROMAK



**Skllavëria e periudhës mbretërore** dallon nga skllavëria e mëvonshme. Gjatë kësaj periudhe skllavërit hynin në përbërjen e familjes së pronarit të tyre. Në shumicën e rasteve skllavëria e kohës mbretërore kishte karakter patriarkal. Pra, urdhrat e të zotit të shtëpisë ishin obligative si për skllavin, ashtu edhe për anëtarin e familjes. Kishte edhe raste të tjera kur pronarët ushtronin dhunë psikologjike dhe fizike ndaj skllavëve duke i rrahur e torturuar me metoda çnjerëzore.

Burime të skllavërisë në periudhën mbretërore ishin luftërat dhe rënia në skllavëri për arsye të borxheve, mosrespektimit të ligjeve dhe për arsye të tjera të ngjashme.

### Roma në kohën e Republikës

Republika Romake u krijua rreth vitit 509 para Krishtit. Në ligjet e Republikës u vendosën një varg normash dhe ndarjesh të pushteteve. Pas dëbimit të mbretit të fundit (Tarkuin Superbi) zyrtarët më të lartë romakë ishin konsujt. Ata ishin kryekomandantë të ushtrisë romake. Pas tyre vinin pretorët, të cilët i udhëhiqnin gjykatat dhe i zëvendësonin konsujt kur ata nuk ishin në Romë. Në këtë mënyrë, Roma nga mbretëria kaloi në republikë, ku rolin kryesor e kishin patricët. Në kohën e Republikës u shtuan

### Periudha mbretërore

Periudha e parë e historisë së Romës që përfshin vitet 753-510 para Krishtit quhet periudha mbretërore. Gjatë kësaj periudhe kanë sunduar shtatë mbretër, prej të cilëve i pari ishte Romuli.

Mbreti zgjidhej nga fiset romake. Ai qeveriste Romën, por ishte udhëheqës i rëndomtë. Ai kishte një varg funksionesh prej të cilave më të rëndësishme ishin funksioni i komandantit ushtarak dhe i gjykatësit. Mbretërit luanin edhe rolin e priftërinjve, pra kishin edhe pushtet shpirtëror. Krahas mbretit qëndronte Senati që përbëhej nga 300 veta.

Senatorët emëroheshin nga mbreti. Ata kishin rolin e një këshilli konsultativ, i cili jepte mendime për çështje të administrimit të brendshëm dhe të politikës së jashtme.

### Skllavëria në periudhën mbretërore

edhe më shumë mospajtimet në mes patricëve dhe plebenjve. Patricët dhe plebenjtë rivalizonin në mes vete për dy arsye kryesore. E para ishin pronat e mëdha tokësore, që ishin e drejtë vetëm e patricëve dhe e dyta të drejtat politike që gjithashtu u takonin vetëm patricëve.


### Organet drejtuese të shtetit

Në Republikën Romake ekzistonin tri lloje kuvendesh të popullit: **Kuvendet e kurive, centurive** dhe të **tribuve**. Kuvendet e kurive kishin karakter fetar, ato të centurive vendosnin për çështjet e luftës, paqes dhe zgjedhnin zyrtarët e lartë. Kuvendet e tribuve kishin karakter legjislativ.

Pushteti ekzekutiv ishte në duart e zyrtarëve të lartë, të cilët zgjidheshin nga kuvendet popullore me mandat njëvjeçar. Ata mund të merrnin vendime të detyrueshme për zbatim, të vinin gjoba, të bënin arrestime etj.

Pas zyrtarëve më të lartë që ishin konsujt, vinin pretorët. Ata i udhëhiqnin gjykatat dhe i zëvendësonin konsujt kur ata nuk ishin në Romë. Pas pretorëve vinin censorët, të cilët merreshin me regjistrimin e popullsisë dhe të pasurisë së tyre. Pas censorëve vinin tribunët e popullit, të cilët mbronin të drejtat e plebenjve për aq sa e kishin të lejuar.

SENATOR ROMAK 



## Fjalori

**Senati** - parlamenti romak.

**Konsuj** - udhëheqësit e

Romës në kohën e

Republikës.

**Pretorët** - ministrat romakë.

**Kuestorët** - gjyqtarët romakë.



## TË PUNOJMË SË BASHKU

Gjeni dallimet në mes të mbretërisë dhe republikës!

## 22. ROMA ZOTËRUESE E PELLGUT TË MESDHEUT

### Luftërat e Romës për territore

Roma, pas pushtimit të Italisë u bë një nga qytetet më të mëdha të Mesdheut. Synimet e saj ishin zotërimi i pellgut të Mesdheut dhe prej andej të shtrinte zotërimet e veta në tri kontinente. Më të zëshmit që u vunë në përkrahje të fushatave pushtuese ishin aristokratët romakë. Roma kishte një ushtri të disiplinuar dhe të organizuar mjaft mirë.

Politikat pushtuese të Romës ranë në kundërshtim me pretendimet e Kartagjenës, e cila shtrihej në bregun verior të Afrikës. Kartagjena



PAMJE NGA LUFTËRAT PUNIKE 

kishte një flotë detare më të fuqishme se Roma. Ndërsa, ushtria e saj tokësore përbëhej në shumicë nga mercenarë të huaj, të cilët në raste vendimtare ishin të pasigurt, madje dinin edhe të tradhtonin. Duke qenë të interesuara për të njëjtat territore, Roma dhe Kartagjena patën konflikte të ashpra mes tyre.

### Luftërat e Romës me Kartagjenën - Luftërat Punike

Luftërat në mes Romës dhe Kartagjenës u quajtën Luftërat Punike, meqë romakët i quanin kartagjenasit “punë”. Këto luftëra zgjatën nga viti 264 deri në vitin 146 para Krishtit.

Lufta e Parë Punike filloi në vitin 264 para Krishtit. Përplasja në mes tyre ishte shumë e ashpër. Në fillim Roma mori Sicilinë, por jo edhe viset bregdetare, sepse i mungonte një flotë e fuqishme. Roma krijoi një flotën me shumë anije luftarake. Në vitin 241 para Krishtit Roma i shkaktoi humbje të mëdha Kartagjenës duke ia shkëputur Sicilinë, Korsikën dhe Sardenjën. Me këtë rezultat përfundoi Lufta e Parë Punike.

Lufta e Dytë Punike filloi në vitin 218 para Krishtit. Komandanti i ushtrisë kartagjenase, Hanibali, kaloi Alpet dhe u nis drejt Romës. Ndeshja në mes dy ushtrive rivale përfundoi me fitoren e Kartagjenës. Një vit më vonë Hanibali i shkaktoi disfatë të rëndë Romës. Ndërkohë romakët i mblodhën sërish forcat e veta, por ndryshuan taktikën e luftës. Ata sulmuan ushtrinë kartagjenase nga krahët duke shmangur kështu luftën e drejtpërdrejtë. Me këtë taktikë romakët e rimorën veten duke i kthyer fitoret në anën e tyre. Sulmet romake në Afrikë e detyruan Hanibalin ta tërhiqte ushtrinë dhe të kthehej për ta mbrojtur Kartagjenën. Disfatën e fundit kartagjenasit e pësuan në vitin 202 para Krishtit. Lufta e Dytë Punike përfundoi me fitoren e romakëve.

Lufta e Tretë Punike u zhvillua në vitin 146 para Krishtit. Kjo luftë përfundoi me disfatë të rëndë të Kartagjenës. Romakët e dogjën dhe e shkatërruan tërësisht Kartagjenën, e cila pushoi së ekzistuari si shtet.

### Luftërat e romakëve në Ballkan

Për t'u bërë superfuqi e kohës, Roma duhej të nënshtrohte edhe mbretëritë ballkanike. Për këtë qëllim ajo filloi luftërat në Iliri dhe Maqedoni. Në mes ilirëve dhe romakëve u zhvilluan tri luftëra të cilat përfunduan me fitoren e romakëve dhe vendosjen e pushtetit të tyre në Iliri.

Rrezikun nga romakët e ndien edhe maqedonasit, të cilët lidhën aleancë me mbretin ilir, Gentin. Në vitin 168 para Krishtit, në betejën pranë Pidnos, romakët i shkaktuan disfatë ushtrisë maqedonase. Me këtë akt mori fund ekzistenca e shtetit maqedonas.



## Fjalori

**Kartagjena** - qytet e shtet i lashtë në Afrikën e Veriut.

**Mercenarë** - ushtarë që luftonin me pagesë në ushtritë e huaja.



HANIBALI



## TË PUNOJMË SË BASHKU

Cilat ishin arsyet e luftërave të romakëve?

## 23. SKLLEVËRIT - NJERËZ PA ASNJË TË DREJTË

### Pse dhe si njerëzit binin në skllavëri ?

Skllavërit ishin pjesa më e diskriminuar e shoqërisë romake. Ata nuk kishin kurrfarë të drejtash njerëzore. Ata kryenin punë të rënda në miniera, në bujqësi, blegtori, në zejtari etj. Skllavërit gladiatorë ishin në pozitë edhe më të vështirë. Ata për të argëtuar skllavopronarët ishin të detyruar të luftonin në mes vete dhe me kafshë të egra në arena të mëdha.



SKLLEVËRIT GLADIATORË  
DETYROHESHIN TË LUFTONIN  
ME KAFSHËT PËR T'Ë ARGËTUAR  
TË PASURIT

Njerëzit binin në skllavëri për disa arsye, por, dy ishin burimet kryesore: robërit e luftës dhe borxhet. Burim tjetër i skllavërisë ishte piratëria, lindja e fëmijëve nga prindër skllavë etj. Piratët kur sulmonin anijet tregtare, ua grabitnin mallrat, zinin rob ekuipazhin dhe i shndërronin në skllavë. Fëmijët e lindur nga prindërit skllavë (ose vetëm nga një nënë skllave) bëheshin robër të skllavopronarit - padronit të nënës. Edhe baballarët kishin të drejta mbi fëmijët e tyre. Ata mund t'i shisnin fëmijët e tyre si skllavë.

Ekzistonin shumë tregje ku shiteshin skllavërit. Çmimi i tyre varej nga

mosha, forca, shëndeti etj.

### Skllavërit detyroheshin të punonin punë të rënda

Skllavërit ishin të detyruar të bënin punë të rënda fizike. Ata punonin në miniera dhe në gurëthyese. Puna në miniera, përveç se ishte shumë e rëndë, ishte edhe e rrezikshme për shkak të



KRYENGRITJA E SKLLEVËRVE

fatkeqësive që ndodhnin shumë shpesh.

Skllëvërit punonin edhe në bujqësi dhe në shtëpitë e padronëve. Krahasuar me punët në gurëthyese dhe miniera, këto ishin punë të lehta.

Shumica e familjeve të pasura romake mbanin skllëvër në shërbim. Ata ushqeheshin më ushqim të dobët, ndërsa për shëndetin e tyre nuk interesohej askush. Shumë skllëvër vdisnin nga luftërat mes tyre dhe me kafshët, nga ngarkesat e papërballueshme fizike në punë dhe nga sëmundjet.

### **Spartaku - gladiator që udhëhoqi kryengritjen**

Jeta e skllëvërve çdo ditë e më shumë bëhej e padurueshme. Ata shpesh ngriteshin në kryengritje për ta fituar lirinë e tyre. Kryengritja më e njohur ishte ajo e udhëhequr nga gladiator Spartaku. Kryengritja e Spartakut filloi në vitin 74 para Krishtit në Kapua. Numri i skllëvërve kryengritës shumë shpejt arriti në 7000 veta. Më urdhrin e Senatit u dërguan 3000 ushtarë romakë për të shuar kryengritjen. Në betejën e zhvilluar në mes tyre, ushtria romake pësoi disfatë të rëndë. Pas kësaj fitoreje, numri i kryengritësve arriti në 120 mijë veta. Mirëpo, skllëvërit u përçanë në mes vete.

Për të shuar kryengritjen, Senati organizoi 10 legjione romake nën komandën e Mark Krasit. Ushtria e Krasit u vu në ndjekje të skllëvërve. Në mes tyre u zhvilluan beteja të ashpra. Beteja vendimtare në mes ushtrisë së Spartakut dhe ushtrisë romake ndodhi në Apulja në vitin 71 para Krishtit. Spartaku pësoi disfatë dhe së bashku me 60 mijë skllëvër mbeti i vrarë. Pas kësaj humbjeje, gjendja e skllëvërve u keqësua edhe më shumë.



## Fjalori

**Gladiator** - skllav ose rob me trup të fuqishëm, që në Romën e vjetër përleshej me skllëvër të tjerë ose me kafshë të egra në arenën e cirkut.

**Padron** - pronar i skllëvërve, njeri i pasur.

**Legjione** - njësi ushtarake themelore në ushtrinë romake.



### TË PUNOJMË SË BASHKU

Shikojeni ndonjë film dokumentar ose artistik me temë “jeta e skllëvërve” në shkollë ose në shtëpi dhe shënoni në fletore momentet më mbresëlënëse për ju dhe pastaj diskutoni në klasë.



## VI

## 24. ROMA NË KOHËN E CEZARIT DHE OKTAVIAN AUGUSTIT

**Cezari u shpall diktator i përjetshëm**

Në kohën e Republikës Romake, marrëdhëniet mes aristokracisë dhe Senatit, shpeshherë, ishin të acaruar për shkak të interesave të palëve. Në këto rrethana, në Romë u forcuan politikisht tri personalitete kryesore: Pompeu, Krasit dhe Cezari. Pompeu pasi forcoi pozitat e tij, u afrua me Krasin dhe Cezarin, të cilët, po ashtu kishin pretendime për pushtet. Në vitin 60 para Krishtit Pompeu, Krasit dhe Cezari lidhën një marrëveshje, e cila u quajt Triumvirati i Parë (sundim i tre njerëzve).

Këta tre sundimtarë të Romës kishin rivalitet në mes vete dhe aspirata për të eliminuar kundërshtarët politikë dhe për t'u bërë sundimtar vetë.

**Vrasja e Krasit - Vrasja e Jul Cezarit**

Pas vrasjes së Krasit në Lindje, pengesa e vetme e Gaj Jul Cezarit mbeti Pompeu. Cezari krijoi një ushtri të fortë të cilën do ta shfrytëzonte për t'u bërë sundimtar i vetëm. Forcimi i pozitave të Cezarit e shqetësoi aristokracinë romake. Fuqisë së Cezarit ia kishte frikën edhe Pompeu. Në mes Cezarit dhe Pompeut filloi një luftë e cila zgjati nga viti 49 deri në vitin 45 para Krishtit. Luftën e fitoi Cezari, kurse Pompeu, pasi u largua nga Roma, u vra në Egjipt. Vrasja e Krasit dhe Pompeut i hapi rrugë Cezarit i cili u shpall diktator i përjetshëm. Cezari e koncentroi pushtetin në duart e veta duke zvogëluar ndikimin e Senatit në politikë. Me këtë rast reagoi Senati dhe aristokracia skllavopronare. Kundër Cezarit u organizua një komplot në vitin 45 para Krishtit. Atë e vranë kundërshtarët e tij komplotistë, Kasi dhe Brutit në Senat.

Bruti kishte qenë kushëri i largët dhe mik i ngushtë i Cezarit, të cilin e donte si ta kishte djalë të vetin. Në momentin e vrasjes, derisa po vdiste i befashuar nga tradhtia e Brutit, Cezari i tha “edhe ti Brut, biri im!. Për nder të Gaj Jul Cezarit muajin korrik e quajten Jul.



JUL CEZARI

VRASJA E CEZARIT  
NË SENATIN ROMAK

## Oktaviani u bë sundimtar i vetëm i Romës

Pas vrasjes së Cezarit, konsull u zgjodh Mark Antoni, njëri nga përkrahësit e Cezarit. Kundër emërimit të Mark Antonit ishte Oktaviani, i biri i adoptuar i Cezarit, i cili deri atëherë studioje në Apoloni të Ilirisë. Oktaviani u kthye në Romë dhe bëri marrëveshje me disa senatorë që do ta përkrahnin kundër Mark Antonit. Kundër të dyve ishte shfaqur edhe Lepidi i cili pretendonte postin e konsullit. Të ndodhur përballë njëri-tjetrit dhe të pafuqishëm për të mposhtur rivalët, Oktaviani, Antoni dhe Lepidi lidhën aleancë politike, e cila u quajt Triumvirati i Dytë.

Pas marrëveshjes, Oktaviani, Antoni dhe Lepidi sulmuan ushtrinë e Kasit dhe Brutit në Maqedoni në vitin 42 para Krishtit dhe e shkatërruan tërësisht. Ata i ndanë zotërimet romake në këtë mënyrë: Lepidi mori Afrikën, Mark Antoni Lindjen, kurse Oktaviani mori Italinë. Mark Antoni u martua me mbretëreshën e Egjiptit Kleopatrën. Ai planifikonte që bashkë me një ushtri të përbashkët të merrte nën kontroll Romën. Oktaviani duke u ndier i rrezikuar, sulmoi ushtrinë e Antonit në brigjet e Epirit në vitin 31 para Krishtit. Ai e pushtoi edhe Egjiptin.

Kleopatra dhe Mark Antoni për të mos rënë në duart e Oktavianit, bënë vetëvrasje. Kështu Oktaviani u bë sundimtar i vetëm i Romës, e rrëzoi republikën dhe u bë perandor. Ai e mbajti titullin e perandorit dhe e sundoi Romën nga viti 31 deri më 14 para Krishtit. Senati romak e shpalli Oktavianin August që do të thotë i hyjnishëm. Për nder të tij muaji gusht u quajt August (në shqip gusht).



 MARK ANTONI DHE KLEOPATRA



## TË PUNOJMË SË BASHKU

Pse u lidh Triumvirati i Parë?

Diskutoni për marrëdhëniet familjare të Cezarit dhe Oktavian Augustit.



## Fjalori

**Diktator** - udhëheqësi i një shteti që cili ka pushtet të pakufizuar dhe vepron me egërsi e pa përfillur askënd.

**Komplot** - bashkërendim veprimesh prapa shpinës së dikujt në mënyrë të pabesë për ta vrarë ose për ta dëmtuar.

## 25. DOBËSIMI DHE RËNIA E PERANDORISË ROMAKE

### Diokleciani - perandori ilir që qeverisi Romën

Diokleciani ishte lindur në një familje ilire nga fisi i dalmatëve. Ardhja e tij në pushtet (284-305) përkohësisht rivendosi paqen dhe begatinë në Romë.

Ai vuri në plan të parë mbrojtjen e kufijve të Perandorisë. Për këtë arsye ai nuk qëndroi në Romë, por në seli të veten zgjodhi qytetin e Nikomedisë në detin Marmara.

Diokleciani filloi reformat e tij duke filluar nga ndarja e re administrative sipas së cilës krijoheshin 100 provinca. Në provincë u bë ndarja e pushtetit ushtarak nga ai civil. Me këtë ndarje të pushtetit synohej vënia e kontrollit dhe mbrojtja më e lehtë e provincave.

Sipas reformave të Dioklecianit, kolonitë nuk kishin të drejtë të braktisnin tokën. Kolonët e arratisur dhe skllëverit, i kapnin i lidhnin dhe i detyronin të ktheheshin në vendet nga kishin ikur. Reformat e Dioklecianit forcuan pozitën e fisnikërisë dhe pronarëve të mëdhenj. Diokleciani e koncentroi pushtetin perandorak në duart e tij. Ky fakt ndikoi në rënien e rolit dhe të rëndësisë së Senatit.


### Përpjekjet e Konstandinit për reforma

Pas Dioklecianit në pushtet erdhi Konstandini me origjinë nga Iliria. Ai në vitin 330 e shpalli kryeqytet të Perandorisë qytetin Bizant, një qytet i vjetër në brigjet e Bosforit. Ky qytet më vonë u quajt Konstandinopojë në shenjë respekti për perandorin Konstandin.

PERANDORI KONSTANDIN



Konstandini forcoi pushtetin e skllavopronarëve. Me këtë veprim e fitoi përkrahjen e aristokracisë. Në vitin 332 fuqizoi edhe një ligj i cili vlente për zejtarët dhe tregtarët, sipas të cilit ata nuk lejoheshin të braktisnin zanatin e tyre e madje as të ndërronin vendbanimet e tyre. Veprim shumë i rëndësishëm që e karakterizon periudhën e sundimit të Konstandinit ishte Edikti i Milanos i vitit 313. Sipas këtij vendimi lejohej liria e besimtarëve të krishterë.



### Rënia e Perandorisë

Perpjekjet e Dioklecianit dhe Konstandinit për reforma dhe ringritje të Perandorisë Romake fillimisht dhanë rezultatet e tyre. Mirëpo, nga fundi i periudhës së sundimit të Konstandinit filloi dobësimi ekonomik dhe politik i Romës.

Sulmet e fiseve barbare dhe kryengritjet e vazhdueshme të shtresave të varfra e dobësuan edhe më shumë Perandorinë. Për herë të fundit, Perandoria u bashkua në vitin 379 nga perandori Teodos. Ai në vitin 395 vendosi ta ndante Perandorinë në dy pjesë: në Perandorinë Romake të Perëndimit dhe Perandorinë Romake të Lindjes, e cila më vonë e mori emrin Perandoria Bizantine.

Qëllimi i Teodosit ishte që Perandorinë t'ua linte trashëgim dy bijve të tij.

Sulmet e fiseve barbare që erdhën nga vise të ndryshme, shkatërruan ushtrinë romake. Në vitin 455 vandalët erdhën nga Afrika Veriore dhe sërish e sulmuan dhe e shkatërruan Romën. Shkatërrimi i Romës shënon fundin e Perandorisë Romake të Perëndimit. Perandoria romake e Lindjes arriti të mbijetonte dhe në shekujt vijues u fuqizua shumë dhe e mori emrin Perandoria Bizantine.



RËNIA E PERANDORISË 



### TË PUNOJMË SË BASHKU

Diskutoni për perandorët romakë me origjinë ilire dhe kontributin e tyre për Perandorinë Romake.

Analizoni si u shpërbë Perandoria Romake.

## 26. SI MARTOHESHIN TË RINJTË NË ROMËN E VJETËR



### Diskutim: Çka është fejesa dhe martesja?

#### Fejesa

Në familjet e mëdha romake zakonisht kishte numër të madh të djemve të aftë për martesë dhe një numër gjithashtu të konsiderueshëm të vajzave të moshës së rritur. Djemve u lejohej të fejoheshin e të martoheshin vetëm me vajzat e lindura jashtë rrethit të familjes së gjerë. Edhe vajzat martoheshin me djem me të cilët nuk kishin afërsi gjaku. Personat që ishin të gatshëm për martesë ishin ata që kishin arritur në pubertet.

Në Romën e Vjetër, fejesa e dy të rinjve ishte akt solemn i tyre dhe i familjeve. Fejesa paraqiste dhënien dhe marrjen reciproke të premtimeve për lidhjen e martesës në mes dy të rinjve. Këto premtime i jepnin prindërit e vajzës dhe të djalit. Në ceremoni mund të merrnin pjesë me lejen e prindërve edhe bashkëshortët e ardhshëm. Çifti që martohej shkëmbente dhurata në mes vete. Fejesat ndërmjet dy të rinjve shpeshherë bëheshin edhe pa vullnetin e tyre. Mjaftonte vetëm vullneti i prindërve në mënyrë që dy të rinjtë të fejoheshin në mes tyre. Fejesë mund të lidhnin dy të rinj që i takonin së njëjtës shtresë shoqërore.

#### Si bëhej lidhja e martesës?

Martesa midis dy të rinjve në Romë duhej të bëhej sipas ligjeve dhe drejtësisë romake. Në fillim, e drejta romake e lejonte grabitjen e nuses si mënyrë të lejueshme të martesës. Mënyrë tjetër ishte e ashtuquajtura blerja e gruas. Sipas kësaj mënyre të lidhjes së

MARTESA ME  
DËSHMITARË NË  
ROMË



martesës, babai i nuses, ose kujdestari i saj, ia dorëzonte nusen kryetarit të familjes së dhëndrit apo vetë dhëndrit. Nga ana tjetër, dhëndri vetë ose babai i tij i jepnin kryetarit të familjes së nuses një monedhë të vogël në emër të çmimit simbolik që duhej paguar për nusen. Pas këtyre formaliteteve konsiderohej se ishte lidhur martesë e rregullt romake. Një formë tjetër e lidhjes së martesës që ishte e zakonshme për patricët, kërkonte 10 dëshmitarë të pranishëm edhe të fejuarit, me rastin e lidhjes së martesës.

Të gjithë të pranishmit duhej ta përcillnin nusen gjer në shtëpinë e dhëndrit. Në dyert e shtëpisë, dhëndri i jepte nuses zjarr dhe ujë dhe i ofronte bukë, ndërsa duke marrë bukën, zjarrin dhe ujin, duhej të thoshin së bashku këto fjalë: ubi tu Gaius, ibi ego Gaia (kudo që të jesh ti, do të jem edhe unë). Një formë e shpeshtë e martesës te plebenjtë ishte marrja e thjeshtë e nuses dhe dërgimi i saj në shtëpinë e dhëndrit pa ndonjë ceremoni.

### A kishte pengesa martesore në Romën e Vjetër?

Në Romë ekzistonin disa rrethana dhe kushte të caktuara të cilat nuk lejonin lidhjen e martesës midis dy njerëzve. Këto rrethana quheshin pengesa martesore.

Një nga pengesat kryesore ishte të qenët i martuar ndonjëri nga bashkëshortët. Pra, nuk lejohej poligamia. Sipas ligjeve romake të rregullta quheshin vetëm martesat monogamike. Pengesë tjetër ishte sëmundja shpirtërore e ndonjërit prej bashkëshortëve. Edhe afërsia e gjakut po ashtu ishte pengesë martesore, në vijë të drejtë pa kufi, ndërsa në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt.

Kishte edhe një varg ndalesash të tjera si: ndalohej martesë ndërmjet qytetarit të lindur në liri dhe së liruarrës me sjellje të këqija, ndalohej martesë ndërmjet senatorit dhe të liruarrës në përgjithësi, martesë ndërmjet të liruarrës dhe artistëve, skllevërve me qytetarët romakë etj.



## Fjalori

### Monogami-ke-

bashkëjetesa e një burri vetëm me një grua.

**Pubertet** - moshë e re kur njeriu kalon nga fëmijëria në adoleshencë; periudha e moshës kur fillon edhe pjekuria seksuale.

**Poligami** - martesë e një burri me disa gra.



## TË PUNOJMË SË BASHKU

Si bëheshin fejesat dhe martesat në Romën e Vjetër?

Mundohuni ta analizoni deri në detaje shprehjen: “Edhe afërsia e gjakut po ashtu ishte pengesë martesore, në vijë të drejtë pa kufi, ndërsa në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt”.

## VI

## 27. ZHVILLIMI EKONOMIK I ROMËS

**Nga një ekonomi e dobët u bë fuqia kryesore mesdhetare**

Fillimisht ekonomia romake ishte e pazhvilluar. Karakterizohej nga bujqësia e dobët krahasuar me popujt e tjerë. Tregtia dhe artizanatet ishin në nivel të ulët. Gjatë dy shekujve të parë të ekzistimit të Perandorisë pati kriza ekonomike. Ekonomia romake bazohej kryesisht në punën fizike të skllevërve. Zgjerimi i shtetit romak ndikoi pozitivisht në zhvillimin ekonomik me ritme të shpejta. Romakët mësuan shumë gjëra në kontakt me ilirët, grekët, kartagjenasit dhe popujt e tjerë. Në shekullin I pas Krishtit, rifilloi prodhimi i enëve, rrobave të leshta, artikujve të ndryshëm prej bronzi, argjile, qelqi. Në qytete, zejtaria dhe tregtia njohën ritme të shpejta zhvillimi. Edhe ekonomia agrare u zhvillua me shpejtësi. Romakët shfrytëzuan rrugët e vjetra dhe detin për të tregtuar prodhimet e tyre. Perandoria Romake e rrethoi tërësisht Mesdheun, të cilin e quajtën “deti ynë”. Anijet lundruese romake lundronin në Mesdhe si dhe në lumenjtë kryesorë të Perandorisë deri në lumin Nil. Bashkë me grekët dhe ilirët, Roma ishte fuqi kryesore ekonomike mesdhetare.

**Metalurgjia**

Minierat u bënë burim i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik të Perandorisë Romake. Rajonet kryesore të minierave të perandorisë ishin: Gadishulli Iberik ku nxirrej ari, argjendi dhe hekuri; Britania ku nxirrej hekuri, plumbi dhe kallaji; minierat romake në provincat e Danubit, Maqedonisë, Trakisë dhe Azisë së vogël ku nxirreshin metale të ndryshme. Prodhimet që dilnin nga këto miniera

shfrytëzoheshin për tregun e brendshëm dhe të jashtëm. Mallrat romake gjendeshin nëpër të gjitha tregjet e botës antike.

**Tregtia**


Roma fillimisht bënte tregti me provincat e veta. Ajo u zgjerua edhe në pellgun e Mesdheut ku bëhej tregti me grekët, ilirët dhe popujt e tjerë mesdhetarë. Në ndërkohë, tregtia u shtri jashtë kufijve deri në Kinë dhe Indi.

PUNËTORI ROMAKE 

Përveç interesave ekonomikë, me rastin e shkëmbimit të mallrave tregtare, romaket përfituan edhe duke gërshetuar kulturën e tyre me kulturat e popujve të tjerë, duke filuar nga kultura mesdhetare e deri në lindjen e lashtë.

Shkëmbimet tregtare ndikuan në pasurimin e prodhuesve dhe tregtarëve romakë të cilët u bënë pjesë e rëndësishme e shoqërisë romake.

 HARTA TREGTARE E ROMËS



## TË PUNOJMË SË BASHKU

Si u bë Roma fuqi kryesore ekonomike mesdhetare?



## VI

## 28. FILOZOFIA, SHKENCA DHE KULTURA ROMAKE



SALLA E FILOZOFËVE



**Shkencat** e tjera që u studiuan nga romakët, ishin: mjekësia, astronomia, gjeologjia, astrologjia, shkencat e natyrës etj.

**Retorika** në Romën e Vjetër ishte veprimtari shumë e rëndësishme. Fjalimet e shpeshta në Senat ndikuan shumë në zhvillimin e artit të oratorisë apo retorikës. Në Romë ishte ngritur një shkollë ku mësohej retorika. Oratorët më të njohur romakë ishin: Mark Tul Ciceroni, Tiber dhe Gai Graku, Mark Bruti, Gaj Jul Cezari, Mark Antoni etj.

**Arkitektura** romake ishte gërshetim i asaj greke dhe etruske. Romakët ndërtuan ura, objekte banimi, tempuj, sheshe, rrugë, banja termale publike, cirk, teatër, amfiteatra të mëdhenj, ujësjellës, kanalizime. Amfiteatri më i madh ishte Koloseumi, i cili zinte afër 50.000 spektatorë, kurse pallati më i njohur ishte ai i Dioklecianit në Split. Për ndërtim përdornin tullën e pjekur dhe çimenton e njohur romake.

KOLOSEUMI



**Skulptura** origjinale romake mori përhapje të gjerë në shekullin II para Krishtit. Romakët i përdornin skulpturat për zbulime arkitektonike, objekte për dekorim, por edhe si përmendore mbivarrore. Skulpturat i punonin kryesisht nga guri, ndërsa më vonë edhe nga mermeri. Skulpturat me temë historike dhe portretet u zhvilluan më së shumti në kohën e Cezarit.

**Piktura** në Romë vlerësohej si një veprimtari e rëndësishme. Romakët pikturonin përfytyrimin për perënditë, perandorët, personalitete të shquara politike e kulturore, piktura me motive nga luftërat e romakëve etj.

**Muzika** në Romën e Vjetër ishte pjesë e kulturës romake që nga kohët më të hershme. Kënga ishte pjesë përbërëse e pothuajse çdo aktiviteti shoqëror. Instrumenti më i përhapur muzikor ishte Tuba. Tuba romake ishte një instrument i gjatë prej bronzi.

**Letërsia** romake, e shkruar në gjuhën latine, mbetet një trashëgimi e qëndrueshme e kulturës së Romës së lashtë. Disa nga punimet e hershme letrare janë: epika historike që tregojnë historinë e hershme ushtarake të Romës, e ndjekur nga poezia, komeditë, historitë dhe tragjeditë. Letërsia romake e arriti lulëzimin më të madh në kohën e Oktavian Augustit. Poetët më të njohur të kësaj periudhe janë: Virgjili, Horaci dhe Ovidi.

**Besimi romak** identifikohet me politeizmin primitiv. Për romakët e zakonshëm, feja ishte pjesë e jetës së përditshme. Çdo shtëpi kishte një tempull familjar, në të cilin bëheshin lutje. Të gjitha fenomenet natyrore kishin perëndinë e vet. Besimi romak ishte i ndikuar nga ai etrusk dhe grek.

Perëndia kryesore e romakëve ishte Jupiteri. Junona ishte gruaja e Jupiterit. Minerva ishte perëndesha e urtësisë, Venera perëndesha e bukurisë, Marsi zot i luftës etj.

Romakët e vjetër ndërtuan faltore (tempuj) për nder të perëndive.



ROMAKËT DUKE EKZEKUTUAR MUZIKË



## TË PUNOJMË SË BASHKU

Shpjegoni ngjarjet historike duke përdorur retorikën.

## VI

## 29. VENDBANIMET, QYTETET DHE JETA E PËRDITSHME ROMAKE

**Shtëpitë romake**

Romakët jetonin në fshatra dhe qytete. Shtëpitë e romakëve në fillim ishin të vogla. Ato ishin kryesisht njëkatëshe dhe kishin një dhomë të madhe e një deri në dy dhoma fjetjeje. Në dhomën e madhe ndizej zjarri, ushqeheshin familja, shfrytëzohej për qëndrim ditor dhe ruheshin gjërat e vlefshme. Në shekujt II-I para Krishtit romakët filluan të ndërtonin edhe shtëpi dy e trekatëshe. Këto shtëpi i ndërtonin të pasurit. Brenda tyre kishte dhoma dhe ambiente të mjaftueshme për familjen dhe për mysafirët. Dhomat zbukuroheshin me punime artistike, sidomos me piktura që varehin në mur dhe skulptura të ndryshme. Dyshemeja dekoroheshin me mozaikë, ndërsa muret e jashtme dekoroheshin me mermer.

SHTËPI ROMAKE

**Qytetet**

Qyteti i Romës ishte qyteti kryesor i periudhës mbretërore, republikane dhe perandorake romake. Roma ishte vendosur pranë brigjeve perëndimore të Italisë Qendrore. Qyteti në fillim ishte i vogël, por u rrit kur shteti mori hov të madh të zhvillimit. Kishte rrugë të shumta që çonin në qytetin e Romës. Rrugët në gjuhën latine quheshin “via”.

Romakët e kishin ndërtuar ujësjellësin. Të pasurit kishin ujë brenda në shtëpitë e tyre, ndërsa pjesa tjetër e popullit mori ujin e tyre nga burimet e vendosura rreth qytetit. Në qendër të qytetit ishte një shesh i rrethuar nga ndërtesa publike si tempuj të perëndive, ku mund të bëhej tregti dhe të kryheshin funksione të tjera publike. Shumë nga ngjarjet më të mëdha të qytetit u zhvilluan në sheshe të tilla si zgjedhjet, fjalimet publike, gjyqet etj.

Qytetet e tjera romake ishin më të vogla dhe nuk e kishin rëndësinë e Romës. Pas zgjerimit të Perandorisë u ndërtuan dhe u zhvilluan edhe qytete të tjera të shumta.

Ndër qytetet më të njohura ishin: Roma (753 para Krishtit), Ariminium-Rimini (268 para Krishtit), Placentia-Piacenza (218 para Krishtit) etj. Qytete të ndryshme u ndërtuan e u zhvilluan edhe jashtë Italisë. Ndër qytetet më të njohura në provincat romake janë: Tarragona në Spanjë (218 para Krishtit), Kotorri në Iliri (168 para Krishtit), Valencia në Spanjë (138 para Krishtit), Naisus-Nishi në Iliri (73 para Krishtit), Sirmiumi-Sremi në Iliri (14 para Krishtit) etj.

RIMINI, HARKU I AUGUSTIT

**Një ditë e zakonshme në Romë**

Familja ishte shumë e rëndësishme për romakët. Kreu i familjes ishte babai i quajtur “paterfamilias”. Ligjërisht, ai kishte të gjithë fuqinë në familje. Gruaja shpeshherë mbante financat dhe menaxhonte familjen. Një ditë e zakonshme romake fillonte në mëngjes. Pastaj njerëzit shkonin në punë. Puna përfundonte pasdite. Në mbrëmje hahej darka e përbashkët në familje. Darka ishte shumë e rëndësishme si ngjarje për romakët, sepse në darkë mblidheshin gjithë familja.

Fëmijët e zakonshëm romakë në moshën parashkollore jetonin nën përkujdesin e familjes, luanin me lojërat e tyre dhe nuk kishin

obligime të tjera. Fëmijët e moshës shkollore ndiqnin mësimet nëpër shkolla. Disa familje, përveç edukimit të fëmijëve në shkolla, kishin edhe mësues të angazhuar në shtëpi. Ata mësonin lexim, shkrim, matematikë, letërsi, retorikë etj. Fëmijët e familjeve të varfra dhe të skllëverve nuk shkonin në shkollë.

Romakët hanin mëngjes të lehtë dhe ushqime të pakta gjatë ditës. Ushqimet kryesore të tyre ishin: fasulja, peshku, perimet, djathi dhe frutat e thata. Mish hanin më rrallë.

Në përditshmërinë e tyre romakët vishnin Toga që ishte një mantel i gjatë. Të pasurit mbanin rroba të bardha prej leshi ose liri. Disa ngjyra dhe shenja të togave ishin të rezervuara për disa njerëz dhe raste të caktuara. Për shembull, një togë me një kufi të purpurt ishte veshur nga senatorë dhe konsuj të rangut të lartë, ndërsa një togë e zezë zakonisht ishte veshur vetëm gjatë kohërave të zisë. Veshje e rëndësishme ishte edhe tunika me një mantel kur ishte ftohtë.

### Profesionet dhe punët e përditshme në Romë

Roma e lashtë ishte një shoqëri ku njerëz të shumtë bënë punë të ndryshme në jetën e tyre të përditshme.

**Fermerët** jetonin në fshat dhe merreshin me punë të bujqësisë dhe blegtorisë.

**Ushtarët** për të fituar një pagë të rregullt dhe një copë tokë sipas ligjeve romake, shërbenin si ushtarë gjithë kohën.

**Tregtarët** e të gjitha llojeve shitnin dhe blinin në tregjet e Perandorisë dhe më gjerë.

**Zehtarët** merreshin me punimin e gjërave të ndryshme duke filluar nga enët, bizhuteritë, armët për ushtrinë dhe punime të tjera artizanale. Profesionin e zejtarit zakonisht e trashëgonin fëmijët pasardhës.

**Argëtuesit** - populli i Romës së lashtë pëlqente të argëtohej. Ashtu si sot, ka pasur një numër artistësh në Romë duke përfshirë muzikantë, valltarë, aktorë, garues karriere dhe gladiatorë.

**Avokatët, mësuesit, inxhinierët** - romakët më të arsimuar mund të bëheshin avokatë, mësues dhe inxhinierë.

**Dijetarët dhe shkencëtarët** merreshin me zhvillimin e dijes dhe të shkencave.

**Senatorët** merreshin me politikë dhe drejtonin kuvendet popullore.

**Konsujt** drejtonin shtetin në kohën e Republikës.

**Perandorët** merreshin me qeverisjen dhe sundimin e Perandorisë Romake.

Në Romë kishte edhe shumë profesione dhe punë të tjera të përditshme që kryenin njerëz të caktuar.



## Fjalori

**E purpurt** - ngjyrë e kuqe e ndezur.



### TË PUNOJMË SË BASHKU

Hulumtoni dhe gjeni shënime për personalitete të tjera të botës romake si: Pompeu, Mark Antoni, Trajani etj.

## VI

30. PERSONALITETE TË SHQUARA  
TË QYTETËRIMIT ROMAK

**Jul Cezari** (12 korrik 100 -15 mars 44 para Krishtit) – u lind në një prej familjeve më të vjetra aristokrate në Romë. Cezari ishte ushtarak dhe burrshtetas romak. Ai ka luajtur një rol të rëndësishëm në transformimin e Republikës Romake në Perandori Romake. Ishte njëri ndër nënshkruesit e Triumviratit të Parë. Ai i zgjeroi kufijtë e Perandorisë Romake deri në Britaninë e Madhe dhe në oqeanin Atlantik. Cezari konsiderohet si një prej gjenive ushtarake më të mëdhenj të kohës dhe një prej liderëve më të shquar. Përveç veprimtarisë ushtarake, Cezari u shqua edhe për veprimtarinë letrare e historike. Jul Cezari u vra nga kundërshtarët e tij politikë.




**Oktavian Augusti** (23 shtator 63 - 19 gusht 14 pas Krishtit) – u lind në Romë. Rrjedh nga një familje romake nga qyteti i Velletrit. Kur u vra Jul Cezari më 15 mars të vitit 44 para Krishtit, Oktaviani po studionte në Apoloni të Ilirisë. Me të dëgjuar lajmin, ai u nis për në Romë. Cezari ishte daja i tij dhe meqë nuk kishte fëmijë të ligjshëm sipas ligjit romak, Oktaviani ishte i biri i adoptuar i tij dhe mbeti trashëgimtari kryesor i Cezarit. Oktaviani ishte një burrë shteti dhe kreu ushtarak romak, i cili ishte perandori i parë i Perandorisë Romake. Së bashku me Mark Antonin dhe Markus Lepidin formuan Triumviratin e Dytë. Koha e qeverisjes së tij njihet si periudhë e lulëzimit të Perandorisë Romake në të gjitha fushat.


**Spartaku** (rreth 109-71 para Krishtit) - ishte gladiator nga Trakia. U bë i famshëm pasi udhëhoqi skllëverit në kryengritje kundër romakëve. Plutarku thotë se ai ishte nomad. Historiani Appian thotë se Spartaku kishte luftuar në një kohë në vetë ushtrinë romake, por më vonë u burgos dhe u bë skllav. Pasi u lirua, u shit si gladiator. Edhe gruaja e Spartakut ishte skllavëruar së bashku me burrin e saj. Pas skllavërimit të tij, Spartaku u stërvit në kampin e gladiatorëve pranë Capuas. Spartaku u zgjodh një nga udhëheqësit e gladiatorëve të arratisur, së bashku me Denoma dhe Kriksus, dy skllëvër të tjerë gladiatorë. Spartaku bashkë me shumë skllëvër u vranë në luftë kundër legjioneve romake. Appian-i pretendon se trupi i Spartakut nuk u gjet kurrë.



**Plutarku** - u lind në një familje të shquar në qytetin e vogël të Kaeronas, në lindje të Delphi-t, në rajonin grek të Boetisë. Familja e tij ishte e pasur. Plutarku studioi matematikën dhe filozofinë në Akademinë e Athinës. Duke qenë afër me romakët, kishte krijuar miqësi me politikanë e shtetarë. Plutarku mori nënshpirtësinë romake. Për shumë vite ai shërbeu si një nga dy priftërinjtë në tempullin e Apolonit në Delphi. Me shkrimet dhe ligjëratat e tij, Plutarku, u bë një njeri i famshëm në Perandorinë Romake. Ai shkroi shumë për romakët, sklllevërit, luftërat dhe ngjarje të tjera të rëndësishme.



**Diokleciani** (22 dhjetor 244-3 dhjetor 311) - u lind në Dalmaci të Ilirisë. Ishte perandor romak që qeverisi nga viti 284 deri më 305. Familja e tij nuk njihet si familje aristokrate me traditë. Babai i tij ishte punëtor i zakonshëm që punonte për senatorin Anullinus. Diokleciani u ngjiti në radhët e ushtrisë për t'u bërë komandant i kalorësisë romake në krah të perandorit Carus. Mori pjesë në shumë beteja të luftës ku doli fitimtar. Pas vdekjes së Carusit dhe djalit të tij në betejat e luftës në Persi, Diokleciani u shpall perandor. Ai e stabilizoi perandorinë duke i dhënë fund krizës që e kishte kapluar në shekullin e tretë. Diokleciani siguroi kufijtë e perandorisë dhe eliminoi të gjitha kërcënimet që mund ta rrezikonin pushtetin e tij.



**Trajani** (18 shtator 53 - 8 gusht 117) - u lind në Italika afër Seviles së sotme që ishte provincë romake. Ishte perandor i cili sundoi nga viti 98 deri në vitin 117. Senati e kishte shpallur si sundimtarin më të mirë. Trajani njihet si perandor i cili e zgjeroi më së shumti shtetin romak. Është i njohur për ndërtime publike, sheshe dhe infrastrukturë. Vdiq në vitin 117 teksa lundronte me anije afër brigjeve të Romës. Historianët e vjetër mendojnë se vdiq nga sulmi në zemër. Postin e tij e trashëgoi i biri i adoptuar Hadriani.



**Konstandini i Madh** ( 27 shkurt 272 - 22 maj 337) - u lind në qytetin ilir Naisus - Nishi i sotëm. Pas vdekjes së babait të tij, gjeneralit Flavius Valerius, u rrit në pallatin perandorak të Dioklecianit. Ai mundi kundërshtarët e tij Licinius dhe Galerius dhe u bë perandor i Romës. Në vitin 313 me Ediktin e Milanos e zyrtarizoi krishterimin duke lejuar që ky religjion të ushtrohej i lirë. Në vitin 330 e zhvendosi kryeqytetin e Perandorisë nga Roma në Bizant (Stambolli i sotëm). Për nder të tij ky qytet u quajt Konstandinopoja. Konstandini ndërtoi shumë kisha, biblioteka, banja publike, ndërtesa dhe sheshe.

## VI

## 31. LINDJA E KRISHTERIMIT

**Si lindi besimi në një perëndi?**

Në vitin 26 para Krishtit, romakët vendosën sundimin e drejtpërdrejtë mbi hebrejtë. Ata e caktuan Pons Pilatin si guvernator. Ai nuk shfaqte tolerancë për traditat hebraike, prandaj populli shpeshherë revoltohej në të. Në vitin 63 para Krishtit njerëzit kishin filluar të besonin në një Zot dhe ishte paralajmëruar ardhja e shpëtimtarit të njerëzimit. Njerëzit që prisnin shpëtimtarin - Mesinë, ishin të bindur se ai do t'u ndihmonte. Ndër më të zëshmit që fliste me optimizëm për ardhjen e shpëtimtarit, ishte Johani. Rugën e Johanit e ndoqën edhe tregtarë e shtegtarë të shumtë dhe njerëz të ndryshëm, të cilët ishin të bindur për ardhjen në tokë të birit të Zotit. Kështu gradualisht lindi dhe u përhap besimi në një perëndi.

Krishterimi i ka rrënjët në religjionet e mëhershme si të egjiptasve, të hebrejve dhe të popujve të tjerë të Lindjes.

**Kush ishte Jezus Krishti?**

JEZU KRISHTI

Jezus Krishti ose Jezusi i Nazaretit ishte i biri i Marisë, e cila ishte e fejuar me Jozefin. U lind në Betlehem, afër Jerusalemit. Ai ishte i zakonshëm si gjithë fëmijët e tjerë. Ndërkohë filloi të punonte si zdrukthëtar në qytetin e Nazaretit në Galile.


Në fillim të tridhjetave, Jezusi filloi që të shkonte nga njëri fshat në tjetrin, duke shëruar ata që vuanin nga sëmundje të ndryshme dhe duke predikuar besimin në Zot.

Sipas Biblës, Jezusi deri në moshën 30-vjeçare nuk dha mësim as nuk bëri mrekulli, kështu që njerëzit nuk e dinin se ai ishte shpëtimtari të cilin e prisnin. Jezus Krishti jetoi 33 vjet, po vetëm 3 vjetët e fundit u shfaq publikisht dhe veproi për krijimin e krishterimit. Ai bënte punë të mira e humane çdo ditë. Me këto veprime dhe predikime të tij pati sukses të tubonte rreth vetes shumë përkrahës, të cilët e konsideronin si shpëtimtar. Sa më shumë rritej autoriteti i Jezusit, aq më shumë ndiheshin të rrezikuar sundimtarët. Për këtë arsye ai u zu dhe iu dorëzua Pons Pilatit, guvernatorit romak në Palestinë, me akuzën se po përgatiste kryengritje kundër Romës. Pilati e dënoi me dënimin më të rëndë duke e gozhdur në kryq.

Lindja e Jezusit festohet çdo vit më 25 dhjetor (ose data të ndryshme në janar nga disa kisha lindore ortodokse) si një festë e njohur si Krishtlindje. Kryqëzimi i Jezusit nderohet të premtën e mirë dhe ringjallja e tij festohet në Pashkë.

**Bibla - libri i shenjtë i të krishterëve**

Bibla është libri i shenjtë i të krishterëve. Aty përmbledhen vlera



edukative, morale, letrare e artistike. Ky libër i shenjtë përbëhet nga Dhjata e Vjetër, Psalmet dhe Dhjata e Re, të cilat janë shkruar për një periudhë të gjatë kohore.

Në përmbajtjen e Biblës mund të lexojmë historinë e njerëzimit duke filluar nga Abrahami e Moisiu, deri në ardhjen e Jezu Krishtit. Bibla përmban rregullat e fesë krishtere, të cilat i respektojnë besimtarët e këtij religjioni. Në Bibël gjejmë edhe fillet e para të krishterimit dhe përhapjes së tij.



KOPJE E VJETËR E BIBLËS 

### **Përhapja e krishterimit**

Në shekullin II krishterimi mori përhapje të gjerë në të gjitha krahinat e Perandorisë Romake. Përhapjen e ideve të krishterimit e përhapnin misionarët, tregtarët e posaçërisht të dërguarit e veçantë, të cilët quheshin apostuj. Përmes tyre krishterimi mori përhapje të gjerë në Lindje, në Azi të Vogël, në Ballkan, në Afrikë e po ashtu, edhe në vetë qendrën e Perandorisë, në Romë. Ndër apostujt e parë që përhapen krishterimin me sukses ishte Pali. Bashkësitë e para të krishtera u formuan edhe në Romë dhe drejtoheshin nga Pjetri dhe Pali, të cilët njihen edhe si dëshmorët e parë të krishterimit, meqë u dënuan me vdekje nga perandori Neron. Shtëpitë e Zotit ku kryheshin ritet e krishtera u quajtën kisha. Ka fundi i shekullit I dhe fillim shekulli II u shkruan shumë tregime për Jezu Krishtin. Këto tregime u quajtën Ungjij. Krishterimin si fe e kishte zyrtarizuar perandori me prejardhje ilire Konstandini i Madh me Ediktin e Milanos në vitin 313.

### **Krishterimi në Iliri**

Krishterimi në Iliri është shumë i hershëm. Daton që nga koha e apostujve në shekullin I. Përhapja e krishterimit në Iliri kishte vështirësi, të cilat vazhduan deri në vitin 313, kur feja u legalizua në Perandorinë Romake, e cila sundonte territoret ilire. Dardania në shekullin IV u bë qendër e madhe e krishterimit. Në Ulpianë u vendos qendra e Ipehkvisë. Martirët e parë të krishterimit, Flori dhe Lauri, ishin gjithashtu nga Dardania.




### **TË PUNOJMË SË BASHKU**

Shikoni filmin për Jezu Krishtin dhe pastaj diskutoni më gjerësisht për fillet e para të besimit në një perëndi, dhe përhapjen e krishterimit.

Diskutoni për momentet që ju kanë pëlqyer më së shumti dhe arsyetoni pse!





# VII

QYTETËRIMI ILIR

## VII

## 32. SHTRIRJA DHE FISET KRYESORE ILIRE

**Kush ishin ilirët?**

Dijetarët kanë konstatuar se ilirët janë popullsi vendase në Ballkan dhe i takojnë familjes së popujve indoevropianë. Ata janë ndër popujt më të vjetër të Gadishullit Ballkanik. Ka shumë studiues që mendojnë se pellazgët ishin fise parailire dhe ilirët janë pasardhës të tyre. Ilirët përmenden që në shekullin V para Krishtit në veprat e autorëve antikë, kurse emrat e disa fiseve ilire i përmend Homeri që në shek. XII para Krishtit. Fillet e prezencës ilire dhe origjina e tyre datojnë që në mesin e mijëvjeçarit të dytë para Krishtit. Në mijëvjeçarin e fundit para Krishtit, ilirët u formuan plotësisht, duke trashëguar nga epokat më të hershme neolitike dhe të bronzit tiparet kulturore, gjuhësore e antropologjike etnike të një populli që jetonte në shumë fise, por që kishin origjinë të përbashkët.

**Shtrirja e fiseve ilire**

Ilirët kanë jetuar në pjesën veriperëndimore dhe qendrore të Gadishullit Ballkanik. Trevat ku shtriheshin ilirët, nga veriu, kufizoheshin me lumenjtë: Sava, Drava dhe Danubi; nga lindja: Morava dhe Vardari; nga jugu shtriheshin deri në Gjirin e Ambrakisë, ndërsa nga perëndimi kufizoheshin me Detin Adriatik dhe me Detin Jon. Disa fise ilire (japigët, mesapët, lukanët etj.) kanë jetuar edhe në Gadishullin Apenin (në Italinë e sotme). Në gjysmën e mijëvjeçarit II para Krishtit (shek. XVI-XIII), prezencën ilire e gjejmë edhe në Azinë e Vogël, ku jetonin ilirë nga fisi i dardanëve dhe i paionëve.

Jetën, gjuhën, kulturën, dhe tiparet antropologjike ilirët i formuan në Gadishullin Ballkanik. Edhe autorët antikë, kur flasin për shtrirjen dhe gjeografinë ilire, përmendin Gadishullin Ballkanik si territor ku shtrihej Iliria.

**Disa nga fiset ilire**

Sipas shënimeve të historianëve grekë dhe romakë dhe bazuar në studimet e kohës sonë, ilirët jetonin në fise dhe në grupe fisesh. Kanë ekzistuar mbi 70 fise ilire të mëdha dhe të vogla. Në mesin e tyre mund të numërohen: enkelejtë, taulantët, dardanët, ardianët, molosët, dalmatët, dasaretët, paionët, thesprotët, dokleatët, albanët, penestët, kaonët etj.



USHTAR ILIR

**ENKELEJTË**- ishin një nga fiset më të hershme që formuan shtetin ilir në fund të shek. V para Krishtit. Ata jetonin në zonat në afërsi të liqenit të Ohrit. Qyteti kryesor i tyre ishte Enkelana. Në territoret e fisit të enkelejve dhe shtetit të tyre kishin jetuar edhe fisi i dasaretëve dhe disa fise të tjera më të vogla. Veprimtaria më e rëndësishme e tyre ishte peshkataria.

**TAULANTËT**- shtriheshin nga lumi Vjosa, deri në afërsi të Durrhahut. Pra, jetonin përgjatë zonës bregdetare. Në shek. IV-III, para Krishtit e drejtuan shtetin ilir. Në trevat e taulantëve, më vonë, shfaqet fisi i albanëve dhe ai i parthinëve. Ata ishin detarë dhe peshkatarë të njohur.

**DARDANËT**- ishin fisi më i madh ilir që jetonin në territoret e Kosovës së sotme dhe në viset përreth. Ata formuan shtetin e tyre. Dy fise të tjera që jetonin në territoret e Dardanisë ishin thunatët dhe galabrët. Qyteti më i rëndësishëm i dardanëve ishte Damasioni. Dardania u njoh si vend ku nxirreshin metalet. Ata ishin: xehetarë, bujq, blegtorë, bletarë dhe tregtarë të shquar.

**ARDIANËT**- shtriheshin rreth gjirit të Rizonit dhe të lumit Nerona. Kur e krijuan mbretërinë e tyre, ardianët e shtrinë pushtetin e vet edhe në territore të fiseve të tjera ilire deri në Shkodër dhe përgjatë bregdetit. Ata luftuan kundër romakëve gjatë shek. III-II para Krishtit. Janë të njohur për flotën e fuqishme që krijuan, për luftë kundër romakëve.

**MOLOSËT**- në Epir jetonin disa fise ilire. Njëri nga kryesorët ishte fisi i molosëve. Ata krijuan shtetin e tyre. Ky shtet, fuqinë më të madhe dhe lulëzimin kulturor e arriti në kohën e mbretit Pirro. Shtetin e Epirit e njohën edhe grekët, romakët dhe maqedonasit.


**DALMATËT**- banonin në brigjet e Adriatikut në krahinën e sotme të Dalmacisë. Shquheshin për punimin e llojeve të ndryshme të veshjeve prej liri e leshi. Veshja e njohur me emrin dalmatika në shekujt e parë u përdor edhe nga aristokracia romake. Në Dalmaci lindi perandori romak Dioklecian. Qyteti më i njohur i tyre ka qenë Delmini.

 SHTRIRJA E FISEVE ILIRE



## VII



 USHTARËT ILIRË NË  
BETEJAT E LUFTËS

**DESARETËT**- jetonin në Ilirinë Juglindore. Njihen si një nga fiset e mëdha ilire. Ata njiheshin si bujq të vyer dhe prodhonin drithëra, fruta, perime etj. Një nga qytetet më të njohura ishte Pelioni (qyteza në Selcë të Poshtme të Pogradecit). Qytet tjetër i madh i këtij fisi ishte edhe Antipatra (Berati i sotëm).


**PAIONËT**- banonin në luginën e sipërme të Vardarit, në kufi me dardanët. Në gjysmën e parë të shek. IV, paionët krijuan mbretërinë. Ata bënë shumë luftëra me maqedonasit. Paionët, në shek. IV-II para Krishtit, prenë monedhën e tyre prej argjendi. Ata përmenden edhe nga Homeri në veprat e tij.

**THESPROTËT** - shtriheshin në krahinën e Epirit. Kufijtë e tyre fillonin në jug të lumit të sotëm Kallama, deri në Gjirin e Ambrakisë. Autorët antikë në shkrimet e tyre i përmendin thesprotët si njerëz punëtorë që kryesisht merreshin me bujqësi, blegtori dhe zejtari. Kishin jetë të organizuar dhe për udhëheqës zgjidhnin njerëzit më të aftë të fisit.

**ALBANËT** - shtriheshin nga Kruja e deri në afërsi të Durrhahut. Ata njihnin jetën e zonave të larta të përshtatshme për blegtori, por njihnin edhe zanatin e bujkut, tregtarit e zejtarit në zona të rrafshëta. Qyteti i tyre më i rëndësishëm ishte Albanopoli (Zgërdheshi i Krujës). Nga fisi i albanëve e morën emrin albanë, arbër- të gjithë shqiptarët e mesjetës, por edhe të periudhave më të vonshme historike.

**PENESTËT**- banonin në luginën e Drinit të Zi. Përmenden për herë të parë nga autorët antikë në vitet 170-169 para Krishtit. Ishin luftëtarë të dalluar. Patën aleancë me shtetin e ardianëve dhe fiset e tjera ilire në luftë të përbashkët kundër romakëve. Mbajtën pozita të rëndësishme në Luftën e Tretë Iliro-romake. Ndërtuan qytete e kështjella për t'u mbrojtur nga armiqtë.

**KAONËT**- shtriheshin përgjatë rrjedhës së lumit Thyamios (sot lumi Kallama). Pra, jetonin në një pjesë të rëndësishme të shtetit të Epirit. Qyteti kryesor i tyre ishte Foinike (Finiqi i Sarandës). Ky qytet, në shek. III para Krishtit, u bë kryeqendra e shtetit të Epirit. Qytet tjetër i madh i kaonëve ishte Antigonea (Saraqinisht i Gjirokastrës). Ishin pjesë e rëndësishme e shtetit të Epirit.



## Fjalori

**Antropologjia**- shkenca që studion veçoritë biologjike të njeriut si qenie e gjallë.

 APOLONIA



## TË PUNOJMË SË BASHKU

Krahasoni territorin ku shtriheshin ilirët me territoret ku jetojnë shqiptarët sot dhe nxirrni përfundime!

## VII

## 33. VENDBANIMET, SHTËPITË DHE QYTETET ILIRE

**Kalatë ilire si vendbanime**

Nga të gjitha gjurmët e kulturës materiale të ilirëve, më të ruajturat, deri në ditët e sotme janë kalatë. Shtëpitë dhe vendbanimet e vogla janë shkatërruar me kalimin e kohës dhe ka fare pak gjurmë të tyre. Vendbanimet e tipit të kalave janë gjetur çdokund në territoret ilire. Ilirët ndërtuan vendbanime në zonat kodrinore-malore, por edhe në zonat e rrafshëta fushore afër lumenjve për arsye të kushteve më të mira për jetë.

Kalatë ilire ndërtoheshin në vende strategjike në lartësi për t'u mbrojtur nga armiqtë. Muret mbrojtëse ndërtoheshin me gurë të mëdhenj. Banorët ilirë hynin në kala përmes një ose më shumë portave, varësisht nga madhësia e kalasë. Brenda kalave të mëdha ishin të ndërtuara shtëpitë e banimit afër njëra-tjetrës.

BUTRINTI - NJË VENDBANIM

**Si dukeshin shtëpitë ilire?**

Shtëpitë e banimit të ilirëve të ndërtuara afër lumenjve ishin kryesisht në formë katrore. Skeleti i tyre ndërtohej me lëndë të trasha druri. Dyshemeja dhe muret ishin të lyera me argjilë, kurse kulmi/pullazi ishte me dy anë dhe mbulohej me kashtë ose me dërrasa. Këto shtëpi kishin brenda tri ambiente banimi. Në njërin ambient, që ishte më i madh, gjendej vatra e zjarrit. Kjo dhomë shfrytëzohej për qëndrim ditor të familjes. Kurse, dy ambientet e tjera shfrytëzoheshin për fjetje. Dhoma e ditës nuk kishte tavan për shkak se aty ndizej zjarri dhe tymi dilte më lehtë. Dy dhomat e tjera kishin tavan që shfrytëzohej si depo ku ruheshin drithërat. Arkitektura e banesave ilire dallonte prej vendit në vend, duke iu përshtatur klimës dhe faktorëve të tjerë të rëndësishëm. Ilirët ndërtuan edhe shtëpi prej guri. Muret ndërtoheshin prej guri, kurse ambientet e brendshme dhe tavani me lëndë drusore.

**Urbanizimi i qyteteve ilire**

Rezultatet që dalin nga zbulimet e fundit arkeologjike na njoftojnë për urbanizimin e qyteteve ilire. Urbanizimi nënkupton ndërtimin e shtëpive me plane, rrugët e gjëra, kanalizimet, ujësjellësit etj. Këto elemente të urbanizimit i gjejmë në qytetet e vjetra ilire si: Albanopol afër Krujës, në Pelion afër Pogradecit, në Bylis të Fierit, në Dimal të Beratit, në Gajtjan të Shkodrës etj. Ilirët morën shembuj të urbanizimit edhe nga kontaktet me grekët dhe romakët. Në qendrat urbane jetonin fisnikëria ilire, magjistarët, artistët, tregtarët dhe njerëz të tjerë me profesione të ndryshme. Shumë qytete ilire luajtën rol të madh duke u bërë qendra të rëndësishme.

### Qytete të njohura ilire

Zhvillimi ekonomik ndikoi në rritjen dhe zhvillimin e qyteteve në Iliri. Ato përparuan si rezultat i shtimit të popullsisë në qytete dhe zhvillimit të zejtarisë e tregtisë. Në Iliri u ndërtuan shumë qytete, si:

**Damastioni**- qyteti kryesor i Dardanisë. I ndërtuar rreth shekullit V para Krishtit. Ishte qendër xehtare. Në Damastion u prenë monedha prej argjendi që mbanin emrin e qytetit.

**Skupi** - qendër e rëndësishme e Dardanisë. Mendohet se u ngrit në shekullin VI para Krishtit. Në vitin 518 u shkatërrua nga një tërmet i madh. Skupin e ri e ngriti perandori romak me origjinë ilire Justiniani I.

**Ulpiana** - qytet dardan. Ndodhet në afërsi të Prishtinës. Në shekullin III-IV njohu zhvillim të madh. Pas tërmetit e rindërtoi Justiniani. Më vonë, për nder të Justinianit, u quajt Justiniana.

**Albanopoli** - qyteti kryesor i albanëve. Gërmadhat e këtij qyteti ndodhen në afërsi të Krujës. Për herë të parë përmendet në shekullin IV para Krishtit.

**Apolonia** - njihet si qytet që nga shekulli VI para Krishtit. Ishte qendër e madhe ekonomike e kulturore. Ciceroni e ka vlerësuar Apoloninë si qytet shumë të bukur.

**Ulqini** - për herë të parë përmendet në vitin 168 para Krishtit. Banohej nga fisi i labeatëve. U përdor si port detar nga mbretëria e Ardianëve.

**Butrinti** - emri i tij i vjetër është Buthrotum. Ishte qytet shumë i rëndësishëm në periudhën greke dhe romake, sepse gjendej në rrugëkryqin që lidhte territore të rëndësishme. Përmendet për herë të parë në shekullin VII para Krishtit.

**Dyrrahu - Durrësi** - sipas autorëve antikë, ky qytet u themelua nga dy mbretër me origjinë ilire të quajtur Dyrrah dhe Epidamn. Ishte qytet i rëndësishëm tregtar. Aty u prenë edhe monedha prej bronzi e argjendi. Nga shekulli I-III pas Krishtit, qyteti i Dyrrahut shënoi një periudhë të lulëzimit kulturor. U bë edhe qendër dhe port kryesor i brigjeve të Adriatikut.

Qytete të tjera të rëndësishme ilire ishin edhe Lisi, Pelioni, Amantia, Naisusi, Foinike, Bylysi, Theranda etj.



### Fjalori

**Urbanizim**- rregullim i një qyteti ose qendre të banuar sipas një plani të caktuar për të krijuar kushte më të mira për jetesë e për punë.



AMFITEATRI ANTIK I DURRËSIT



### TË PUNOJMË SË BASHKU

Krahasoni shtëpitë e banimit të ilirëve me shtëpitë në të cilat jetojmë ne. Identifikoni qytetet ilire të cilat ekzistojnë edhe sot si qytete.



## VII

## 34. SI DUKESHIN ILIRËT?



USHTAR ILIR

**Ilirët ishin shtatlartë**

Sipas historianit grek, Herodotit, ilirët ishin shtathedhur dhe shumë të fuqishëm. Këto pohime i vërtetojnë edhe zbulimet arkeologjike të bëra në vendbanime të ndryshme të Ilirisë, duke filluar nga Sllovenia e sotme e deri në Greqi. Në hulumtimet që janë bërë në varreza ilire, janë gjetur eshtra të burrave dhe grave ilire, që dëshmojnë për shtatlartësinë e tyre. Edhe romakët i përshkruanin ilirët si burra të fuqishëm e shtatlartë.

Për përshtypjet e romakëve për ilirët mësojmë nga kanë shkruar historianët romakë të cilët kanë pasur kontakte me ilirët dhe shkruan për luftërat iliro-romake si dhe për tregtinë dhe bashkëpunimin midis tyre. Romakët i njohën më së miri ilirët në fund të shekullit I para Krishtit, dhe gjatë shekullit të parë pas Krishtit, kur e tërë Iliria u pushtua nga Perandoria Romake. Edhe gratë ilire shquheshin për shtatlartësi.

**Si dukeshin burrat dhe gratë ilire**

Duke parë monumente të artit dhe portrete ilire krijohet bindja se të gjithë ilirët mbanin mjekra. Por, në të vërtetë, mjekra nuk ishte e zakonshme për të gjithë. Shumë prej tyre i rruanin ato. Gjatë gërmimeve arkeologjike janë gjetur brisqe rroje prej bronzi në territoret ilire në Slloveni, Bosnje e Hercegovinë dhe përgjatë bregdetit Adriatik, që nënkupton se shumica e burrave i rruanin mjekrat. Kjo flet edhe për përkushtimin e tyre ndaj higjienës dhe pastërtisë.

GRA ILIRE - PIKTURË



Edhe tatuazhet ishin pjesë e kulturës së përgjithshme ilire. Sipas gjeografit grek, Strabonit, fisi ilir i japodëve e kishte për zakon të bënte tatuazhe në trupin e tyre. Edhe gjetja e gjilpërave me dorëza gjatë gërmimeve arkeologjike i vërteton këto pohime. Veshjet i kishin tradicionale dhe në dukje të përafërta me njëra-tjetrën.

Gratë ilire mbanin flokë të gjatë, visheshin me këmisha të gjata, në kokë vinin një shami për zbukurim. Ato mbanin stoli të ndryshme në trup dhe në veshje të tyre. Stoli të përditshme të grave ilire ishin: vathët, shamitë zbukuruese, byzylykët, qaforet, gjilpërat stolisëse etj.

### **Pastërtia trupore dhe higjiena e dardanëve**

Shpeshherë, në histori është shumë e vështirë të gjenden argumente për jetën e përditshme të popujve të vjetër. Sa u takon informatave për pastërtinë trupore të ilirëve dhe higjienën në përgjithësi, kemi shënime të pakta. Ekzistojnë të dhëna vetëm për dardanët. Sipas Strabonit, dardanët lahashin vetëm tri herë në jetë, njëherë kur lindnin, njëherë kur martoheshin dhe i lanin të vdekurit kur vdisnin, para se t'i varrosnin. Këto shënime të Strabonit për dardanët janë në kundërshtim me informatat që na i ofrojnë studiuesit modernë të kohës sonë. Sipas tyre, Straboni dhe disa autorë antikë e kanë ngatërruar higjienën e zakonshme me ritualet. Pra, dardanët u kushtonin rëndësi ritualeve të lindjes (lanin foshnjat kur lindnin), të martesës (larja rituale në martesë) dhe të vdekjes (lanin kufomat e njerëzve para se t'i varrosnin), kurse pastërtinë e zakonshme e kishin si gjithë të tjerët. Edhe fiset e tjera ilire, por edhe popujt e tjerë antikë, i kishin ritualet e veta, të cilave u kushtonin më shumë rëndësi.



## Fjalori

**Rituale** - tërësia e zakoneve që bëhen sipas një rregulli nga tradita për raste të caktuara të jetës së përditshme (lindje, martesë, besim, raste vdekjeje etj.).



### TË PUNOJMË SË BASHKU

Krahasoni veshjet e grave ilire me veshjet kombëtare të grave në kohën e sotme.

Diskutoni për larjen rituale të dardanëve dhe përgjigjuni nëse keni njohuri për ndonjë ritual të ngjashëm në ditët tona.

## VII


## 35. BUJQËSIA, BLEGTORIA DHE ZEJTARIA TE ILIRËT

**Bujqësia**

Në Iliri kishte shumë fusha pjellore. Tokat pjellore dhe uji i mjaftueshëm për ujitje ndikoi në zhvillimin e bujqësisë. Ilirët kultivonin të gjitha llojet e drithërave përfshirë grurin, elbin etj. Jo rastësisht, krahina të veçanta ilire, si Paionia dhe Thesprotia, përmenden nga Homeri si vende të përshtatshme për kultura bujqësore. Në zonat e ulëta bregdetare, krahas drithërave dhe disa kulturave të tjera bujqësore, kultivohej edhe rrushi dhe ulliri. Rritja e hardhisë së rrushit dhe elbit ua mundësoi atyre prodhimin e verës dhe të birrës. Birra dhe vera ilire ishin të njohura në qytetërimin antik.

Ilirët u njohën edhe për prodhimin e perimeve, si të bishtajës, të bathës, të bizeles etj. Ata kultivuan edhe pemë frutore si: mollë, dardhë, rrush, qershi etj.

Në Iliri ishte e zhvilluar edhe bletaria. Ata, përveç mjaltit, dinin ta përfitonin edhe dyllin për nevoja të tyre të përditshme. Në shkrimet e Aristotelit thuhet se taulantët e përdornin mjaltin edhe për të bërë një lloj pijeje të ngjajshme me atë të verës së ëmbël të cilën e përdornin në festat e tyre.



 DELET ISHIN KAFSHË SHTËPIAKE QË MBAHESHIN NGA ILIRËT

**Blegtoria**

Në viset e rrafshëta dhe malore të Ilirisë, blegtoria ishte veprimtaria kryesore. Dijetari Hesiodi, duke e cilësuar Helopinë si një fushë shumë pjellore me livadhe të gjera, shton se ajo është e pasur me tufa delesh. Mendohet se e gjithë krahina e Dalmacisë ku jetonin dalmatët e ka marrë emrin nga delja, meqë ishte vend i njohur blegtoral ku kultivoheshin delet.

Nga delet, përveç mishit dhe produkteve të qumështit, ata përfitonin edhe leshin, që ishte shumë i kërkuar nëpër tregje jo vetëm në Iliri, por në të gjitha tregjet e Mesdheut.

Ndër kafshët shtëpiake që mbanin ilirët ishin: kuajt, gomarët, lopët, qetë (kijet), delet, dhitë, derrat, qentë etj. Qentë ruanin kopetë e bagëtisë. Raca më e njohur ishte qeni dardan apo deltari Ilir, siç është i njohur në ditët tona.

Ky fakt vërtetohet me zbulimet arkeologjike në vendbanime ilire,



QENI DARDAN - QENI I SHARRIT 

ku janë gjetur kocka kafshësh dhe mbetje të tjera. Edhe gjuetia, ishte veprimtari e përditshme. Ilirët gjuanin kafshët e egra si: derrin, drerin, ariun etj.

### Zejtaria

Zejtaria ishte veprimtari e përditshme te Ilirët. Ata përpunonin hekurin dhe metalet e tjera. Prej tyre prodhonin gjëra të ndryshme përfshirë armë, vegla pune që u duheshin në përditshmëri, mjete bujqësore dhe prodhime të tjera për t'i tregtuar. Zejtarët më të shquar ishin ata që prodhonin stoli dhe zbukurime të ndryshme për gra, monedha dhe gjëra të tjera më të imëta. Zejtarët ilirë, gra e burra, u bënë të njohur edhe për punimin e veshjeve të ndryshme, si për jetën e përditshme, ashtu edhe për ceremoni festive. Shumë veshje ilire u tregjuan në tregje të ndryshme mesdhetare. Disa nga veshjet që punuan ilirët u bënë veshje ceremoniale të perandorëve romakë.



PËRKRENARE E PUNUAR NGA BRONZI 



### Fjalori

**Batha** - lloj fasuleje

**Bizele** - bimë barishtore njëvjeçare që bënte kokrra që përdorehin për ushqim.



### TË PUNOJMË SË BASHKU

Krahasoni veshjet e grave ilire me veshjet kombëtare të grave në kohën e sotme.

Diskutoni për larjen rituale të dardanëve dhe përgjigjuni nëse keni njohuri për ndonjë ritual të ngjashëm në ditët tona.

Diskutoni për emrin *dardan*.

## VII

## 36. ILIRËT ISHIN TREGTARË TË SHQUAR

**Kushtet për zhvillimin e tregtisë**

Iliria kishte një pozitë shumë të favorshme për zhvillimin e tregtisë. Dalja në dy dete, në liqene dhe lumenj të lundrueshëm e bënë Ilirinë vend të rëndësishëm tregtar. Te disa fise ilire, tregtia kishte ndikim vendimtar në zhvillimin e tyre ekonomik e shoqëror. Përveç detit, liqeneve dhe lumenjve, ilirët ndoqën edhe rrugët e rëndësishme tokësore në kërkim të tregjeve të mëdha. Pra, Iliria kishte kushte të favorshme për zhvillimin e tregtisë.

**Çka tregtonin ilirët?**

Ilirët tregtonin produkte të ndryshme. Ata shisnin prodhime bujqësore e blegtorale, bimë shëruese e ilaçe, mjaltin, birrën që e prodhonin vetë, prodhimet artizanale, metalet, lëkurat etj. Në anën tjetër, ata blinin produkte që nuk i prodhonin në vendin e tyre si: qelibarin, rrëshirën, mallrat e qeramikës dhe gjëra të tjera që i gjenin me çmime të ulëta, si armë dhe përkrenare të ndryshme. Ilirët tregtinë më të madhe e bënë me grekët për shkak të afërsisë gjeografike, por edhe me romakët dhe popujt e tjerë. Anijet greke dhe romake ishin të përditshme në portet

ilire. Ndonjëherë, anijet tregtare rrezikoheshin nga piratët ilirë.

**Rrugët tregtare**

Në periudhën pararomake, ilirët i shfrytëzonin rrugët e vjetra. Me pushtimet romake në Iliri u ndërtuan rrugë të reja tregtare. Straboni përmend disa rrugë tregtare që ndiqnin ilirët për të zhvilluar tregtinë e tyre. Përveç Detit Adriatik dhe Detit Jon, ai flet edhe për rrugën tregtare që kalonte nëpër luginën e lumit Narona. Rrugë tjetër e rëndësishme ishte edhe rruga tregtare që kalonte nga Durrësi dhe Apolonia, nëpër luginën e lumit Shkumbin e deri në liqenin e Ohrit. Në kohën e romakëve kjo rrugë u quajt Via Egnatia. Kurse, nëpër luginën e Vardarit dhe të Moravës kalonte rruga kryesore që çonte në brendi të Ballkanit.

QELIBARI QË PRODHOHEJ NGA  
RRËSHIRA ISHTE NJË NGA  
PRODHIMET QË TREGTONIN ILIRËT



## Monedhat

Deri në shekullin IV para Krishtit, ilirët nuk e kishin zhvilluar tregtinë duke përdorur monedhat. Këtë veprimtari e ushtronin duke shkëmbyer mallin me mall. Shkëmbeheshin kokë me kokë mallrat që kishin vlerë afërsisht të njëjtë ose varësisht nga nevojat.

Nga shekulli IV para Krishtit, ilirët filluan t'i pritnin monedhat e tyre. Në monedha ata i vendosnin portretet e mbretërve të tyre dhe ndonjë gjë tjetër që ishte e rëndësishme në jetën e tyre, siç ishte rasti i anijeve Liburna. Janë të njohura monedhat e Monunit, mbretit të Dardanisë, Gentit, mbretit të ardianëve, mbretit Mytil etj. Monedha u prenë në shumë qytete ilire, si në Damastion, Amantia, Bylis, Scodra, Liss, Risan, Orikum, Naisus etj.



 MONEDHA TË GJETURA NË ILIRI



## Fjalori

**Rrëshira**-një lloj materieje e lëngshme që del nga druri, sidomos nga pyjet halore.

**Qelibari**- rrëshirë e ngurtësuar e disa drurëve halorë, me ngjyrë të verdhë në të kuqe a në të murrme, pothuaj e tejdukshme, e cila përdoret zakonisht për të bërë sende të ndryshme zbukurimi.



## TË PUNOJMË SË BASHKU

Duke analizuar prodhimet ilire, gjeni disa prej tyre që prodhohen edhe sot nga shqiptarët.


## VII

## 37. DETARIA, ANIJET LUFTARAKE DHE PIRATËRIA NË ILIRI

**Ilirët ishin detarë të shquar**

Gjeografia e shtrirjes së Ilirisë përgjatë deteve Adriatik dhe Jon dhe sëra e ishujve u dha mundësi ilirëve shumë herët që të merreshin me peshkim dhe lundrim. Ata u bënë detarë të shquar dhe të njohur nga qytetërimi mesdhetar. Anijet nuk i përdornin vetëm për peshkim dhe lundrim të zakonshëm në dete dhe liqene. Duke qenë detarë të mirë, ilirët ndërtuan edhe flotë detare për t'iu kundërvënë flotave të shteteve që sulmonin Ilirinë për ta pushtuar. Më e njohura ndër flotat ilire që kishte përballuar sulmet romake nga deti, ishte flota e shtetit të ardianëve.



ANJJE ILIRE QË PËRDOREJ  
PËR TREGTI 

**Liburna e njohur ilire**

Burimet historike për detarinë dhe anijet i gjejmë tek autorët antikë dhe në monedhat ilire, disa prej të cilave në njëren anë kishin të shtypura anijet si stemë.


Ilirët bregdetarë ishin mjeshtër dhe ndërtues të mirë të anijeve. Grekët dhe romakët e mësuan anijendërtimtarinë nga mjeshtrit ilirë. Ilirët ndërtuan disa lloje të anijeve, por më të njohurat janë anijet luftarake dhe tregtare. Ata ndërtuan luftanijen e vogël më të përsosur të kohës e cila u quajt Liburna. Ajo ishte anije e shpejtë, lehtë e manovrueshme dhe shumë e përshtatshme për aksione lufte

dhe piratërie. Anijet Liburna i kishte përdorur Oktavian Augusti në luftën kundër Antonit dhe Kleopatërës. Këto anije bartnin mesatarisht 50 luftëtarë bashkë me teknikën luftarake të kohës.

### Piratëria


Në periudhën antike, piratëria ishte veprimtari e zakonshme te popujt bregdetarë. Ndër popujt që u shquan për piratëri ishin edhe ilirët. Ata e shihnin piratërinë si aktivitet të rëndësishëm ekonomik. Sulmet e anijeve pirate të ilirëve kundër anijeve tregtare greke, romake dhe të tjera, kishin në radhë të parë domethënie ekonomike. Ndërkaq, kur piratët sulmonin anijet luftarake, sulmi merrte tipare politike. Çak i piratëve ilirë ishte sulmi i anijeve të mallrave që lundronin përgjatë bregdetit lindor të Adriatikut në drejtim të veriut dhe të jugut.

Përveç ilirëve, për piratëri shquheshin edhe kretasit, fenikasit, etruskët, grekët dhe romakët. Autorët antikë grekë dhe romakë kanë shkruar me urrejtje për piratët ilirë, se këta u pasuruan nga fitimet që iu sillte piratëria dhe sulmet e vazhdueshme ndaj anijeve tregtare të grekëve dhe të romakëve.



 ANIJE ILIRE QË PËRDOREJ PËR PIRATËRI



 LIBURNA E SHTYPUR NË  
MONEDHA ILIRE



### TË PUNOJMË SË BASHKU

Gjeni në hartë detet në të cilat lundronin ilirët.  
Krahasoni anijen Liburna me anijet moderne!  
Diskutoni për piratërinë ilire!




## VII

## 38. VESHMBATHJET DHE STOLITË ILIRE

**Veçoritë e veshjeve ilire**

Ilirët kishin shumë gjëra të përbashkëta me popujt fqinjë, por edhe të tjera që i dallonin ata, duke i bërë si popullsi të veçantë. Për veshjet e grave dhe burrave ilirë ekzistojnë shënime që nga shekulli VI para Krishtit kur autorë të ndryshëm flasin për veshjet e veçanta popullore në Iliri. Burimet kryesore të informatave mbi veshjet ilire janë të dhënat e autorëve antikë e më pak burimet arkeologjike të nxjerra nga gërmimet që janë bërë në të gjitha krahinat e Ilirisë.



 VESHJE POPULLORE SHQIPTARE TË BAZUARA NË TRADITËN ILIRE

**Si visheshin burrat?**

Veshja mashkullore si kulturë e veçantë e ilirëve bazohej në këmishën apo fustanellën e gjatë dhe atë të shkurtër. Mbi fustanellë, burrat ilirë shpeshherë vishnin një gunë. Kjo veshje ishte më e përhapura në territoret që populloheshin nga fisi ilir i japodëve gjatë shekujve VI-V para Krishtit. Tunika mashkullore ilire ka ngjashmëri me atë romake, por mëngët i ka më të gjera dhe është e prerë në dy pjesë mbi supë. Një rrobë tjetër që vishnin ilirët dalmatë quhej dalmatika, e cila u përvetësua nga romakët dhe u bart deri në Lindje dhe në Afrikë. Dalmatika u bë veshje shume e dashur e skllavopronarëve, bile atë e bartën edhe perandorë të Perandorisë Romake.

Ilirët vishnin edhe një lloj veshjeje që ngjante me pantallona. Ata, gjithashtu, vinin në kokë kësula të ndryshme. Prej tyre, katër janë ndër më të përdorurat. Më i shpeshti lloj i kapelës ishte në formë të rrumbullakët që ngjan shumë me plisin që përdoret në ditët e sotme nga shqiptarët. Mendohet se plisin, e ka origjinën nga kjo kësulë ilire. Një lloj tjetër ishte kësula e lëkurës në formë konike. Lloji i

VESHJE E GRUAS-HYJNESHËS DARDANE 




tretë ishte kësula në formë të rrumbullakët me një rreth të gjerë dhe të valëzuar. Lloji i katërt i kësulës ishte i punuar me pëlhurë dhe lëkurë, që stolisej me pulla të imëta bronzi, që ngjante me një lloj përkrenareje. Mbathjet kryesore të burrave ilirë ishin opingat që punoheshin nga lëkurat. Kjo mbathje u përhap edhe te popujt e tjerë. Madje, opingat ilire u përvetësuan më vonë edhe nga popujt sllavë.

### Veshjet dhe stolitë e grave në Iliri

Si pjesë e veshjes së përditshme të grave ishte këmisha tradicionale ilire, e cila më vonë mori përhapje të gjerë te popujt e Ballkanit. Kjo këmishë, me pak ndryshime, përdoret edhe sot në gazmende dhe festa të ndryshme kombëtare në Kosovë, Shqipëri dhe vise të tjera etnike. Te veshmbathjet e grave ilire shihen tri elemente kryesore: këmisha e gjatë deri te shputat e këmbëve e ndonjëherë edhe më e shkurtër, fustani i grave ilire dhe guna e njohur që ishte veshje e përditshme te shumica e grave.

Prej fustaneve, gratë ilire më së shumti e vishnin një lloj fustani që



 STOLI ME MOTIVE ILIRE QË JANË PËRDORUR DERI NË DITËT E SOTME

ishte i prerë në brez. Nga gunat më të shpeshta që vishnin gratë ilire është guna me kapelë, e cila, me disa ndryshime, përdoret si veshje e grave edhe në ditët e sotme. Autorët antikë e quanin *cuculus liburnikus*, duke aluduar se ishte veshje e grave nga fisi i liburnëve. Gratë, shpeshherë, bartnin edhe shamitë zbukuruese, që u vareshin deri në supe.

Për t'u zbukuruar më shumë, gratë ilire bartnin edhe stoli të ndryshme. Ndër kryesoret ishin: qaforet, byzylykët, unazat, gjilpërat stolisëse, varëset, fibulat, kopsat, varëset e brezit etj.



### TË PUNOJMË SË BASHKU

Shkruani një ese krahasuese për veshjen e grave dhe të burrave ilirë dhe veshjet kombëtare të shqiptarëve.



### Fjalori

**Guna** - veshje e sipërme kombëtare për burra dhe gra, e punuar prej leshi ose prej liri.

## VII

## 39. ILIRËT NJIHNIN ILAÇE PËR SHËRIMIN E SËMUNDJEVE

**Lindja dhe mosha mesatare te ilirët**

Në periudhën antike, lindja e fëmijëve nga gratë shtatzëna ishte, në të shumtën e rasteve, shumë e vështirë për shkak të mungesës së dijes nga fusha e mjekësisë. Mjekësia nuk ishte shumë e zhvilluar. Dijetari romak, Varoni, rrëfen se gratë ilire i lindnin me lehtësi fëmijët e tyre. Kur u vinte koha e lindjes, ato largoheshin nga puna në fushë, lindnin fëmijët dhe ishin në gjendje sërish të ktheheshin në punët e fushës. Kjo ishte karakteristikë e grave që jetonin në fshatra dhe vise malore. Ato dinin të bënin edhe ilaçe për periudhën e shtatzanisë dhe kohën pas lindjes. Këto ilaçe i nxirrnin nga bimët shëruese që i njihnin dhe i gjenin në natyrë. Dijetarë flasin edhe për numrin e vdekshmërisë në zona të ndryshme të shtrirjes ilire, si pasojë e mungesës së mjekimit. Për vdekjen e foshnjave, ata akuzonin zotat e këqij. Mosha mesatare e jetës së njeriut, krahasuar me ditët e sotme, ishte shumë e shkurtër.



 GENTIANA LUTEA  
BIMA SHËRUESE QË E  
ZBULUAN ILIRËT



 ENË PËR MIKSIMIN E BARNAVE NATYRALE


### Barnat mjekuese që prodhuan ilirët

Ilirët njihnin edhe barna mjekuese që shëronin sëmundje të ndryshme. Ato barna i prodhonin nga bimët që i gjenin në natyrë. Një ndër ato bimë ishte luleshpata, e njohur në kohën antike si, Iris Illyrica. Për vetitë shëruese të kësaj bime, që rritej në Iliri, kanë folur dhe e kanë lavdëruar shumë autorë antikë, që janë marrë me mjekësi. Mjeku Dioskurid thoshte se luleshpata shëronte shumë sëmundje ose edhe i parandalonte ato. Ndër sëmundjet e shpeshta që shëroheshin nga kjo lule ishin: ithati, dhimbjet e kokës, pagjumësia etj. Ilirët e përzienin luleshpatën edhe me mjaltë dhe prodhonin ilaçe të tjera. Për bimët shëruese dhe ilaçet që njohën dhe prodhuan ilirët, flet në shkrimet e tij edhe historiani Plini.

### Ilirët eksportnin bimë mjekuese në shtetet greke dhe në Perandorinë Romake

Me kalimin e kohës, ilirët thelluan edhe më shumë dijet që i takonin njohjes së bimëve shëruese dhe mjekësisë. Duke njohur mirë bimët shëruese, ata grumbulluan aq shumë, saqë nisën t'i eksportnin në tregjet e vendeve fqinje. Më së shumti bimë shëruese shiteshin në Perandorinë Romake dhe në Greqi. Bima më e njohur që kultivohej në Iliri dhe që shitej në këto tregje ishte Genciana, që sot njihet me emrin Gentiana Lutea.

Kjo bimë ishte emërtuar nga mbreti ilir Genti, i cili i pari kishte zbuluar vetitë shëruese të kësaj bime. Bazuar në shënimet e vjetra mendohet se mjekësia popullore ilire ishte e përhapur dhe e zhvilluar në gjithë Ilirinë. Duke eksportuar bimët shëruese në Perandorinë Romake dhe shtet-poliset greke, ilirët ua mësuan grekëve dhe romakëve njohjen e disa bimëve shëruese, përgatitjen dhe përdorimin e tyre te të sëmurët. Edhe popujt e tjerë njihnin bimë shëruese, që i gjenin në vendet e tyre dhe i tregtonin në Iliri në dhe vende të tjera.



## Fjalori

**Eksport**-shitje jashtë vendit.



### TË PUNOJMË SË BASHKU

Krahasoni moshën mesatare të jetës së ilirëve me moshën mesatare të njerëzve sot.

Diskutoni për bimët shëruese që zbuluan ilirët.

A dini ndonjë bimë shëruese që i takon mjekësisë tradicionale popullore?

## VII

## 40. ILIRËT FORMOJNË SHTETET E TYRE

**Lindja e shteteve ilire**

Formimi i shteteve ilire nisi nga mesi i shekullit V para Krishtit. Shteti i parë ilir kishte tiparet e shtetit skllavopronar dhe zotëronte një territor të caktuar. Të parët nga fiset ilire që formuan shtetin ishin enkelejtë. Më vonë, mbretëritë e tyre i formuan edhe taulantët, dardanët, ardianët, molosët dhe fise të tjera më të vogla që u bënë pjesë e rëndësishme e shteteve ilire.



 MBRETI BARDHYL

**Enkelejtë formojnë mbretërinë ilire (shekulli V - 335 para Krishtit)**

Nga fundi i shek. V para Krishtit, u krijua shteti ilir i enkelejve. Udhëheqësi i parë që njohim ishte mbreti Sirra. Atë e rrëzoi nga pushteti Bardhyli në shek. IV para Krishtit. Bardhyli vinte nga një familje e mesme e shoqërisë ilire. Me të marrë drejtimin e shtetit ilir, Bardhyli e themeloi dinastinë e tij. Qendër e shtetit u bë zona rreth liqenit të Ohrit, në tokat e fisit të enkelejve. Mendohet se ai e mori pushtetin me anë të kryengritjes, i përkrahur nga shumë luftëtarë, të cilët ishin kundërshtarë të mbretit Sirra.

Në kohën e qeverisjes së Bardhylit, enkelejtë bënë shumë luftëra me maqedonasit, meqë këta të fundit kishin pushtuar disa territore të enkelejve. Qëllimi i mbretit Bardhyl ishte të rikthente dhe të përfshinte nën sundimin e tij këto toka të pushtuara.

Bardhyli i mundi maqedonasit, ktheu tokat e humbura dhe i detyroi t'u paguanin ilirëve tribut vjetor. Maqedonasit në vitin 360 para Krishtit u përpoqën t'i rikthenin territoret, por nuk ia arritën qëllimit. Në betejat e luftës kundër enkelejve, maqedonasit lanë

 BYLYSI ANTIK



shumë të vrarë. Aty u vra edhe mbreti maqedonas Perdika. Pas ardhjes së Filipit II në krye të shtetit maqedonas, filluan prapë luftërat e enkelejve me maqedonasit. Në vitin 359 para Krishtit, ndodhi beteja vendimtare iliro-maqedonase. Aty mori pjesë edhe Bardhyli, pavarësisht se ishte shumë i shtyrë në moshë. Këtë betejë e fituan maqedonasit dhe e vunë në vartësi shtetin ilir të enkelejve. Kliti e as pasardhësit e tjerë të Bardhylit, përkundër përpjekjeve, nuk arritën të çliroheshin nga varësia maqedonase. Shteti ilir i enkelejve, me kalimin e kohës, u shua.


### **Mbretëria e taulantëve (335-251 para Krishtit)**

Forcimi i fisit të taulantëve ndikoi në formimin e shtetit të tyre. Lajmet e para për taulantët vijnë nga lufta e udhëheqësit të tyre Gaular kundër mbretit maqedonas Argeiosit në shekullin VII para Krishtit. Mirëpo, i pari që krijoi dinastinë e tij mbretërore ishte Glaukia. Shteti i tij shtrihej në Shqipërinë e mesme dhe në atë të veriut.

Pas vitit 323 para Krishtit, Glaukia arriti të çlironte të gjitha tokat që maqedonasit ua kishin marrë enkelejve dhe t'i çlironte enkelejtë nga vartësia maqedonase. Në vitin 312 para Krishtit, Dyrrahu dhe Apolonia u bënë pjesë e mbretërisë ilire të Glaukisë.

Në vitin 309 para Krishtit, Glaukia, me një ushtri të madhe, zbriti në Epir dhe vendosi në fron Pirron e Epirit. Bardhyli i ri, pasardhës i Glaukisë, krijoi marrëdhënie miqësore me Epirin.

Në kohën e mbretërisë së taulantëve u zhvilluan qytete të rëndësishme, si: Damastioni, Bylisi, Albanopoli, Dimali, Skodra, Lisi, Meteoni, Ulcini, Rizoni etj. Disa prej tyre prenë edhe monedhat e veta prej bronzi dhe prej argjendi. Këto qytete luajtën rol të rëndësishëm në zhvillimet politike, ekonomike dhe kulturore të Ilirisë.



## Fjalori

**Fron** - pushteti i lartë i një mbreti a i një perandori.



### TË PUNOJMË SË BASHKU

Diskutoni si u formua shteti i parë ilir, cili fis e formoi dhe pse është i njohur Bardhyli!


Duke analizuar qytetet në kohën e mbretërisë së taulantëve, saktësoni cili prej tyre ekziston edhe sot si qytet.

## VII

## 41. MOLOSËT FORMOJNË SHTETIN E EPIRIT (SHEK. V-IV PARA KRISHTIT)

**Shtrirja e shtetit të Epirit**

Shteti i Epirit shtrihej nga lumi Vjosa deri në Gjirin e Ambrakisë dhe nga Deti Jon deri në malet e Pindit. Në Epir jetonin disa fise të mëdha dhe shumë fise të tjera më të vogla. Fiset kryesore ishin molosët, kaonët, thesprotët. Popullin e Epirit, autorët grekë e quanin epirotë “barbarë” që domethënë jogrekë. Fisi më i fuqishëm në këtë krahinë ilire ishin molosët. Organizimi shtetëror i Epirit filloi që në shek. V para Krishtit. Mbreti i parë epirot që njohim, ishte molosi Admeti. Tharypa, mbret molos që sundoi gjatë viteve 423 - 385 para Krishtit, ishte edukuar në shkollat e Athinës. Ai ndërmoi një varg reformash me qëllim që të forconte mbretërinë ilire në Epir. Edhe Alketa dhe Neoptolemi, që sunduan pas tij, e vazhduan politikën e zgjerimit të territoreve shtetërore.

**Lidhja e fiseve ilire në krye me molosët (shek. IV-330 para Krishtit)**

Për të forcuar edhe më shumë shtetin e Epirit, u krijua Lidhja Molose. Në të merrnin pjesë disa fise të tjera epirote. Në krye të kësaj lidhjeje qëndronin molosët si fisi më i madh dhe më i fuqishëm që drejtonte shtetin. Secili nga fiset që hyri në Lidhje mernte pjesë aktive në qeverisjen e shtetit. Mbreti duhej të ishte nga fisi i molosëve. Ai kishte pushtet të trashëgueshëm dhe ishte

edhe komandant i përgjithshëm i ushtrisë. Fiset e tjera më të vogla ilire nuk mund të mbanin poste drejtuese në Mbretërinë e Epirit. Lidhja Molose e vazhdoi politikën e zgjerimit të kufijve të vet. Në mesin e shek. IV para Krishtit, edhe tokat e thesprotëve e të kaonëve u futën në përbërjen e shtetit të Epirit.

 PIRRO I EPIRIT

**Pirro - sundimtar i Epirit**

Pas shumë ngjarjeve politike e ushtarake në shtetin e Epirit, në vitin 297 para Krishtit, në krye të shtetit erdhi Pirroja. Ai u bë njeriu më i pushtetshëm dhe komandanti suprem ushtarak i shtetit.

Gjatë sundimit të Pirros (297-272 para Krishtit), Epiri zhvilloi një politikë aktive dhe të pavarur. Pirroja vendosi marrëdhënie diplomatike me shtete të fuqishme të kohës. Në kohën e sundimit të Pirros, Epiri njohu një lulëzim të jetës qytetare, me një veprimtari të dendur dhe me ngritjen e qyteteve të reja. Pirroja i zgjeroi kufijtë e

shtetit duke pushtuar territore të reja. Në veri, kufijtë i zgjeroi deri te lumi Shkumbin, në lindje, tokat deri në Vardar, kurse në jug, pushtoi tokat deri në Korinth.

Pirroja bëri luftëra edhe jashtë territoreve të Ilirisë. Me kërkesën e mbretit të Tarentit në vitin 280 para Krishtit, ai zbarkoi me një ushtri të madhe në Italinë e Jugut. Në mes të ilirëve dhe romakëve u zhvillua një luftë e ashpër. Luftën e fitoi Pirroja por në betejat e luftës la shumë ushtarë të vrarë. Kur e uruan për këtë fitore, Pirro u përgjigj duke thënë: “edhe një fitore si kjo dhe unë do të mbetem pa ushtri”. Për këtë arsye, edhe në ditët tona kur fitohet diçka, por brenda fitores ka edhe humbje, thuhet “fitore si ajo e Pirros”.

Pas luftës me romakët, ai luftoi edhe kundër grekëve. Pasi hyri në Greqi me ushtrinë e tij, shënoi disa fitore radhazi. Në vazhdim të luftërave, në vitin 272 para Krishtit, në betejat e luftës u vra Pirroja, mbreti i Epirit. Pas vdekjes së tij, Epiri u përfshi në luftë të brendshme për pushtet. Shteti i Epirit u shkatërrua dhe u pushtua nga romakët në vitin 167 para Krishtit.



 PIRROJA PËRDORI EDHE ELEFANTËT NË LUFTËRAT E TIJ.



## Fjalori

**Barbarë** - emër me të cilin grekët e vjetër i quanin me përbuzje të huajt.



### TË PUNOJMË SË BASHKU

Analizoni shprehjen e Pirros: “Edhe një fitore si kjo dhe unë do të mbetem pa ushtri”!



## VII

## 42. DARDANIA

**Popullsia dardane**

Mendohet se emri i fisit ilir të dardanëve vjen nga fjala ilire *dardhë*. Pra, Dardania njihej si vend i dardhave. Popullsia në Dardani jetonte në fise të ndryshme. Fisi më i madh që dominonte ishte fisi i dardanëve. Fise të tjera më të vogla ishin: galabrët, thunatët, daunët dhe disa fise të tjera. Strukturën shoqërore në Dardani e përbënin: aristokracia skllavopronare, e cila udhëhiqej nga mbreti dardan, kurse pas tij vinin ushtarakët e lartë dhe priftërinjtë. Grupi i dytë shoqëror i rëndësishëm ishin xehetarët, zejtarët dhe tregtarët, të cilët ishin kontributdhënës në zhvillimin ekonomik të Dardanisë. Në vendin e tretë, si grup shoqëror radhitej fshatarësia e lirë, bujqit e blegtorët dhe grupi i fundit ishte popullsia pa të drejta, që përbëhej nga skllavërit. Burimet e skllavërisë në Dardani ishin robërit e luftës dhe skllavërimi i njerëzve që nuk i paguanin borxhet. Pas pushtimit të Dardanisë nga Perandoria Romake, ndryshoi struktura e popullsisë, meqë në rangun më të lartë të shoqërisë futeshin funksionarët e shtetit romak, kurse në shtresën më të ulët ranë shumë dardanë që e humbën lirinë e tyre dhe u skllavëruan nga romakët.



KËSHTJELLË  
DARDANE

**Jeta e përditshme e dardanëve**

Dardanët jetonin në familje të mëdha dhe në fise. Ata ndërtonin shtëpi njëkatëshe, fillimisht nga druri e pastaj nga guri. Ambienti më i rëndësishëm në shtëpitë dardane ishte dhoma e ditës, ku qëndronte familja gjatë gjithë kohës. Dardanët e nisnin ditën e tyre herët në mëngjes. Punët në familjet dardane ishin të ndara. Gratë merreshin me punët e zakonshme të familjes. Më së shumti kujdes tregonin ndaj fëmijëve. Kurse, burrat kryenin më shumë punët e bujqësisë, të blegtorisë, të zanateve, por edhe punë të tjera të rënda fizike. Në punët e përditshme angazhoheshin edhe të rinjtë e moshës më të rritur. Vajzat i ndihmonin nënat e tyre në punët e shtëpisë, kurse djemtë ndihmonin burrat në punët fizike. Familjet e shtresës aristokrate i shkollonin fëmijët e tyre, kurse shtresa e njerëzve të varfër nuk e kishin këtë mundësi. Në mbrëmje, bëhej bashkë e gjithë familja, sepse secili prej tyre e mbyllte ditën e punës.

Fejesat dhe martesat e të rinjve, dardanët i bënin në mënyrë tradicionale. Për fatin e të rinjve dhe zgjedhjen e bashkëshortit të fëmijëve të tyre, vendosnin prindërit. Vajzat, përkundër dëshirës së tyre, nuk kishin të drejtë të refuzonin vendimin e prindërve.

Edhe ceremonitë mortore të dardanët ishin të veçanta. Ata respektonin shumë kultin e të vdekurit. Njerëzit e vdekur i varrosnin me gjërat e tyre personale.

Sa i takon besimit të dardanëve, vendin më të rëndësishëm e zinte hyjnesha dardane. Hyjnizimi i gruas në jetën e përditshme tregon se dardanët e respektonin shumë kultin e nënës si ripërtëritëse e familjes. Dardanët e donin edhe muzikën. Në festa e gazmende, ata këndonin këngë e hidhnin vallet e tyre tradicionale. Gjuha e përditshme e komunikimit të dardanëve ishte gjuha ilire. Për fat të keq, dardanët nuk e lanë gjuhën e tyre të shkruar.

### Zhvillimi ekonomik në Dardani

Dardania kishte fusha të gjera, lugina e lumenj, që ndikuan në zhvillimin e bujqësisë. Edhe në zona malore kishte kushte të mira për zhvillimin e blegtorisë. Popullsia dardane, në fillimet e veta, ishte kryesisht popullsi që merrej me bujqësi e blegtori. Në blegtori, dardanët u njohën shumë për kultivimin e qenit dhe djathit dardan. Më vonë, lindi edhe zejtaria. Ekonomia dardane bazohej në: bujqësi, blegtori, xehetari, prodhime artizanale, bletari, tregti. Nga shekulli IV para Krishtit u përhap me të madhe qarkullimi i monedhave. Për tregti përdorehin monedhat dardane të Damastionit e pas pushtimeve romake u përdor edhe denari romak. Tregtia me vende dhe popuj të ndryshëm i sillte përfitime ekonomisë dardane. Përfitime kishte edhe nga gërshetimi i kulturës dardane me kulturat e tjera, sepse kështu popujt e njohën më mirë njëri-tjetrin. Lulëzimin më të madh ekonomia dardane e kishte në kohën e mbretërisë dardane. Kurse, rënien me të madhe e përjetoi pas pushtimit romak të Dardanisë, meqë dardanët e humbën pavarësinë politike dhe ekonomike dhe vendi shfrytëzohej nga romakët.

### Qytetet kryesore të Dardanisë

Që nga shekulli VII para Krishtit, dardanët krijuan lidhje tregtare me Jugun. Lidhjet tregtare morën hov të madh në shekullin VI para Krishtit. Gjatë shekujve VI-IV u zhvillua faza paraurbane me vendbanime kodrinore dhe me prodhimtari të dendur zejtare, ndërsa nga shekulli IV, dardanët formuan shtetin e tyre të fuqishëm.

Të gjitha këto ndikuan në lindjen dhe zhvillimin e qyteteve. Në fazën urbane filloi modernizimi i qyteteve. U ndërtuan ndërtesa publike dhe private, u ndërtuan ujësjellës dhe kanalizime, u rrit numri i popullsisë në qytete, u rrit prodhimtaria zejtare etj. Si qytete të rëndësishme në Dardani u njohën Damastioni, Scupi (Shkupi), Naisusi (Nishi i sotëm), Ulpiana, Vicianumi, Sirmiumi - Sremi etj.



### TË PUNOJMË SË BASHKU

Shkruani ese me temë nga jeta e përditshme e dardanëve!

## VII

## 43. MBRETËRIA DARDANE

**Formimi dhe shtrirja e Mbretërisë Dardane**

Dardanët ishin njëri nga fiset më të mëdha ilire. Në shek. IV para Krishtit, ata krijuan mbretërinë e tyre. Mbretëria Dardane shtrihej në territorin e Kosovës së sotme e të krahinave të tjera përreth. Nga pikëpamja gjeografike, kufijtë e saj shtriheshin në veri, deri te qyteti i Naisusit - Nishit, kurse në jug, deri në Kukës dhe në rrjedhën e sipërme të Vardarit. Brenda Mbretërisë Dardane u përfshinë galabrët e thunatët si dhe fise të tjera më të vogla. Shteti dardan shfrytëzonte edhe sklevërit në kohë lufte duke pasur si prijës dhe udhëheqës pronarin e tyre. Dardanët krijuan një ushtri të fuqishme dhe të armatosur mirë.

Forcat e kësaj ushtrie u treguan sidomos në shek. III para Krishtit, kur dardanët qenë në gjendje të mbroheshin nga dyndjet e fuqishme të keltëve, të cilët zbritën nga Evropa Qendrore. Madje, dardanët treguan gatishmërinë të ndihmonin edhe Maqedoninë, që t'i përballonte këto sulme.

Në mesin e shek. III para Krishtit, kur sundonte mbreti Longar, ushtritë dardane u përpoqën të shtrinin kufijtë e tyre deri në brigjet e Adriatikut. Ndër mbretër të tjerë të njohur ishin edhe Batoja dhe Monuni.

**Dardanët luftuan kundër maqedonasve**

Lufta për dominim dhe zgjerim të shtetit i çoi në përplasje dardanët me fqinjët e tyre maqedonas. Një betejë e ashpër ndërmjet tyre u zhvillua në vitin 231 para Krishtit ku mbeti i vvarë edhe mbreti maqedonas Dhimitri II. Dardanët e shfrytëzuan dobësimin e Maqedonisë nga luftërat me keltët. Në vitin 219 para Krishtit, dardanët vërshuan përsëri kundër Maqedonisë.

Në vitin 216 para Krishtit, ushtritë dardane ndërmorën një operacion të fuqishëm ushtarak kundër Maqedonisë, duke zënë 20.000 robër. Ata zbritën deri në fushën e Agros, në brigjet e lumit Haliakmon. Në vitin 200 para Krishtit, mbreti dardan, Batoja së bashku me ardianët dhe me mbretër të tjerë ilirë, lidhën aleancë me romakët kundër Maqedonisë. Kjo i shtyu dardanët të ndërmerrnin sulme të reja në jug të kufirit të tyre.

Maqedonasit bënë marrëveshje me fiset kelte, duke i joshur këta të fundit të luftonin kundër dardanëve dhe të pushtonin tokat e tyre. Qëllimi kryesor i dardanëve ishte të bëheshin fuqia kryesore e rajonit.

### Luftërat e dardanëve kundër romakëve

Dardanët u bënë pengesë serioze në përpjekjet e romakëve për të zgjeruar sundimin e tyre. Roma pretendonte të pushtonte të gjitha tokat ilire dhe të arrinte deri në Danub. Dardanët, të zënë në luftë kundër maqedonasve, u zunë të papërgatitur për t'u bërë ballë me sukses sulmeve romake. Në vitin 97 para Krishtit, romakët arritën fitore në luftë me dardanët. Në këto rrethana dardanët ranë nën pushtetin e Romës. Në ndërkohë, ata u organizuan dhe nisën luftën kundër romakëve. Dardanët shënuan fitore, por këto rezultate ishin të përkohshme, meqë Perandoria Romake i riorganizoi forcat e veta dhe i hodhi në luftë kundër ilirëve dardanë. Në fund të shekullit I para Krishtit, Perandoria Romake i pushtoi tokat e Dardanisë duke shkatërruar kështu shtetin dardan.



 ULPIANA, QYTET NË DARDANI



### TË PUNOJMË SË BASHKU

Duke analizuar shtrirjen e Mbretërisë Dardane, vizatoni një hartë dhe krahasoni territorin e Mbretërisë Dardane dhe atë të Republikës së Kosovës.

## VII

44. MONUMENTE TË KULTURËS  
MATERIALE NË DARDANI

 HYJNESHA NË FRON

Dardania, duke qenë një nga territoret më të rëndësishme të Ilirisë, ishte e pasur me ngjarje dhe aktivitete të ndryshme. Në Dardani u ruajtën veçoritë etnike ilire që u takonin dardanëve dhe fiseve të tjera ilire më të vogla që jetonin në Dardani. Njohuritë për hyjnitë dardane, monumentet kulturore dhe burime të tjera materiale, i sigurojmë përmes gjetjeve arkeologjike.

**Hyjnesha dardane - Hyjnesha në Fron**

Në lokalitete të ndryshme të Dardanisë antike janë gjetur numër i madh portretesh të Hyjneshës dardane. Hyjnesha, së pari, është zbuluar në lokalitetin Tjerrtorja në Prishtinë. Ajo daton që nga viti 3500 para Krishtit në epokën neolitike dhe është punuar nga balta. Një zbulim tjetër i hyjneshës në fron është realizuar në Smirë të Vitisë, në vitin 1988. Hyjnesha dardane simbolizon shprehjen e besimit dardan që nga periudha parahistorike. Ajo është një nga monumentet më të vlefshme dardane të gjetura ndonjëherë në territorin e Kosovës së sotme.

**Monedha me mbishkrimin Dardania**

Në lokalitetin e Soçanicës në Kosovë janë gjetur monedha të ndryshme me figurën e hyjneshës dhe me mbishkrimin Dardanici-a. Një nga këto monedha ka qenë në qarkullim gjatë viteve 98-100 pas Krishtit. Monedhat përdoren për shkëmbime tregtare. Edhe xehetarët dardanë i përdornin këto monedha kur i tregtonin prodhimet e tyre.



MONEDHË ME  
MBISHKRIMIN  
DARDANICI 

**Hyjnesha dardane e gjetur në Banjën e Kllokotit**

Në Banjën e Kllokotit është gjetur busti i një gruaje, i skalitur në mermer. Vendi ku u gjet busti është i njohur si vendbanim i madh ilir i kohës së sundimit romak. Ky bust i takon periudhës së shekujve II-III. Në këtë bust gruaje shohim gruan ilire me një shami zbukuruese, që i varet deri në supe, vathët e mëdhenj në formë të kalaveshit të rrushit dhe qaforja zbukuruese mjaft e dukshme. Kjo figurë gruaje quhet busti i Hyjneshës Dardane nga Kllokoti.



BUSTI I HYJNESHËS  
DARDANE NGA KLLOKOTI 

## Cjapi

Cjapi është një nga kafshët që mbanin ilirët. Kjo kafshë është flijuar për nder të Vidasit, i cili ishte hyjni ilire e blegtorisë. Cjapi është respektuar edhe në traditën shqiptare. Bririn e cjapit e mbajti në helmetë edhe mbreti Pirro i Epirit. Figura të cjapit të punuara prej bronzi janë gjetur në shumë lokalitete ilire.



 CJAPI I PRIZRENIT

## Hardhia e rrushit


Kultivimi i rrushit ka ndikuar te dardanët që ta vlerësojnë shumë hardhinë. Në lashtësi, hardhia e rrushit shihej si pasuri e çmueshme e ilirëve. Ajo simbolizonte begatinë e familjes, meqë, përveç përdorimit të rrushit për ngrënie, ilirët prodhonin edhe pije të ndryshme. Më e përhapura ishte pija e verës, që prodhohej gjithandej Dardanisë. Dardanët e skalitën hardhinë e rrushit në gurë dhe mermer duke e vlerësuar lart.



 HARDHIA E RRUSHIT,  
E SKALITUR NË GURË

## Vrapuesja e Prizrenit

Vrapuesja e Prizrenit është një figurë prej bronzi. Ajo i takon botës së atletikës, që është rast i rrallë të jetë grua, meqë atëbotë gratë nuk lejoheshin të merrnin pjesë në lojëra sportive. Mendohet se daton rreth 500 vjet para Krishtit. Është gjetur në Prizren, prandaj quhet Vrapuesja e Prizrenit. Të gjitha këto monumente dhe shumë të tjera së bashku përfaqësojnë thesarin e Dardanisë antike dhe të Kosovës së sotme.



 VRAPUESJA E PRIZRENIT

## VII

## 45. MBRETËRIA ARDIANE



**Diskutim:** Diskutoni për emrat që mbajnë shqiptarët, si: Agron, Teutë, Gent, Vjosë. Pse i mbajnë këta emra?

### Agroni krijoi Mbretërinë e Ardianëve (250 - 168 para Krishtit)

Ardianët janë ndër fiset e mëdha ilire. Ata formuan shtetin e tyre në shek. III para Krishtit. Themeluesi i Mbretërisë Ardiane ishte Agroni. Mbretëria Ardiane arriti të bashkonte një pjesë të madhe të tokave ilire. Kufijtë shtetërorë të shtetit ardian shtriheshin që nga lumi Vjosa në jug, deri në Dalmacinë e Mesme në veri, dhe në lindje që nga trevat rreth liqenit të Ohrit deri te bashkimi i dy Drinave në Kukës. Qyteti kryesor i Mbretërisë Ardiane u bë Shkodra.

Shteti ardian ishte mbretëri e trashëgueshme. Fronin mbretëror kishin të drejtë ta zinin edhe gratë. Në kohën e mbretit Gent, pushteti i mbretit ishte i pakufizuar.

### Lufta e Parë Iliro-romake (229 - 228 para Krishtit)

Mbretëria Ardiane, së bashku me Perandorinë Romake, ishin dy fuqitë kryesore detare në Adriatik. Mbreti Agron ndërtoi flotën detare më të madhe ilire. Ai krijoi edhe reparte të ushtrisë këmbësore dhe kalorës. Agroni e mbështeti sundimin e tij në ndihmën e aristokracisë dhe të shtresave të varfra, me të cilat e krijoi ushtrinë.

Pas vdekjes së Agronit, udhëheqjen e shtetit e mori Teuta, një grua ambicioze dhe e vendosur që të vazhdonte politikën e forcimit të shtetit ilir. Teuta bëri një varg reformash, të cilat e fuqizuan edhe më shumë Mbretërinë Ardiane. Fuqizimin e Teutës nuk e shihnin me sy të mirë romakët. Andaj, për të penguar rritjen e shtetit ilir, Roma i shpalli luftë Teutës. Në vitin 229 para Krishtit filloi lufta e Parë Iliro-romake. Flota romake, me një numër të madh të anijeve, u nis për ta pushtuar Ilirinë. Teuta u bëri rezistencë romakëve, por njëri nga komandantët e saj, Dhimitër Fari, me tradhti ua dorëzoi Korkyrën, meqë romakët i kishin premtuar se do ta njohin si mbret të Ardianëve. Romakët, të motivuar, vazhduan luftën dhe pushtuan Apoloninë dhe Dyrrahun. Teuta u tërhoq në qytetin Rizon (Risani, në gjirin e Kotorrit), duke kërkuar paqe. Në vitin 228 para Krishtit, u realizua paqja me romakët, të cilët e ngushtuan së tepërmi shtetin ilir, duke e kufizuar nga Narona deri te qyteti i Lisit (Lezha e sotme).



MONEDHA TË GJETURA NË TERRITORIN E SHTETIT, CATTARO - KOTORARDIAN

### **Lufta e Dytë Iliro - romake (219-218 para Krishtit)**

Dhimitër Fari, si shpërblim për tradhtinë që i bëri Teutës, u caktua nga romakët si sundimtar i shtetit të ardianëve. Dyrrahu e Apolonia u vunë në protektoratin romak. Megjithatë, Dhimitri, pasi forcoi pozitat e tij, u mundua të pavarësohej sërish nga Perandoria Romake dhe ta fuqizonte shtetin e tij. Në vitin 228 para Krishtit, Dhimitri përfshiu brenda shtetit ardian disa territore të humbura më parë dhe krijoi aleancë me Maqedoninë kundër romakëve. Ai forcoi ushtrinë ilire dhe ripërtëriu flotën detare.

Ndërkohë, u shfaqën grindje në mes të drejtuesve të shtetit ardian. Skerdilaidi, i cili qe bërë bashkësundimtar me Dhimitër Farin, u bashkua me romakët. Kjo luftë politike në mes të tyre i dëmtoi interesat e shtetit ardian. Në këtë situatë, Roma e pati më të lehtë të sulmonte ilirët e përçarë në mes vete. Lufta në mes ardianëve dhe romakëve u zhvillua në vitet 219-218 para Krishtit. Betejat kryesore u zhvilluan në qytetin e Dimalit dhe në Far. Lufta përfundoi me fitoren e romakëve. Pas kësaj humbjeje, Dhimitër Fari u detyrua të strehohej në Maqedoni. Romakët e futën sërish nën vartësinë e vet shtetin ardian dhe e vunë në krye aleatin e tyre Skerdilaidin. Nga viti 218 para Krishtit, Roma e detyroi Mbretërinë Ardiane t'i paguante një tatim vjetor.

### **Lufta e Tretë Iliro-romake (168-167 para Krishtit) - rënia e shtetit të ardianëve**

Duke qenë një shtet i dobët dhe i varur nga Roma, shteti ardian u bë synim i maqedonasve. Kështu lindi konflikti mes romakëve dhe maqedonasve për territoret e ardianëve. Në vitin 205 para Krishtit, trualli i Mbretërisë Ardiane u bë arenë luftime midis romakëve dhe maqedonasve. Në vitin 181 para Krishtit, në krye të Mbretërisë Ardiane u vu Genti. Ai lidhi aleancë me maqedonasit kundër romakëve. Qëllimi i Gentit ishte t'i bashkonte forcat me maqedonët dhe të fitonte sërish pavarësinë nga Roma. Ai e vlerësonte si armën më kryesore flotën detare, prandaj e fuqizoi atë. Për ta përballuar fuqinë e romakëve, Genti lidhi aleancë edhe me Mbretërinë Dardane. Duke parë fuqizimin e ardianëve, Senati romak vendosi të sulmonte Ilirinë. Për këtë arsye, në vitin 168 para Krishtit, përgatiti një ushtri të madhe. Ushtria romake zbarkoi në Iliri dhe rrethoi kryeqendrën e mbretërisë - Shkodrën. Ardianët e humbën luftën dhe, një vit më vonë, e humbën pavarësinë e tyre. Ky akt shënon edhe shkatërrimin përfundimtar të Mbretërisë së Ardianëve dhe vendosjen e sundimit të gjatë romak.



## VII

## 46. ILIRIA NËN SUNDIMIN E PERANDORISË ROMAKE

**Çka ndodhi pas pushtimit të Ilirisë nga romakët?**

Perandoria romake arriti të pushtonte krahinat e Ilirisë përgjatë bregdetit Adriatik, kurse ilirët që banonin në viset e brendshme të Ballkanit, e ruajtën deri vonë lirinë e tyre.

Pas vendosjes së pushtimit romak, ilirët u ndien shumë të rrezikuar. Roma ndoqi një politikë të shfrytëzimit të skajshëm, duke përdorur

metoda dhune nga më të ndryshmet. Pushtuesit romakë shpronësuan pronarët ilirë. Fshatarët, pronarë tokash, i kthyen në skllëvër. Shumë ilirë, për t'iu shmangur kësaj dhune, i lanë pronat dhe vendin e tyre dhe u larguan.

Romakët ndoqën edhe politikën e shpërnguljes, të kolonizimit dhe të asimilimit. Ata sollën në Iliri ushtarakë, zejtarë, fshatarë, tregtarë, detarë, nëpunës, por edhe romakë të zakonshëm. Qëllimi i tyre ishte që të shpopullonin dhe të asimilonin Ilirinë. Me prurjen e këtyre kolonëve, filloi të përhapej gjuha latine dhe kultura romake në Iliri.

**Romakët e ndanë Ilirinë në disa provinca**

Perandoria e fuqishme romake e ndau territorin ilir në disa njësi administrative. Tokat në jug të Matit u përfshinë në Provincën e Maqedonisë,

kurse tokat nga lumi Mat e deri në Danub, u përfshinë në Provincën e Ilirikut. Në shek. IV, pasuan ndarje të tjera. Iliria e Jugut u nda në katër provinca: Prevali (me qendër në Shkodër), Dardania (me qendër Shkupin), Epiri (me qendër Durrësin) dhe Epiri i Vjetër (me qendër Nikopojën). Në krye të provincave, Perandoria Romake kishte emëruar drejtues që zakonisht ishin të preferuarit e perandorit.

**Shfrytëzimi ekonomik i Ilirisë nga romakët**

Romakët e shfrytëzuan Ilirinë edhe ekonomikisht. Ata sollën xehetarë të shumtë që nxirrnin nga minierat ilire metale të ndryshme, si: argjend, bronz, plumb, hekur. Përveç xehetarëve, në miniera punonin edhe skllëvër të zënë robër gjithandej ku bënte luftë Perandoria Romake. Nxjerrja e metaleve ndikoi në zhvillimin e hovshëm të zejtarisë. Prodhimet më të shumta që sillnin fitime vinin nga farkëtaria, argjendaria, zdrukthëtaria, sharrëtaria dhe



GRA ILIRE, SKULPTURË

vorbëtaria. Këto prodhime shiteshin në tregje të ndryshme të Mesdheut.

Gjatë sundimit romak, eksportoheshin edhe prodhimet bujqësore, blegtorale, prodhimet e drurit, vaji dhe vera. Jeta e ilirëve nën romakë u bë shumë më e vështirë, sidomos në kohën e krizës së Perandorisë Romake, e cila u shfaq në mënyrë të dukshme prej shek. III pas Krishtit.

Pavarësisht këtyre rrethanave, ilirët patën rol të rëndësishëm në ekzistencën e Perandorisë Romake. Ata i dhanë shtetit romak shumë drejtues e perandorë të njohur, si: Klaudin II, Decin, Aurelianin, Dioklecianin, Probin, Konstantinin etj.

### **Ndikimi romak dhe gërshetimi i kulturës iliro-romake**

Pas pushtimeve romake, në Iliri filloi të ndihej ndikimi romak edhe në kulturë. Gjuha latine mori përhapje të gjerë dhe ishte gjuhë zyrtare. Qendra të kulturës romake u bënë qytetet e mëdha ilire. Këto qytete u populluan me popullsi romake. Pas kolonizimit, këto qendra urbane u shndërruan në vendbanime me popullsi të përzier. Kjo ndikoi edhe në gërshetimin e kulturave të ilirëve me romakët. Të dy popujt huazuan nga njëri-tjetri duke filluar që nga veshjet dhe jeta e përditshme e deri te gjuha dhe tradita e popujve.

Në Iliri u pa ndikimi romak edhe në arkitekturë, skulpturë, pikturë, mozaik dhe në kulturën e religjionit. Megjithë ndikimin romak në kulturën ilire, në shumë zona të Ilirisë u ruajtën traditat ilire në art, skulpturë, zeytari, veshje, zbukurime etj.



### **TË PUNOJMË SË BASHKU**

Si u sollën pushtuesit romakë me ilirët?  
Çka kuptoni me gërshetim të kulturave?

## VII

47. KRYENGRITJA ILIRE KUNDËR  
PERANDORISË ROMAKE (6-9)**Faktorët që ndikuan në shpërthimin e kryengritjes**

Masat e ndërmarra nga Perandoria Romake në Iliri e vështirësuan gjendjen e popullsisë vendëse. Ekziston një numër i madh i faktorëve që ndikuan në vendimin e ilirëve për kryengritje. Vështirësitë ekonomike, taksat e larta, kthimi i popullsisë së lirë ilire në skllëvër, masat administrative, ndalimi i tregtisë, i ndërtimit të anijeve dhe veprime të tjera ishin vendimtare në shfaqjen e hapur të pakënaqësisë.

Ilirët ishin të vendosur të mos e pranonin këtë nënshtrim. Ata organizuan kryengritje lokale disa herë, të cilat u shtypën me lehtësi nga romakët. Në fillim të shekullit I pas Krishtit, ata përgatitën një kryengritje të madhe. Organizatorët bënë thirrje që të bashkoheshin të gjitha fiset ilire në luftë të përbashkët kundër pushtuesve romakë për ta çliruar atdheun e tyre.

**Kryengritja e madhe ilire**

Përgatitjet për kryengritje të përgjithshme kundër romakëve dhanë rezultatet e veta. Kryengritja e madhe ilire filloi në vitin 6 dhe zgjati deri në vitin 9. Si shkas për fillimin e kryengritjes u shfrytëzua shtimi i taksave dhe rekrutimi i dhunshëm i ushtarëve nga Iliria për të luftuar për interesa të perandorisë në luftërat e saj pushtuese. Në këtë kohë, Roma kishte tërhequr një pjesë të madhe të ushtrisë së saj të rregullt nga Ballkani dhe e kishte dërguar në luftë në Azi dhe Afrikë.

Të parët që ngritën krye ishin fisi i desidiatëve dhe i breukëve. Atyre iu prinin Batoja i desidiatëve dhe Batoja i breukëve. Kryengritësve desidiatë dhe breukë iu bashkuan edhe dalmatët, panonët dhe fiset e tjera prej Panonisë e gjer te dardanët dhe prej Moravës deri në Adriatik. Ilirët kryengritës, sipas shënimeve që na ofrojnë autorët antikë, formuan një ushtri të madhe, që numëronte rreth 200.000 këmbësorë dhe 9.000 kalorës. Kjo ushtri kryengritëse zhvilloi shumë luftime kundër romakëve.

Kryengritësit në fillim radhitën suksese të konsiderueshme. Ata depërtuan deri në Itali.

I ndodhur përballë kësaj ushtrie ilire, Oktavian Augusti u hodh në sulm me ushtrinë e tij. Romakët në sulmin e parë nuk arritën t'i thyejnë kryengritësit. Për këtë arsye, ata i futën krerët e kryengritjes në grindje në mes vete. Kjo grindje shkaktoi përçarje, kurse përçarja i dobësoi shumë forcat kryengritëse. Këtë dobësim e shfrytëzoi



 BATOJA, UDHËHEQËS I  
KRYENGRITJES.

Tiberi, i cili sulmoi sërish ushtrinë kryengritëse. Bato i breukëve hoqi dorë nga lufta dhe u tërhoq pas premtimeve që i dhanë romakët. Batoja i desidiatëve u detyrua të tërhiqej me forcat e veta në Dalmaci. Romakët arritën t'i shpartallojnë forcat kryengritëse.

### **Pse u shua kryengritja?**

Pas tri vjetësh të luftimeve kundër romakëve, kryengritja u shua. Ilirët ranë sërish nën sundimin e romakëve, por pati humbje ushtarake nga të dyja palët. Ndër arsyt kryesore që ndikuan në shuarjen e kryengritjes ishin: organizimi i dobët ushtarak krahasuar me ushtrinë romake, gabimet strategjike (ilirët gabuan që sulmuan romakët deri në Itali, ata duhej të luftonin vetëm në tokat ilire të pushtuara), armatimi i dobët krahasuar me romakët dhe, më kryesorja, përçarja e forcave kryengritëse dhe konflikti në mes Batos së desidiatëve dhe Batos së breukëve.

Ilirët e humbën betejën, por nuk u pajtuan asnjëherë me nënshkrimin. Ata vazhduan edhe më tej luftën për t'u çliruar nga pushtuesit romakë.



 KRYENGRITJA ILIRE



## **TË PUNOJMË SË BASHKU**

Identifikoni faktorët që ndikuan në fillimin e kryengritjes!  
Analizoni faktorët që ndikuan në shuarjen e kryengritjes!

## VII

## 48. ARMËT SULMUESE DHE MBROJTËSE QË PËRDORESHIN NË ILIRI

Nevojat për të mbrojtur jetën, nderin dhe pasurinë i detyruan ilirët të armatoseshin. Në luftëra, ata përdorën armë të ndryshme. Ndër armët më të përdorura ishin:

**Thika** - (në ilirisht sika - sica) ishte armë e vogël me dimensione dhe forma të ndryshme, por jo me dallime të mëdha sa i takon gjatësisë. Kurse, si formë ishte karakteristike thika e drejtë dhe e lakuar si e shpatës së kthyer.

**Shpata e lakuar** - është prodhuar në Iliri. Ishte e shkurtër dhe shumë praktike për t'u përdorur prandaj ishte shumë e përhapur. Nga ilirët e morën tregtarët grekë dhe romakë të cilët, përveç përdorimit në vendet e tyre, e tregtuan deri në Spanjë.

**Sibyna** - është armë ilire e cila ishte e punuar prej hekurit dhe kishte formën e shtizës. Sibyna është gjetur gjatë gërmimeve arkeologjike në gjithë territorin e Ilirisë. Kjo nënkupton se është përdorur nga të gjitha fiset ilire.

**Thika e luftës** - ishte e gjatë 20-30 centimetra dhe quhet armë sulmuese. Kjo armë në fillim përdorej në jetën e përditshme për nevoja të caktuara. Më vonë, duke e parë si praktike, ky lloj thike u bë armë shumë e përdorshme, sidomos në luftimet trup më trup.

**Harku, shigjeta, shpata** - janë armët më të përdorura në ushtrinë ilire. Këto lloje armësh, ilirët i prodhonin vetë, por sipas nevojës i blinin edhe në vende të tjera. Këto armë janë gjetur në varrezat e ushtarëve ilirë, sepse ishte traditë që armët personale të varroseshin bashkë me ushtarin e vvarë.

**Armët mbrojtëse** - në armët mbrojtëse futen kryesisht mburojat me forma dhe dimensione të ndryshme. Fillimisht, mburojat bëheshin nga druri e ndonjëherë edhe nga lëkurat. Të dhënat për këto mburoja i gjejmë tek autorët antikë, meqë nuk mund të ketë informata nga burimet arkeologjike sepse druri dhe lëkura nuk i rezistojnë viteve, pra janë kalbur në tokë për një kohë të shkurtër. Më vonë u punuan mburoja metali në formë të



rrumbullakët, katrore dhe drejtkëndëshe.

**Parzmorja** - është veshje prej metali që e përdornin ushtarët ilirë për ta mbrojtur trupin e tyre në betejat e luftës. Parzmorja kryesisht mbulonte pjesën e epërme të trupit.

**Përkrenarja** - bën pjesë në armatimin e ushtarëve të pasur. Përkrenaret e bronzta i vinin komandantët e ushtrisë ilire dhe kalorësit. Përkrenare të shumta janë gjetur në gjithë territorin e Ilirisë. Në armët ilire bënë pjesë edhe shpata me dy teha, kallçinjtë, shpatat e luftës, heshtat etj.



ARMË SULMUESE DHE  
MBROJTËSE QË  
PËRDORNIN ILIRËT



## TË PUNOJMË SË BASHKU

Duke shfrytëzuar aftësitë tuaja nga fusha e artit, shfrytëzoni imagjinatën tuaj dhe pikturoni ndonjë nga armët ilire.


## VII

## 49. GJUHA, KULTURA DHE BESIMI TE ILIRËT

**Në Iliri flitej gjuha ilire**

Në territorin e Ilirisë, të gjitha fiset e kanë folur ilirishten. Për fat të keq, ata nuk na e lanë të shkruar gjuhën ilire. Gjurmë të gjuhës së shkruar ilire mund të jenë zhdukur gjatë viteve e shekujve të luftërave e shkatërrimeve në territorin ilir. Domethëniet e shumë fjalëve ilire të njohura, sot, është e mundur të shpjegohet vetëm përmes gjuhës shqipe. Kjo përbën faktin kryesor për vazhdimësinë e shqipes si pasardhëse e ilirishtes. Nga gjuha e vjetër ilire janë ruajtur shumë fjalë, si: emra njerëzish, fisesh, malesh, lumenjsh, qytetesh etj. Ndër emra njerëzish, më të përhapur janë: Gent, Teutë, Taulant, Dardan, Glauk, Dimal, Gentianë, Bardhyl etj. Vazhdimësia e ilirishtes në shqipe mund të shpjegohet edhe përmes emrave: Dalmat - Delme - Dele, Dimal - dy male, Dardan - nga fjala dard - dardhë, Maluntum - mal, Ulcin - Ulqin, Skupi - Shkupi, Ulk - Ujk, Scodra - Shkodra, Naisus - Nishi, Bigeste - bigë, Sika - thika etj.



 GJARPRI, SIMBOL I KULTIT ILIR

**Letërsia dhe arti ilir**


Për letërsinë ilire, nuk kemi shumë informacione, meqë veprat e shkruara letrare nuk arritën deri në ditët e sotme. Megjithatë, është e njohur se letërsia dhe shkrimet ilire trajtojnë tema për historinë, luftërat, mjekësinë etj. Ndër dijetarë e autorë që kanë shkruar tekste të shkurtra dhe libra janë: Genti, Pirroja, Filonid Dyrraheni, Dioskuridi (ishte mjek) etj. Arti ilir pasqyrohej në zbukurimet e bëra në godinat monumentale ose në ndërtimin e varrezave. Ilirët punonin skulptura prej guri, shtatore e portrete njerëzish. Shtatore dhe portrete ata u bënë mbretërve dhe hyjnive. Skulptura të tilla janë gjetur në shumë vende të Ilirisë. Ndër portretet më të bukura të gjetura gjatë gërmimeve arkeologjike janë: Hyjnesha në Fron dhe Hyjnesha Dardane. Artizanatet zunë vend të rëndësishëm në krijimtarinë artistike ilire. Arti dekorativ u shfaq më së shumti në enë balte ose bronzi. Ilirët zhvilluan edhe arkitekturën e tyre origjinale dhe atë që vinte si rezultat i gërshetimit të kulturave të ndryshme.

Arti ilir përshtatej me nevojat dhe interesat e shoqërisë qytetare ilire.

**Muzika dhe vallet ilire**

Ilirët kishin muzikën e tyre të veçantë që e shoqëronin me vegla muzikore. Ata përdornin disa lloje veglash frymore, me harqe dhe me tinguj. Vegla më e përhapur ishte fyelli, të cilin ata besonin se e kishte shpikur Vidasi, mbrojtësi i blegtorisë. Një tjetër vegël muzikore ishte sirinski (kavalli). Lahuta, gjithashtu, përdorej kur këndonin këngë epike. Ilirët përdornin edhe okarinën. Ata këndonin në polifoni. Edhe vallet ishin të përditshme në jetën e ilirëve. Kishin valle gazmore, valle të trimërisë dhe valle rituale. Vallet shoqëroheshin me instrumente dhe luheshin dorë më dorë. Më e veçanta ishte vallja e luftëtarëve ilirë me shpata, të cilën e luajnë edhe sot sidomos shqiptarët e Kosovës.



 KAVALLI PËRDOREJ SI VEGËL MUZIKORE NË ILIRI.

## Në çka besonin ilirët ?

Krijimi i besimit të idhujve në Iliri daton nga periudha parahistorike. Këtë pohim e argumenton gjetja arkeologjike e “Hyjneshës në fron” në lokalitetin Tjerrrtorja në Prishtinë. Në fazat e mëvonshme të ekzistencës së tyre, ilirët kishin kaluar nëpër fazën e totemizmit. Kjo lidhet me faktin se shumë emra të fiseve ilire, të qyteteve dhe emra të tjerë, kanë bazë nga emrat e kafshëve. Vetë emri ilir, sipas mitologjisë, lidhet me gjarprin. Emri i enkelejve rrjedh nga ngjallat; taulantët identifikohen me tallandyshen (dallëndyshen); emri i dalmatëve identifikohet me dalmen - delmen; Ulqini - Ulkini nga emri ujk etj.

Më vonë, ilirët ishin paganë, pra besonin në shumë perëndi. Ata besonin në diell, hënë, ujëra, rrufe, bubullinë, shi, zjarr, kafshë etj. Kulti i diellit dhe i gjarprit ishin shumë të përhapura. Disa nga këto hyjnizime janë përcjellë ndër shqiptarët deri në ditët sotme. Kulti i diellit shihet kudo në kullat shqiptare, në dyer të hyrjes dhe në dritare të cilat kanë formë gjysmërrethi dhe mbi to janë të vendosura tulla ose gurë të gjatë në formë vertikale, që simbolizojnë rrezet e diellit. Edhe kulti i gjarprit ka mbetur nga tradita. Deri në ditët e sotme, në fshatra të thella, është përdorur shprehja “gjarpri është roja e shtëpisë” ose këmisha e gjarprit është përdorur kundër “syrit të keq” - mësyshit.

Ilirët respektonin shumë kultin e nënës, të familjes dhe të fisit. Nëna shihej si ripërtëritëse dhe mbrojtëse e familjes. Perënditë kryesore, në të cilat besonin ilirët, ishin: Pani - hyji i pyllit dhe i grigjës; Medauri - perëndi e luftës; Bindi - hyji i detit dhe lundrimit - ujit; Vidasi - hyji i blegtorisë; Iria - hyjneshë e bujqësisë; Thana - hyjneshë e lindjes - plleshmërisë dhe Tademi - zot i dritës.

Ilirët besonin edhe në jetën pas vdekjes. Kjo është vërtetuar nga zbulimet arkeologjike. Në varret ilire janë gjetur armë, stoli, enë dhe gjëra të tjera të ndryshme. Të gjithë ilirët, para se të përqafonin krishterimin, ishin politeistë.



## Fjalori

**Kult** - adhurim a nderim i tepruar ndaj dikujt, besim në fuqitë e mbinatyrshme.

**Pagan** - ai që nuk ka kaluar në njërin nga fetë monoteiste, ai që besonte në shumë hyjni e perëndi.

**Politeist** - ai që besonte në shumë perëndi. Politeizmi lindi pas totemizmit.



## TË PUNOJMË SË BASHKU

Duke shfrytëzuar burime të ndryshme, gjeni fjalë ilire që nuk janë shënuar në këtë tekst.

Në cilin rajon të territoreve shqiptare është trashëguar këndimi në polifoni, që këndohet edhe sot?

Diskutoni edhe për vallet e trimërisë që luhen edhe në ditët e sotme. Gjeni në cilin rajon luhen!

Krahasoni besimin e ilirëve të vjetër me shqiptarët e sotëm!



## VII

## 50. PERSONALITETE TË SHQUARA ILIRE

**Bardhyli (449-359 para Krishtit)**

Bardhyli ishte mbret i enkelejve. Ai erdhi në pushtet pasi e rrëzoi mbretin Sirra nga fronti. Me origjinë ishte nga shtresat e mesme. Ai drejtoi shtetin ilir të enkelejve nga viti 393 deri me 359 para Krishtit. Luftoi kundër grekëve dhe maqedonasve. Këta të fundit i detyroi t'i paguanin shtetit të enkelejve tatim vjetor. Bardhyli gjunjëzoi mbretërit maqedonas, si Aleksandrin II dhe Perdikanin III. Ai ishte aktiv si komandant i ushtrisë ilire deri në fund të jetës së tij.

**Glauku (-302 para Krishtit)**


Ishte njëri nga mbretërit ilirë prej fisit të taulantëve. Glauku e ringriti shtetin ilir që humbi rëndësinë e vet pas vdekjes së Bardhylit. Drejtoi Mbretërinë e taulantëve në periudhën 325-302 para Krishtit. Më 335 kishte ndihmuar Klitin për marrjen e Pelionit. Pas vdekjes së Aleksandrit të Maqedonisë, çliroi krahinat rreth liqenit Lyhniid dhe i bashkoi ato me zotërimet e veta.

Glauku lidhi krushqi me mbretin molos Aiakidin. Kur Aiakidi ra nga pushteti në vitin 317 - Glauku mori nën mbrojtje të birin e tij 2-vjeçar, Pirron. Në vitet 314-312, Glauku luftoi me sukses kundër Kasandrit për Apoloninë e Dyrrahun, kurse tri vjet më vonë hyri në Epir dhe vuri në krye të shtetit molos Pirron 12-vjeçar. Sundoi deri në vitin 302 para Krishtit.

 USHTARILIR
**Teuta**

Teuta ishte një nga personalitetet më të rëndësishme të historisë ilire. Ajo qeverisi vetëm tri vjet, por la gjurmë në historinë e Mbretërisë Ardiane. Ajo e trashëgoi pushtetin e bashkëshortit të saj, Agronit, gjatë viteve 230-227 para Krishtit.

Teuta vazhdoi të çonte përpara forcimin e shtetit ilir dhe të realizonte planet dhe synimet e Agronit. Ajo forcoi më tej rendin shtetëror, duke i dhënë përparësi pushtetit qendror, i dha impuls të ri zhvillimit ekonomiko-kulturor të qyteteve. Mbretëresha i kushtoi vëmendje të veçantë fuqizimit ushtarak e posaçërisht flotës detare, të cilën e llogariste si armën më të fortë.



### Genti

Ishte biri i mbretit Pleurat. Ai qeverisi Mbretërinë Ardiane nga viti 181 deri në vitin 168 para Krishtit. Në kohën e Gentit, shtetin ilir u fuqizua politikisht, ushtarakisht si dhe pati një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Pas ardhjes në pushtet, Genti pati përplasje me romakët, të cilët i pengonte forcimi i shtetit ilir.

Romakët e akuzuan si nxitës dhe mbështetës të piratëve të cilët i ndalonin anijet tregtare romake. Për këtë arsye, senati caktoi në vitin 178 një flotë ushtarake prej 10 anijesh të patrullonte në Adriatik. Në kohën e Gentit, në shtetin ilir u priten monedha. Forcimi politik dhe ushtarak i mbretërisë së Gentit e shqetësoi Perandorinë Romake, e cila i sulmoi ilirët me potenciale të shumta në vitin 168 para Krishtit.

### Longari (sundoi 231 - 206 para Krishtit)

Longari njihet si mbreti i parë i Dardanisë. Longari ishte në luftë me mbretër të ndryshëm, meqë ata pretendonin të fusnin nën sundimin e tyre tokat e Dardanisë. Ai i mundi në betejat e luftës mbretërit e njohur maqedonas Dhimitrin II dhe Filipin V. Në vitin 231 para Krishtit, e çliroi Paioninë nga maqedonasit. Në kohën e sundimit të Longarit, Mbretëria Dardane njohu ritme të zhvillimit ekonomik e kulturor. Ai krijoi aleanca me fiset e tjera ilire dhe me Mbretërinë e Ardianëve për luftë të përbashkët kundër pushtuesve.

### Pirro i Epirit (319-272 para Krishtit)

Pirroja ishte një nga udhëheqësit më të shquar të kohës. Ai rridhte nga fisi i molosëve në Epir. Pirroja u bë i njohur në vitin 280 para Krishtit kur e kaloi ngushticën e Otrantos me 20.000 këmbësorë, 3000 kalorës dhe rreth 200 elefantë, për të luftuar kundër Romës. Atje korri fitore të shumta, por edhe humbi shumë ushtarë. Kufijtë e shtetit të Pirros u shtrinë në lindje deri në lumin Aksios (Vardar), në veri, përtej Apolonisë, kurse në jug, deri në Peloponez. Në kohën e qeverisjes së Pirros, u shënuan përparime të shumta në ngritjen dhe zhvillimin e qyteteve, në jetën urbane, në zhvillimin ekonomik dhe atë kulturor.







